



Roli i Institucioneve Publike në Zhvillimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin në Shqipëri

Ilda Londo, Brankica Petković, Sandra Bašić Hrvatinić



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e partnerëve të projektit "Media për Qytetarët – Qytetarët për Median" dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.

Titulli: Roli i Institucioneve Publike në Zhvillimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin në Shqipëri

Botues: Instituti Shqiptar i Medias
Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania
Tel./fax: ++ 355 4 2229800
E-mail: info@institutemedia.org
www.institutemedia.org

Autor i raportit për Shqipërinë: Ilda Londo

Editor për raportin për Shqipërinë: Ilda Londo

Autorë të raportit rajonal: Brankica Petković, Sandra Bašić Hrvatin

Editor për raportin rajonal: Brankica Petković

Përkthimi dhe korrektimi: Altin Fortuzi

Design: Slaviša Starčev

Faqosja: Bujar Karoshi, M&B Botime dhe Studio Grafike

Tirazhi: 100 kopje

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Londo, Ilda
Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit
mbi median dhe informacionin në Shqipëri / Ilda Londo,
Brankica Petković, Sandra Bašić Hrvatin ; përkth. e red.
Altin Fortuzi. – Tiranë: M & B, 2019
112 f. ; 20 x 17.6 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-256-82-9

1.Masmedia 2.Teknologjia e informacionit 3.Edukimi
4.Raporte 5.Ballkani Perëndimor 6.Shqipëri

37.015 :316.774(047)

Roli i Institucioneve Publike në Zhvillimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin në Shqipëri

Përmbajtja

1. Hyrje	7
2. Ilda Londo Roli i Institucioneve Publike në Zhvillimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin në Shqipëri	9
3. Brankica Petković dhe Sandra Bašić Hrvatin Edukimi mbi Median dhe Informacionin në Vendet e Ballkanit Perëndimor: Një Mundësi Emancipimi Akoma e Parezalizuuar	55
3. Rreth autorëve	111

Media për Qytetarët – Qytetarët për Median është një projekt i shtatë organizatave për zhvillimin e medias në Ballkanin Perëndimor (**Fondacioni "Mediacentar", Instituti Shqiptar i Medias, Instituti Maqedonas për Median, Instituti i Medias i Malit të Zi, Shkolla e Gazetarisë Novi Sad, Instituti i Paqes, SEENPM**) me qëllim forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në rajon për të zhvilluar edukimin për median dhe informacionin (MIL).

Media për Qytetarët – Qytetarët për Median

www.seenpm.org

<https://www.facebook.com/seenpm.org/>

@SEENPM_org

www.cimusee.org

Për më shumë informacion mund të kontaktoni admin@seenpm.org dhe ilda@institutemedia.org



1. Hyrje

Edukimi për median dhe informacionin (EMI) në Shqipëri nuk është term gjerësisht i njohur, i diskutuar apo i pasqyruar në politikat e institucioneve publike. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile, por edhe disa institucione publike, kanë punuar në këtë fushë, kryesisht në mënyrë sporadike dhe spontane. Një vizion i plotë, i qartë dhe i vazhdueshëm për aplikimin e konceptit në fushën e politikave dhe institucioneve publike, apo dhe organizatave jo qeveritare ka munguar.

Në kohën ku jetojmë mundësitë për të marrë informacion janë shumëfishuar, falë numrit të lartë të mediave në vend dhe procesit të dixhitalizimit të mediave audiovizive, por sidomos në sajë të shpërthimit galopant të mediave online. Fakti që një pjesë e mirë e popullsisë në Shqipëri është përdoruese e rregullt e rrjeteve sociale bën që informacioni të arrijë në më shumë njerëz se kurrë më parë, më shpejt se kurrë më parë.

Ndërkohë që informacioni përhapet me shpejtësi, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për instrumentat apo vetëdijen e popullsisë në lidhje me këtë informacion. Sa të përgatitur janë shqiptarët për të dalluar nëse informacioni është i vërtetë? A dinë ata të dallojnë kush është burim i besueshëm dhe kush jo? A mund të dallojnë faktet nga opinioni dhe kur ky i fundit paraqitet si fakt? Këto dhe shumë pyetje të ngjashme janë pyetje që gjithnjë kanë pasur rëndësi në lidhje me vërtetësinë dhe besueshmërinë e mediave. Por asnjëherë më parë kjo besueshmëri nuk është vënë në pikëpyetje si sot, kur shpejtësia e përhapjes së informacionit duket se është prioriteti kryesor. Dinamika e zhvillimit të peizazhit mediatik nga njëra anë, si dhe ndryshimi në dinamikën e prodhimit të lajmit nga ana tjetër, e kanë rritur gjithnjë e më tepër nevojën për të hedhur dyshime mbi informacionin që serviret publikisht.

Në këtë kontekst, është gjithnjë e më e rëndësishme alternativa e edukimit të qytetarëve për median dhe informacionin, pra pajisja e tyre me njohuritë dhe instrumentet e nevojshme për të lundruar në këtë det informacioni, jo gjithnjë të vërtetë, të verifikuar, të plotë, apo të paanshëm. Natyrisht që do të ishte naive të besojmë se edukimi për median dhe informacionin do të ishte shkopi magjik që automatikisht shndërron qytetarët në përdorues të ndriçuar të medias dhe informacionit. Gjithsesi, në njëfarë mase ky edukim ndihmon gjithnjë e më shumë njerëz t'i fusin lajmet dhe informacionet në sitë dhe të marrin atë që mendojnë se është më afër të vërtetës, dhe kjo nuk është arritje e vogël në situatën e sotme.

Ky botim është pjesë e projektit rajonal "Media për Qytetarët - Qytetarët për Media: Forcimi i kapaciteteve të organizatave jo-qeveritare për zhvillimin e Edukimit për Median dhe në Ballkanin Perëndimor." Ky projekt po zbatohet me mbështetjen e Bashkimit Evropian nga shtatë organizata: Mediacenter Sarajevë, Instituti Shqiptar i Medias, Instituti Maqedonas për Median, Instituti Medias i Malit të Zi, Shkolla e Gazetarisë Novi Sad, si dhe Instituti i Paqes në Ljublanë dhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizmin në Media (SEENPM). Pjesa e parë e botimit përmban raportin kërkimor për gjendjen e politikave publike mbi edukimin për median dhe informacionin në Shqipëri, të hartuar nga Instituti Shqiptar i Medias. Pjesa e dytë është një përmbledhje e rezultateve të kërkimit në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ku po zbatohet projekti, e kryer nga Brankica Petković dhe Sandra Basic Hrvatin. Përfundimet e raportit kërkimor do të shërbejnë si bazë për të zhvilluar aktivitetet e mëtejshme të projektit, si dhe janë një mundësi informimi për aktorë të tjerë që punojnë për zhvillimin dhe nxitjen e politikave të edukimit për median dhe informacionin në rajon.

Roli i Institucioneve Publike në Zhvillimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin në Shqipëri

1. Hyrje

Në Shqipëri, edukimi mbi median dhe informacionin është një koncept relativisht i ri dhe i pastudiuar në tërësinë e vet, si përrsa i përket debatit publik ashtu dhe politikave të hartuara dhe të zbatuara në këtë fushë. Deri më sot, politikat zyrtare janë marrë vetëm me aspekte të veçanta të edukimit mbi median dhe informacionin (EMI), ndërsa përpjekjet për t'i zbatuar këto politika nuk kanë qenë gjithmonë të suksesshme apo sistematike. Organizatat e shoqërisë civile kanë qenë në pararojë të këtij procesi, por iniciativat e tyre nuk kanë qenë shumë efikase, dhe nuk ka patur përkushtime afatgjata në këtë fushë. Në kapitujt e mëposhtëm jepet një paraqitje e përgjithshme e iniciativave rreth EMI-t nga organizma shtetërore, publike, dhe private, si dhe nga organizata të shoqërisë civile, duke analizuar zhvillimet dhe prirjet kryesore në fushën e EMI-t, që janë edhe në fokus të këtij raporti kërkimor.

1.2. Politikat zyrtare në lidhje me edukimin mbi median dhe informacionin në Shqipëri

Sa herë që përmendet edukimi mbi median dhe informacionin në strategjitë, politikat dhe dokumentet zyrtare, mund të dallohen qartë dy elemente të përbashkëta: zakonisht flitet për njohjen me informacionin, dhe jo për edukimin mbi median; dhe gati gjithmonë i kushtohet vëmendje nevojës së zhvillimit të kompetencave që lidhen me edukimin mbi informacionin, ndërsa zhvillimi i një mendësie analitike dhe kritike mbi përmbajtjen e informacionit dhe medias vetëm sa preket shkarazi, apo nuk përmendet fare.

Dokumentet kryesore që paraqesin në detaje politikat qeveritare mbi shoqërinë e informacionit, si Strategjia Ndërsektoriale "Akhenda Digjitale e Shqipërisë" (2015-2020), dhe paraardhësja e saj Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit (2008-2013), e përqendrojnë vëmendjen e tyre ndër të tjera edhe mbi nevojën për të futur në shkolla lëndën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Në përgjithësi, prioritetet e parashtruara në Strategjinë Axhenda Digjitale për vitet 2015-2020 përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës kombëtare të TIK-ut, shtimin e numrit të lidhjeve të shpejta në internet (të paktën 100 Mbps për 50 për qind të familjeve, dhe 30 Mbps për të gjithë popullsinë), rritjen e përdorimit të internetit nga popullsia, duke kaluar nga 50 për qind në vitin 2013 deri në 90 për qind deri në fund të vitit 2020, si dhe lidhje interneti broadband për të gjitha shkollat në vend.¹ Në lidhje me futjen e TIK-ut në sistemin arsimor, Plani i Veprimit të Strategjisë parashikon edhe digjitalizimin e bibliotekave në institucionet

¹ Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, *Strategjia Ndërsektoriale "Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020"*. http://www.akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digjital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf (Faqja u vizitua më 2 Dhjetor 2018).

e arsimit para-universitar, trajnime mbi TIK-un për mësuesit, zhvillimin e një sistemi të mësimin online, dhe puna e vazhdueshme më TIK-un në arsimin para-universitar.²

Këto dokumente të strategjive zyrtare përmendin shkurtimisht rëndësinë e edukimit të publikut mbi shfrytëzimin e avantazheve që jep informimi, por aty informacioni shikohet vetëm si element pozitiv që duhet zhfrytëzuar, dhe nuk gjykohet si një element që duhet shqyrtuar, dhe që mund të bëhet edhe objekt kritikash. Duket se vëmendja kryesore e politikave në lidhje me edukimin mbi informacionin është përqendruar kryesisht mbi procesin e digjitalizimit të sektorëve publikë dhe privatë. Në këtë drejtim, dokumentet zyrtare e vënë më shumë theksin mbi edukimin e qytetarëve në lidhje me ndërveprimin elektronik me qeverinë, dhe shoqërinë digjitale në përgjithësi, duke i pajisur me aftësi teknike se si të mbledhin, përdorin, dhe shpërndajnë informacion në lidhje me këto shërbime.

Gjykimi me sy kritik i aspekteve të tjera të procesit të digjitalizimit, apo të vetë cilësisë të informacionit, nuk ka qenë pjesë e politikave apo strategjive zyrtare. Kjo prirje vihet re jo vetëm për sa i përket digjitalizimit dhe mediave të reja, por edhe në lidhje me mediat tradicionale, pasi nuk ka asnjë politikë për zhvillimin e edukimit mbi median, si në normat administrative të përgjithshme, ashtu dhe në ato për median.

² Po aty.

1.2.1. TIK kushtëzon politikat në lidhje me EMI-n në sistemin arsimor

Baza ligjore për funksionimin e sistemit arsimor para-universitar në Shqipëri është ligji 69/2012, "Mbi arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë." Përfaqja kryesore e ligjit është se sistemi para-universitar është një arsim i bazuar në kompetenca, duke përfshirë edhe kompetencat digjitale që duhet të përfitojë çdo nxënës i këtij sistemi, dhe deri në një farë mënyre ato mund të konsiderohen si të lidhura me EMI-n. Koncepti i aftësive digjitale është zhvilluar akoma më tej, dhe është përfshirë në programet mësimore, por edhe këtu kemi një përfaqje të ngjashme si në rastin e strategjive zyrtare në fushën e informacionit, pasi konsiderohet e rëndësishme që nxënësit të jenë në gjendje të gjejnë dhe të krijojnë informacion, por nga ana tjetër nuk i jepet prioritet zhvillimit të mendimit analitik dhe kritik në lidhje me mediat.

E njëjta frymë vihet re qartë edhe në dokumente të tjera të rëndësishme që rregullojnë funksionimin e sistemit arsimor, si Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Para-universitar 2014-2020, dhe Korniza Kurrikulare dhe Kurrikula Bërthamë. Në lidhje me kompetencat digjitale, këto dokumente orientohen kryesisht drejt teknologjisë dhe TIK-ut, që përbën një nga shtatë fushat kryesore të nxënies në kurrikulat e arsimit para-universitar. Si rezultat i kësaj, TIK është tani një lëndë e detyrueshme për të gjitha shkollat para-universitare publike dhe private në vend. Dhe pse zhvillimi i mësimimit në këtë lëndë ka problemet e veta dhe duhet përmirësuar trajnimi i mësuesve, kurrikula e pranon rëndësinë që ka zotërimi i aftësive digjitale nga ana e qytetarëve.

Nga ana tjetër, një pjesë me rëndësi kritike, si zbrërthimi i strukturave dhe punës së medias dhe informacionit, nuk është bërë pjesë e prioritetëve dhe politikave zyrtare. Megjithatë, lëndë të ndryshme përfshijnë edhe elemente të caktuara të analizimit me sy kritik të përmbytjes në media, si teksti, reklamat, aksesit në informacion, etj. Këto elemente zënë një hapësirë shumë të kufizuar në raport me TIK-un, dhe për më tepër nuk vihet re ndonjë vizion i qartë në politikat zyrtare mbi arsimin në lidhje me analizimin me sy kritik të medias dhe informacionit.

1.3. Organizatat e shoqërisë civile: në pararojë në fushën e edukimit mbi median

Përpjekjet më të mëdha për të mbushur boshllëkun në fushën e EMI-n vijnë kryesisht nga shoqëria civile. Këto iniciativa kanë kohëzgjatje dhe fushë veprimi të kufizuar, dhe u mungojnë politikat apo vizionet afatgjata, që kërkojnë bashkëpunim dhe bashkërendim pune me faktorë dhe organizata të tjera. Megjithë kufizimet dhe mangësitë e veta, këto aktivitete janë të vetmet përpjekje serioze për të njohur qytetarët me EMI-n, dhe për të mos u kufizuar vetëm tek teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

Për shembull, Instituti Shqiptar i Medias ndërmori një iniciativë, në kuadër të një projekti në vitin 2010, për të mbledhur dhe shkëmbyer eksperiencën me vende të tjera të rajonit për nisma në lidhje me edukimin mbi median, dhe shqyrtimin e mundësive për futjen e kësaj lënde në kurrikula. Si rezultat i kësaj pune u hartuan dy tekste shkollorë, që mund të përfshiheshin në kurrikulat zyrtare, edhe në formën e një projekti pilot, por kjo nuk ka ndodhur akoma, për arsye të ndryshme.

Trajnimi i të rinjve mbi edukimin digjital është një nga iniciativat e ndërmarra më dendur nga organizata të shoqërisë civile. Këto iniciativa janë zakonisht kurse trajnimi afatshkurtra, ndërsa trajnime për periudha të gjata kohe, të ngjashme me kurse diplome, janë të rralla. Disa organizata të ndryshme janë angazhuar në mënyrë aktive në përpjekje të tilla, duke përfshirë këtu edhe Institutin Shqiptar të Medias, qendrën Media Aktive, dhe disa të tjera. Po kështu, janë organizuar edhe disa konkurse me pjesë filmike dhe materiale të tjera mediatike të prodhuara nga vetë qytetarët, mbi çështje sociale - që është një formë tjetër e edukimit mbi median. Kohët e fundit ka filluar edhe funksionimi i një faqeje interneti për verifikimin e fakteve dhe deklaratave të politikanëve në media, në kuadër të një projekti më të madh mbi sistemin e drejtësisë.

1.4. Autoritetet mediatike dhe organizmat profesionale të medias: heshtje rreth edukimit mbi median dhe informacionin

Në përgjithësi, edhe ato pak përpjekje në lidhje me edukimin mbi median i drejtohen grupimeve të caktuara, dhe për pasojë i gjithë ky proces nuk ka patur ndonjë ndikim afatgjatë. Edhe mungesa e angazhimit të faktorëve mediatikë është pjesë e këtij problemi dhe dështimeve në ndërmarrjen e iniciativave të suksesshme në lidhje me EMI-n. Organizma rregullatore dhe vetë-rregulluese, që mund të përfshihen në procesin e edukimit të qytetarëve mbi median, dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të analizuar me sy kritik përmbajtjen mediatike, janë të pafuqishme apo nuk e shohin prioritare nevojën e edukimit mbi median. Këshilli i Ankesave, që është pjesë e institucionit rregullator Autoriteti i Mediave Audiovizive, ka organizuar disa takime në lidhje me këtë temë, por deri më tani këto aktivitete kanë përfshirë vetëm profesionistë të medias.

Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve, pranë radio televizionit publik, ka pak kohë që është krijuar dhe mbetet akoma për t'u parë nëse do të jetë në gjendje të luajë ndonjë rol në këtë drejtim. Po kështu, edhe Këshilli i Etikës, një organizatë e krijuar nga profesionistë të medias për të përmirësuar etikën në media, ka një hapësirë të kufizuar pune dhe i mungon eksperiencia e nevojshme, megjithëse teorikisht mund të jetë në gjendje të luajë një rol në përparimin e EMI-t.

Në përgjithësi, mediat nuk kanë treguar ndonjë interes në edukimin e qytetarëve mbi median dhe informacionin, veçanërisht në lidhje me nevojën për analizimin e medias në një shoqëri demokratike. I vetmi zhvillim pozitiv në këtë drejtim është krijimi i një hapësire 30-minutëshe në emisionin e mëngjesit në televizionin publik, intervistë me një pedagog gazetarie, duke u përqendruar në diskutimin e përmbajtjes mediatike dhe kritikën rreth medias.

1.5. Kompanitë private dhe EMI: një përpjekje më shumë për të zhvilluar aftësitë rreth TIK

Edhe përpjekjet e sektorit privat, si kompanitë e teknologjisë së informacionit, kanë qenë të rralla. Microsoft mbështeti një projekt në vitin 2016 për organizimin e një kursi masiv trajnimi online mbi shkrimin e kodeve kompjuterike, dhe aspekte të tjera të lidhura me TIK-un. Ky projekt pilot u zhvillua në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit, dhe platforma e krijuar për këtë projekt mund të vizitohet akoma në internet. Lëndët jepeshin në klasa online and mësimet përfshinin si lëndë të përgjithshme anglishten, matematikën, fizikën, dhe kiminë, si dhe kodimin dhe TIK-un si lëndë profesionale. Tani së fundmi, një laborator kompjuterik u hap si pjesë e Akademisë TIK, për mësimin e aftësive në lidhje me TIK-un për fëmijët e moshave 7-19 vjeç.³

Edhe në këtë rast, gati të gjitha përpjekjet e sektorit privat në fushën e EMI-t përqendrohen rreth TIK-ut, ndërsa nuk ka angazhim serioz dhe të vazhdueshëm për analizimin me sy kritik të medias dhe përmbajtjes së saj, në lidhje me lajmet e rreme dhe propagandën, megjithëse kjo është është gjithmonë e më shumë në qendër të debatit publik.

³ Gerta Dervishi, "Qendra e re inovative e Tiranës, laborator TIK përgatit të rinjtë shqiptarë për sfidat e shekullit të 21-të" Follow Business Albania, 5 Shtator 2018. <https://followbusinessalbania.com/tiranas-new-innovation-center-ictslab-prepares-albanian-youngsters-for-21-st-century-challenges/> (Faqja u vizitua më 20 Shtator 2018).

1.6 Mbrojtje apo edukim

Koncepti i edukimit të qytetarëve mbi mënyrat se si funksionon sistemi i medias është relativisht i panjohur në Shqipëri, përveç momenteve të caktuara të debateve publike të nisura nga media në raste ekstreme, që zakonisht kanë të bëjnë me debate mbi shkelje të rënda të normave etike. Përveç këtyre rasteve, nuk ka fare përpjekje për të nxitur analizimin me sy kritik mbi median, apo iniciativa për të orientuar qytetarët në konsumin e medias, për t'i dhënë atyre njohuritë dhe informacionet e duhura se si ta kuptojnë dhe përdorin median.

Në shumicën e rasteve, instruksionet që i jepen qytetarëve në lidhje me median kanë të bëjnë me mbrojtjen ndaj saj, dhe jo me mënyrën se si funksionon media. Kjo prirje vihet re veçanërisht në përpjekjet e organizatave jo-qeveritare dhe institucioneve publike që merren me mbrojtjen e fëmijëve. Në fakt, iniciativat dhe përpjekjet për krijimin e hapësirave më të sigurta për fëmijët në internet, kanë shënuar përparime më të mëdha se çdo iniciativë tjetër në lidhje me elemente të analizimit kritik në kuadër të edukimit mbi median dhe informacionin. Si pasojë e nevojës urgjente për të siguruar mbrojtje më të mirë për të miturit dhe ndjeshmërisë së kësaj teme, institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare, dhe faktorë vendas kanë ngritur zërin dhe janë angazhuar aktivisht në këtë drejtim. Kjo pasqyrohet edhe në legjisllacionin aktual, në udhëzime dhe rregullore specifike të miratuara nga autoritetet publike në lidhje me sigurinë e fëmijëve në internet dhe mbi çështjet e privatësisë, si dhe nga përpjekjet dhe aktivitetet e shumta të organizuara për këtë qëllim nga shoqatat për të rinjtë dhe fëmijët.

Momentalisht ekziston një koalicion me një numër aktivistësh dhe organizatash, duke përfshirë edhe institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare si agjenci të Kombeve të Bashkuara, dhe organizata vendase, që merren me mbrojtjen e fëmijëve në internet, dhe ky koalicion ka edhe platformën dhe faqen e tij të internetit në adresën

www.isigurt.al. Ashtu si dhe në aktivitetet e tjera të organizuara nga këto organizata, vëmendja kryesore i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve, dhe jo shpjegimit të mënyrës se si mund ta përdorin median dhe informacionin në mënyrë të sigurtë, por efikase. Kohët e fundit u hap Qendra Kombëtare e Internetit të Sigurtë, me qëllim që të përmirësohet niveli i sigurisë në internet, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë.⁴

⁴ CRCA (Child Rights Centre Shqipërinë – Qendra për të Drejtën e Fëmijës në Shqipëri) "Qendra kombëtare e internetit të sigurtë hapet në Shqipëri," CRCA, 31 Tetor 2018. <http://www.crca.al/en/news/national-safe-internet-centre-opened-albania> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

1.7. Fokusi tematik i punës studimore: Forcimi i rolit të institucioneve publike në edukimin e qytetarëve për EMI-n

Një përmbledhje e shkurtër e këtij prezantimi të përpjekjeve për edukimin mbi median dhe informacionin në vend, na tregon se përpjekjet në këtë drejtim janë akoma të rralla, mungojnë angazhimet e përbashkëta dhe një vizion i qartë, ndërkohë që mbështetemi akoma tek projekte sporadike. Duket qartë se politika zyrtare fazorizon TIK-un, ndërsa analiza kritike mbi median dhe informacionin nuk shihet si prioritet. Përpjekjet e shoqërisë civile për ta mbushur këtë boshllëk nuk kanë qenë edhe aq të suksesshme. Megjithëse këto orvatje akoma vazhdojnë, ato kanë qenë të fragmentarizuara dhe kanë angazhuar vetëm një numër të vogël aktorësh; një përpjekje e bashkërenduar e aktorëve të ndryshëm do të siguronte një sukses më të madh të këtyre iniciativave. Së fundmi, debati publik dhe përpjekjet aktuale përkrahin dukshëm prirjet parandaluese kundrejt medias dhe informacionit, dhe nuk përqendrohen tek edukimi dhe arsimimi, duke u mbështetur më tepër tek siguria online, dhe jo aq tek edukimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve mbi median.

Duke patur parasysh këtë situatë, kapitulli i ardhshëm i këtij raporti studimor përqendrohet mbi rolin e institucioneve publike të lidhura me median në sistemin e EMI-t - universitetet, radio televizioni publik, organizmat rregullatore, mekanizmat vetë-rregulluese – duke u munduar të përcaktojnë se cilët faktorë ndikojnë në rolin dhe ndikimin aktual të institucioneve publike për promovimin e EMI-t tek publiku. Institucionet publike që merren me median kanë potencialin më të madh për të hartuar dhe zbatuar iniciativa mbi EMI-n, por deri më sot ato kanë ndenjur në hije. Enti rregullator ka bërë disa përpjekje nëpërmjet Këshillit të Ankesave, por ato kanë qenë iniciativa sporadike dhe diskutime që zhvillohen akoma brenda një rrethi të mbyllur.

Radio televizioni publik i ka kushtuar pak kohë, tani së fundmi, diskutimeve në lidhje me EMI-n, por akoma nuk ka politika apo iniciativa specifike në këtë drejtim. Mëgjithëse është krijuar edhe Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve, nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshme për ta bërë atë një iniciativë publike, që të përmirësojë me të vërtetë nivelin e njohjes dhe komunikimit të qytetarëve me këtë radio televizion. Edhe universiteti publik është i kufizuar ana e kurrikulave, dhe nuk është angazhuar më tej për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit në lidhje me nevojën për EMI-n, apo të zhvillojë mjete dhe mënyra për të promovuar EMI-n në publik.

Për këtë arsye, në kapitujt e mëposhtëm do të përqendrohemi mbi rolin e institucioneve publike për edukimin mbi median dhe informacionin. Raporti do të fokusohet në veçanti në ato institucione publike që janë pjesë e sistemit arsimor, dhe ato që administrojnë sistemin mediatik. Qëllimi kryesor është që të prezantojmë më shumë informacion në lidhje me politikat dhe metodat e këtyre institucioneve publike për promovimin e EMI-t, dhe analizimin e tyre. Në mynyrë më specifike, puna studimore do të analizojë institucionet arsimore para-universitare dhe universitetet. Po kështu, studimi do të përqendrohet mbi autoritetet rregullatore dhe mediat publike, duke analizuar rolet dhe ndikimet e tyre në përmirësimin e situatës në lidhje me EMI-n.

2. Përgatitja e terrenit për edukimin mbi median dhe informacionin

Peizazhi mediatik shqiptar është mjaft dinamik dhe i pasur në numra, megjithëse shifrat nuk transformohen medoemos në pasuri dhe shumëllojshmëri në përmbajtje. Megjithëse shtypi i shkruar duket qartë se është në rënie, duke pasqyruar edhe prirjet botërore, dhe problemet e kësaj media tradicionale, ka akoma në qarkullim 18 gazeta të përditshme për një popullsi me më pak se tre milionë banorë. Situata financiare e mediave audiovizive duket të jetë disi më e mirë se ajo e shtypit të shkruar, por edhe raporti i numrit të radiove dhe televizioneve për banorë është i lartë. Sipas Autoritetit të Mediave Audiovizive, aktualisht ka 49 stacione radioje lokale; katër stacione radio komunitetesh, që i shërbejnë bashkësive më të mëdha fetare në vend; dy stacione radio private kombëtare; si dhe radioja publike me katër degë të saj në rrethe.⁵ Po kështu, ka 47 stacione televizive lokale, 75 televizione kabllore, pesë platforma kombëtare digjitale me programet e tyre respektive, si dhe platforma digjitale e radio televizionit publik me 12 programet e saj.⁶

Ndërkohë ka patur edhe një rritje të dukshme të mediave online, veçanërisht gjatë këtyre viteve të fundit, kur numri i mediave në internet shtohet parreshtur nga dita në ditë. Meqë mediat në internet nuk e kanë të detyrueshme që të regjistrohen, nuk ka informacion mbi numrin e saktë të tyre; por Unioni i Gazetarëve Shqiptarë llogarit se ka rreth 800 media shqiptare online.⁷ Shtimi i mediave në internet është inkurajuar nga zhvillimet teknologjike, si dhe nga përmirësimi i aksesit në internet në vend. Sipas të dhënave nga Statistika të Internetit nëpër Botë (Internet World Stats), niveli i depërtimit të internetit arriti në 66 për qind në fund të vitit 2017,⁸ ndërsa të dhënat nga enti rregullator kombëtar i komunikacioneve elektronike tregojnë se në tremujorin e tretë të vitit 2018 pati një rritje prej 15 për qind në

5 AMA, Lista e operatorëve të radios: <http://ama.gov.al/subjekte-audio/> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

6 AMA, Lista e operatorëve audiovizivë: <http://ama.gov.al/subjekte-audiovizive/> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

7 Aleksander Cipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, intervistuar më 20 Tetor 2018.

8 Të dhëna nga Statistikat e Internetit nëpër Botë, <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm#al> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

akses broadband në krahasim me 2017.⁹ Po kështu, përdorimi i mediave sociale është rritur ndjeshëm, ku Facebook është rrjeti social më i përdorur. Në vitin 2018, kishte 1.5 milionë përdorues aktivë të mediave sociale në vend.¹⁰

Këto statistika, si dhe fakti që nuk ka asnjë pengesë për përdorimin e mediave të çfarëdolloji në vend, tregojnë qartë se ka një shumëllojshmëri alternativash për publikun në zgjedhjen e organeve të medias. Sidoqoftë, nuk është gjithmonë e qartë se çfarë lloj mediash preferohen të ndiqen nga publiku, pasi nuk ka të dhëna publike mbi konsumin mediatic. Një sondazh publik i vitit 2016 mbi pandëshkueshmërinë në sistem,¹¹ tregoi se televizioni vazhdonte të ishte burimi kryesor i informacionit, megjithëse interneti, dhe veçanërisht rrjetet sociale, kishte fituar dukshëm terren. Një numër i konsiderueshëm të intervistuarish, 44 për qind e tyre, tha se e përdornin internetin për informacion mbi lajmet e ditës, dhe më konkretisht faqet e internetit të agjencive të lajmeve. Një numër akoma më i madh i tyre (56 për qind) tha se i përdornin rrjetet sociale për të njëjtin qëllim. Edhe Barometri Ballkanik 2018 jep disa të dhëna në këtë drejtim: 65 për qind e shqiptarëve e përdornin internetin për komunikim, ndërsa 41 për qind e tyre thonë se e përdornin internetin për lajme, dhe po 41 për qind përgjigjen se hyjnë në internet për zbatimje (Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit 2018).

Në këtë drejtim, prirjet në lidhje me konsumin mediatic në Shqipëri nuk ndryshojnë edhe aq nga tendencat globale. Edhe politikanët shqiptarë janë bërë pre e prirjeve për t'i cilësuar, në mënyrë të vazhdueshme, si lajme të rreme dhe dezinformata të gjitha ato informacione që i konsiderojnë si të pafavorshme për ta, duke shkaktuar në këtë mënyrë një acarim të situatës, dhe përkeqësim të nivelit të komunikimit publik në lidhje me median. Kryeministri Edi Rama sulmon verbalisht gazetarët në mënyrë të vazhdueshme, dhe nëpërkëmb punën e tyre, duke vënë shpesh në pikëpyetje motivet apo profesionalizmin e tyre, por edhe politikanët të tjerë kanë ndjekur shembullin e tij. "Rama është ankuar vazhdimisht se qeveria e tij është viktimë e 'shpifjeve,' dhe ka sulmuar mediat që e kritikojnë atë duke përdorur një mori epitimesh, duke i quajtur disa prej tyre sharlatanë, kazanë, helm apo edhe rrezik për opinionin publik."¹² Natyrisht që kjo nuk ka ndihmuar aspak në krijimin e një klime të shëndetshme për lirinë e medias, duke krijuar një situatë të tensionuar me sulme verbale që vënë në dyshim besueshmërisë e gazetarëve në vend.

9 Të dhëna nga AKEP, https://akep.al/images/stories/AKEP/statistika/2018/Raport_T3_2018.pdf (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

10 Hootsuite, "Ne jemi socialë" (We are social) Manuali Digjital 2018, <https://www.slideshare.net/wearesocial/2018-digjital-yearbook-86862930> (Faqja u vizitua më 13 Dhjetor 2018).

11 IDRA, *Pandëshkueshmëria – Opinioni publik mbi kuptimin, arsyet dhe rolin e institucioneve*, (IDRA, 2017), http://www.osfa.al/sites/default/files/studimi_pandeshkueshmeria_1.pdf (Faqja u vizitua më 13 Dhjetor 2018).

12 Gjergj Erebara, "Organizatet e të drejtave të njeriut kritikojnë kryeministrin shqiptar për 'disiplininë' të medias," Balkan Insight, 26 Dhjetor 2018. <http://www.balkaninsight.com/en/article/rights-organizations-criticize-albania-prime-minister-push-for-online-media-disciplining--12-26-2018> (Faqja u vizitua më 3 Janar 2019).

Në këtë situatë, është akoma më e rëndësishme që qytetarët të ndërgjegjësohen në lidhje me rolin e medias në vend, çfarë ndikimi mund të kenë faktorë të ndryshëm mbi profesionalizmin e mediave, modelin e biznesit, dhe transparencën e tyre. Treguesi i edukimit mbi median për vitin 2018 e renditi Shqipërinë ndër vendet e fundit në Evropë, si e papërgatitur për t'u përballur me lajmet e rreme dhe epokën e post-të vërtetës që po përjetojmë. Vetëm Turqia dhe Maqedonia ishte më dobët në këtë drejtim (Lessenski 2018). Kështu, në një kohë kur shqiptarët kanë akses të lirë në një numër më të madh mediash se kurrë më parë, veçanërisht në mediat online, duket se popullata ka mangësira të mëdha në filtrimin e informacionit, dhe analizimin e medias në mënyrë kritike. Të gjendur përballë një situatë sulmesh të vazhdueshme politike kundër besueshmërisë së medias, dhe duke patur parasysh se niveli i profesionalizmit në media nuk është fare i përsosur, perceptimi i publikut dhe vlerësimi i punës së medias duhet të udhëhiqet dhe gjykohet nga respektimi i standardeve profesionale, dhe jo nga retorika politike e ditës.

Po kështu, niveli i dobët i profesionalizmit të shumë mediave online, rënia e ndjeshme e nivelit të respektimit të standardeve etike, si dhe retorika e përgjithshme politike kundër medias, janë vetëm problemet më të fundit që janë shfaqur në skenën mediatike, por mbase janë më të dukshmet. Mungesa e një vizioni të qartë dhe të një politike të qëndrueshme mbi median nëpër vite, është një nga faktorët që ka sjellë këtë situatë. "Hartimi i politikave dhe legjisllacionit mbi median është zhvilluar pa ndonjë vizion apo strategji të qartë, por është drejtuar më shumë nga nevojat e momentit, dhe jo aq nga një vizion i përcaktuar mirë për zhvillimin e medias." (Londo 2014, 62) Zhvillimi i tregut dhe ambientit mediatik gjatë 28 viteve të fundit ka patur një sërë problemesh, duke përfshirë zhvillimin e çrregullt, një treg kaotik, praktika të dyshimta biznesi, struktura profesionale vetërregulluese të dobëta dhe të pazhvilluara, mungesë transparence, praktika klienteliste, dhe përqendrim gjithmonë e më të madh të pronësisë së medias në pak duar. Studimet rajonale të zhvilluara në vendet e Ballkanit perëndimor në vitin 2014 treguan se në Shqipëri integriteti i medias është i rrezikuar dukshëm nga shumë drejtime. "Ato përfshijnë mungesën e transparencës në financimin e medias dhe praktikatat e biznesit, radio televizion publik i dobët, si dhe dominimin e interesave politike dhe private mbi interesat publike në zhvillimin dhe zbatimin e politikave mediatike." (Londo 2014, 108)

Përgjatë viteve, organizatat që punojnë në fushën e medias kanë monitoruar, analizuar dhe identifikuar prirjet dhe problemet kryesore në lidhje me tabllonë mediatike në vend.¹³ Po kështu, mediat, organizatat mediatike, dhe

¹³ Instituti Shqiptar i Medias ka punuar për 20 vite në këtë fushë, duke zhvilluar studime mbi pronësinë në media, zhvillimet dhe prirjet në tregun mediatik, integritetin në media dhe profesionalizmin e saj, legjisllacionin në fushën e medias dhe politikatat mediatike, rolin e organizmave rregullatore dhe mediave publike, praktikatat vetërregulluese, marrëdhëniet e punës, etj. (shiko Çështje të integritetit në media, 2014, Mediat shqiptare dhe standardet evropiane, 2018, Studim mbi

autoritetet kanë debatuar herë pas here në lidhje me këto probleme, por është disi e vështirë që në këto diskutime të angazhohet edhe publiku, pasi zakonisht këto probleme konsiderohen si çështje të brendshme të profesionit. Për shembull, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2016, për të hequr kufizimet mbi pronësinë e mediave private kombëtare, krijoi hapësira për një përqendrim më të madh të pronësisë mbi median, por përveç ekspertëve të medias dhe palëve të angazhuara në proces, nuk kishte edhe shumë interes nga publiku në lidhje me këtë temë. Kjo nuk shihet si një çështje që ndikon direkt mbi shumicën e popullatës, ndryshe nga sa ndodhi me orvatjet për të mbyllur transmetimet në sinjalin analog në rrethin e Tiranës, në shtator 2018, gjë që solli një reagim të menjëhershëm nga njerëzit, pasi shumica e qytetarëve nuk ishte përgatitur për këtë ndryshim. Diçka e ngjashme ndodhi edhe në vitin 2018, kur televizionet më të mëdha private kërkuan që gjysma e fondeve që mblidheshin nga taksa e televizorit për llogari të radio televizionit publik të kalonin për llogari të televizioneve private, për të përmirësuar cilësinë e programeve. Edhe në atë rast nuk pati fare reagime nga ana e qytetarëve, megjithëse po çënoheshin fondet publike.

Këto raste janë vetëm disa nga shembujt që tregojnë nivelin e ulët të njohjes nga ana e qytetarëve të standardeve dhe rolit të medias në demokraci, si dhe mbi konfliktin midis interesave të tregut dhe interesave të publikut. Kjo situatë në lidhje me nivelin e edukimit të popullatës mbi median shpjegon deri diku mbështetjen e vakët të publikut në rastet e sulmeve kundër gazetarëve, apo mungesën e reagimit kundër propozimeve për ndryshime në ligj që çënojnë lirinë e shprehjes. Këto shembuj që përmendëm më lart, si dhe shumë raste të tjera, kur ka munguar përfshirja e publikut në çështje apo diskutime të lidhura me median, si dhe të dhëna nga studimet e mëparshme, nënvizojnë nevojën urgjente për një angazhim më serioz në edukimin e qytetarëve mbi median, veçanërisht në kuadër të ndikimit në rritje të rrjeteve sociale, si dhe sasisë shumë të madhe të informacioneve të pakonfirmuara që i serviren qytetarëve çdo ditë.

Në këtë drejtim, organizata të shoqërisë civile kanë ndërmarrë disa përpjekje sporadike për të edukuar qytetarët mbi median dhe informacionin, në varësi të kapaciteteve dhe strukturave të tyre, por përfshirja e autoriteteve publike në këtë proces do t'i jepte një shtysë të konsiderueshme këtyre lloj iniciativave. Kapitujt e mëposhtëm merren me qëndrimin e autoriteteve publike në këtë drejtim, duke u përqendruar në institucionet që mund të kenë ndikimin më të madh në këtë fushë, si institucionet arsimore dhe organizmat që merren me median.

statusin e gazetarëve, 2018, etj.) Edhe dega e BIRN në Shqipëri, dhe dega gjermane e Gazetarëve pa Kufij zhvilluan një studim monitorues në vitin 2018 mbi pronësinë në media, duke nënvizuar prirjen e përqendrimit në pak duar, dhe ndikimin e madh që ka një grup i vogël njerëzish në fushën e medias, megjithë numrin e madh të organeve të medias. Edhe organizata të tjera kanë zhvilluar studime dhe monitorime mbi çështje të ndryshme të lidhura me median, duke u munduar të rritin nivelin e ndërgjegjësimit mbi problemin e profesionalizmit.

3. Sistemi arsimor, politikat dhe praktikat në lidhje me edukimin mbi median

Nuk ka akoma politika apo dokumente zyrtare që përqendrohen tek edukimi mbi median dhe informacionin në Shqipëri. Ky koncept është akoma i panjohur dhe i pastudiuar në Shqipëri në tërësinë e tij. Elemente të këtij koncepti janë përfshirë në dokumente të politikave zyrtare, por nuk ka patur asnjëherë ndonjë debat publik, përpjekje, apo iniciativa që përqendrohen në mënyrë specifike në rolin e EMI-t në vend. Megjithëse politika dhe strategji zyrtare prekin aspekte të veçanta që mund të konsiderohen si pjesë të procesit të EMI-t, ky term nuk përmendet në asnjë nga këto dokumente zyrtare.

Politikat dhe praktikat ekzistuese të sistemit arsimor në vend e njohin rëndësinë e edukimit digjital, dhe kjo është pasqyruar edhe në kurrikulat e sistemit arsimor para-universitar, ku lënda TIK luan një rol të rëndësishëm. Nga ana tjetër, politikat e sistemit arsimor e injorojnë rëndësinë e njohjes të funksionimit të sistemit mediatik, dhe edukimin e qytetarëve mbi vlerësimin kritik të medias. Ky boshllëk njohurish nuk mbushet as në shkallët më të larta të sistemit arsimor, pasi edukimi mbi çështjet e medias është i destinuar vetëm për ata që studiojnë për gazetari dhe mësuesi. Kapitujt e mëposhtëm kanë për qëllim të përshkruajnë dhe analizojnë me hollësi politikat aktuale mbi EMI-n në sistemin arsimor para-universitar dhe në shkollat e larta.

3.1. Edukimi mbi median dhe informacionin: një proces i bazuar mbi TIK

Politikat zyrtare për edukimin mbi informacionin janë kushtëzuar nga një sërë faktorësh, si digjitalizimi teknik i shërbimeve, ndikimi i procesit të integritit në BE mbi formulimin e politikave, ndryshimet teknologjike dhe zhvillimi i infrastrukturës. Si rezultat i kësaj, përveç nevojës për të krijuar dhe përmirësuar shërbimet elektronike, politikat e qeverisë shqiptare janë përqendruar edhe mbi nevojën për të investuar në përmirësimin e aftësive të publikut për të përdorur këto shërbime të reja elektronike. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare ka vite që ka deklaruar si prioritet të saj digjitalizimin, ndërtimin e një shoqëri të mirëinformuar, dhe shoqërinë e informacionit, si për të patur një shoqëri më të hapur dhe më të zhvilluar, ashtu edhe për të nxitur zhvillimin ekonomik. Për shembull, një strategji e miratuar në vitin 2008 e vuri theksin mbi përfitimet e futjes të lëndës TIK në shkolla, por edhe mbi nevojën për të përmirësuar nivelin e njohurive të të gjithë popullsisë për akses dhe përdorim të informacionit dhe shërbimeve elektronike.¹⁴

Në këtë kuadër, i është kushtuar goxha vëmendje përfitimit nga ana e nxënësve të njohurive dhe aftësive mbi TIK, nëpërmjet futjes së kësaj lënde në kurrikulat e arsimit të detyrueshëm. Rëndësia që i kushtohet edukimit masiv të përdorimit të teknologjisë është përmendur edhe në ligjin për arsimin. Ligji aktual për arsimin para-universitar u aprovua në vitin 2012, dhe përcakton se politika zyrtare mbi arsimin para-universitar do të mbështeste një përqasje të bazuar në kompetenca. Ligji identifikon disa kompetenca që nxënësit duhet të përfitojnë gjatë arsimit para-universitar, duke përfshirë kompetencat digjitale, duke u marrë direkt me këtë element të rëndësishëm të edukimit mbi informacionin. Ky aspekt zhvillohet akoma më shumë nga Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Para-universitar 2014-2020. Në kapitullin ku shpjegohen vizionet, parimet, dhe prioritetet e politikave mbi arsimin para-universitar thuhet se

¹⁴ Këshilli i Ministrave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, *Strategjia Ndërsektorale për Shoqërinë e Informacionit, 2008-2013*. https://shteti-web.org/wp-content/uploads/2014/05/Information-Society-strategy_printed_version_en.pdf (Faqja u vizitua më 2 Dhjetor 2018).

“realizimi i këtij vizioni do të mundësojë sigurimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit... të përdorin teknologji të reja,”¹⁵ ndërmjet objektivave të tjera.¹⁶ Strategjia thotë se mënyra më e mirë për të arritur objektivat e mësimin të TIK-ut në shkolla është përmirësimi i infrastrukturës teknologjike në shkolla, si dhe zhvillimi i materialeve multimediale për kurrikulat, laboratorët lëvizës nëpër shkolla, dhe integrimi i TIK-ut në disa lëndë të kurrikulave shkollore.¹⁷

Ndërsa ligji dhe strategjia e arsimit para-universitar përcaktojnë objektivat kryesore të arsimit para-universitar, duke përfshirë edhe edukimin digjital, këto parime zhvillohen akoma më tej në kurrikulën bërthamë, dhe më saktësisht akoma në Kornizën Kurrikulare. Ashtu si dokumentet e tjera të politikave strategjike të qeverisë mbi arsimin, edhe Korniza Kurrikulare merret vetëm me aftësitë dhe edukimin digjital, dhe nuk përmend për asnjë moment ndonjë element të medias apo qëndrimin kritik ndaj informacionit në përgjithësi. Në fakt, në Kornizën Kurrikulare kompetenca digjitale përkufizohet si “përdorimi në mënyrë efikase dhe me sy kritik i TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë, dhe në komunikim. Këto kompetenca përfshijnë aftësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar, dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëvepruar me rrjetet e informacionit në internet.”¹⁸ Për këtë arsye, përjasja e përgjithshme e kurrikulës është hartimi dhe miratimi i subjekteve në kurrikula që mundësojnë dhe lehtësojnë përdorimin e teknologjisë nga nxënësit në kërkimin e informacionit, por nuk merret në mënyrë të posaçme me vetë informacionin. Politikat në këtë drejtim janë të nivelit elementar, dhe kanë si objektiv të pajisin nxënësit me aftësitë e nevojshme për përdorimin e teknologjisë, por nuk shkojnë më tej se kaq - drejt edukimit të nxënësve për të kuptuar dhe analizuar cilësinë e informacionit që u serviret nëpërmjet këtyre teknologjive.

Kurrikula bërthamë bazohet në Kornizën Kurrikulare, duke i zhvilluar më tej politikat dhe parimet e saj të përgjithshme në lëndë dhe subjekte konkrete, si dhe plane mësimore. Meqë Korniza Kurrikulare e konsideron TIK-un si një nga shtatë fushat kryesore të nxënies, dhe një nga prioritetet për brezin e ri dhe të gjithë popullin në përgjithësi, edhe kurrikula bërthamë ruan po atë nivel peshe dhe rëndësie që i jepet TIK-ut në kurrikulën e përgjithshme. Lënda e TIK u fut në shkolla në vitin 2007, për nxënësit nga klasa e shtatë deri tek klasa e 12-të. Aktualisht, sipas kurrikulës bërthamë të miratuar në vitin 2014, TIK-u si lëndë e detyrueshme fillon që në klasë të katërt, dhe është pjesë e kurrikulës deri në

15 Ministria e Arsimit dhe Sporteve, *Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014), http://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015-1.pdf (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

16 Ky është një element që theksohej edhe nga Strategjia për Arsimin, për vitet 2009-2013. Një nga prioritetet e strategjisë së mëparshme përmendte edhe përfshirjen e gjerë të TIK-ut në kurrikula, duke i mundësuar nxënësve përmirësimin e njohjes me TIK-un, dhe duke i bërë kështu më konkurrues në tregun e punës.

17 Po aty.

18 Po aty.

klasë të 12-të, pra deri në fund të arsimit para-universitar.¹⁹ TIK-u është në të njëjtën kategori në planet mësimore si lëndë e teknologjisë, ku të dyja këto lëndë zhvillohen me nga një orë në javë, duke përbërë së bashku 5.4 për qind të planit mësimor në programin e shkallës së tretë, dhe 3.2 për qind të planit mësimor për shkallën e katërt.²⁰ Në tetor 2018, ministrja e arsimit njoftoi se po mendohej që të ndryshohej kurrikula bërthamë, për të lejuar përfshirjen e lëndës të TIK akoma më herët në sistemin arsimor, që në klasë të dytë.²¹ Paralelisht me këtë ndryshim, u njoftua se një lëndë e re mbi shkrimin e kodeve kompjuterike mund të futej në shkolla për klasat e teta, duke përforcuar akoma më tej vëmendjen e politikave arsimore mbi TIK-un.²²

Sipas kurrikulës bërthamë, disa nga subjektet që duhet të përfshihen në lëndën e TIK-ut janë analiza e thelluar e të dhënave, motorët e kërkimit dhe gjetja e informacionit në internet, njohuri elementare të gjuhës së programimit, paraqitja grafike si pjesë komunikimi, etj.²³ Disa nga kompetencat kryesore, që pritet të zhvillohen nga nxënësit, përfshijnë hartimin e përmbajtjes së publikimeve në internet në forma të ndryshme multimediale, përhapjen e informacionit dhe përmbajtjes, angazhimin në aktivizëm qytetar online, bashkëpunim dhe bashkëveprim nëpërmjet kanaleve digjitale, kërkimi dhe filtrimi i informacionit, etj.²⁴

Po kështu, infrastruktura teknologjike për zhvillimin e lëndës TIK është përmirësuar, por mbetet akoma shumë për të bërë.²⁵ Sipas Strategjisë Axhenda Digjitale, raporti kompjuter-nxënës ndryshon nga shkolla në shkollë, por është pak a shumë 1 me 27, dhe në disa raste raporti është edhe më i lartë se kaq.²⁶ Të dhënat për vitin 2016 tregojnë një përmirësimin të lehtë, ku raporti është ulur në 1 kompjuter për 25 nxënës²⁷, por duhet të përmirësohet akoma

¹⁹ Plani mësimor i lëndëve, 2014, mund të lexohet tek: <http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Plani-Mesimor-1-9-2014-Kurrikula-Re.pdf> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

²⁰ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014). <http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

²¹ Fjala e ministres së arsimit Lindita Nikolla: "Edukimi Digjital në Arsimin Para-Universitar", 2 Tetor 2018. <http://arsimi.gov.al/edukimi-digjital-ne-arsimin-para-universitar/> (Faqja u vizitua më 23 Dhjetor 2018).

²² Po aty.

²³ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Korniza Kurrikulare e Arsimit Para-universitar.

²⁴ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, *Programi i lëndës TIK, shkalla e tretë, klasa 6 dhe 7* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit, 2014). http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/09/Prog_TIK_Shkalla-3_shtator-2015.pdf (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

²⁵ Strategjia aktuale për arsimin para-universitar pranon se "megjithë investimet e bëra, përdorimi i TIK-ut në institucionet arsimore mbetet i kufizuar. Pajisjet sigurohen zakonisht nëpërmjet fondeve publike, por në disa raste të veçanta edhe nëpërmjet kontributeve të sektorit privat. Sipas Strategjisë, në shumicën e rasteve, pajisjet nuk përdoren si duhet, apo janë me defekt. Shkollat e sistemit arsimor publik raportojnë se kanë 15,731 kompjuterë, nga të cilët vetëm 11,331 funksionojnë. Po kështu ka edhe 1,631 laptopë nëpër shkolla, por 432 prej tyre janë me defekt.

²⁶ Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, *Strategjia Ndërsëktoriale "Axhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020"*.

²⁷ AKSHI – monitorim i planit të veprimit për Strategjinë Axhenda Digjitale, 2016.

më shumë. Një tjetër problem serioz ka të bëjë me faktin se jo të gjithë laboratorët dhe klasat ku zhvillohet mësimi i lëndës TIK janë të lidhura me internetin, që është një faktor themelor për zhvillimin e suksesshëm të kësaj lënde. Në fakt, ky problem pranohet edhe nga Strategjia Ndërsektoriale "Akhenda Digjitale e Shqipërisë", që thotë se më shumë se një e treta e shkollave ka probleme me lidhjen në internet.²⁸ Këto probleme themelore, megjithëse ka patur përmirësime të lehta, krijojnë pengesa serioze në zhvillimin me sukses të lëndës TIK. Një artikull investigativ i studentëve të gazetarisë vuri në dukje problemet në zbatimin e një projekti për krijimin e klasave inteligjente në 120 shkolla, nëpërmjet përdorimit të tableteve të lidhura me njëra-tjetrën në klasa, por një nga problemet ishte mungesa e lidhjes me internetin në shkolla.²⁹

Përveç kësaj, një pengesë kryesore me lëndën e TIK-ut është edhe hendeku i njohurive ndërmjet brezave të ndryshëm - midis mësuesve dhe nxënësve - në lidhje me këtë subjekt, dhe duket se trajnimi i mësuesve në këtë drejtim nuk ka qenë i mjaftueshëm deri tani. Sipas strategjisë për arsimin para-universitar, mësuesit duhet të marrin 18 orë trajnim në vit.³⁰ Sidoqoftë, duket se në praktikë lënda TIK nuk është po aq prioritet sa thuhet në letër. "Shpesh kjo lëndë jepet nga mësues që kanë patur një trajnim afatshkurtër, dhe janë diplomuar në fusha të tjera, si fizikë apo matematikë, dhe kjo shihet si një mënyrë për të përmbushur orët e mësimin që duhet të plotësojë një mësues. Trajnimi i mësuesve pa dyshim që çalon apo nuk zhvillohet fare, si për lëndën TIK ashtu edhe në edukimin mbi median."³¹ Në fakt, si mësuesit³² ashtu edhe nxënësit duket se e konfirmojnë problemin që kanë mësuesit herë pas here me përdorimin e teknologjisë, pasi ka raste kur kërkojnë ndihmë nga nxënësit gjatë zhvillimit të mësimin.³³ Së bashku me planin për të nisur lëndën TIK në klasa më të ulëta, dhe fillimin e klasave provë për kodet kompjuterike, ministrja e arsimit gjithashtu njoftoi për kurse paralele trajnimi për 470 mësues të TIK-ut.³⁴ Megjithëse është e vërtetë se ka ambicie të mëdha nga sistemi arsimor në lidhje me TIK-un në nivel strategjie, zbatimi i saj në praktikë ka hasur në pengesa të shumta, si nga mangësitë në infrastrukturë ashtu edhe si rezultat i problemeve me trajnimin e mësuesve.

28 Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, *Strategjia Ndërsektoriale "Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020"*.

29 Nevila Dosti dhe Enkel Xhangoli, "3.5 milionë euro për klasat inteligjente pa internet," Pse, 3 Prill 2017. <http://pse2017.com/3-5-milione-euro-per-klasat-inteligjente-pa-internet/> (Faqa u vizitua më 2 Janar 2019).

30 Ministria e Arsimit dhe Sporteve, *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Para-universitar 2014-2020*.

31 Erida Koleci, specialiste, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, intervistuar më 30 Korrik 2018.

32 Top Channel TV, "Mësim me tablet, projekti në pak shkolla. Fondi është përdorur i gjithi", 12 Maj 2018. <http://top-channel.tv/2018/05/12/mesim-me-tablet-projekti-ne-pak-shkolla-fondi-eshte-perdorur-i-gjithi/> (Faqa u vizitua më 3 Janar 2019).

33 Dosti dhe Xhangoli, "3.5 milionë Euro për klasa inteligjente pa internet".

34 Fjala e ministres së arsimit Lindita Nikolla.

3.2. Elemente të EMI-t në lëndë të tjera: një përpjekje e pamjaftueshme

TIK është bërë pjesë e kurrikulës bërthamë si lëndë e veçantë dhe e detyrueshme, dhe elemente të saj janë përfshirë edhe në lëndë të tjera, ndërsa nuk ka akoma ndonjë pjesë specifike të kurrikulës që merret me kritikën e informacionit nga këndvështrimi i edukimit mbi median dhe informacionin. Ka pak elemente të saj në shpërndara në lëndë të caktuara, veçanërisht në lëndën e qytetarisë, që i përkushtohen analizimit të teksteve në media, zhanreve të saj, si dhe të qenit në gjendje që të gjykosh mbi to. Për shembull, programi i lëndës së qytetarisë për klasën e dhjetë, që është një lëndë e detyrueshme për nxënësit e asaj klase, merret edhe me të drejtën për informacion, si dhe ligjin për median.³⁵ Programi mësimor sugjeron që të zhvillohen gjashtë orë mësimi mbi këto tema, ndërkohë që e gjithë lënda zhvillohet gjatë 70 orëve mësimi për një vit shkollor.

Nga një analizë e temave dhe kapitujve të shpërndara në lëndën e qytetarisë, vihet re se i kushtohet një vëmendje shumë e madhe legjisllacionit, kushtetutës, dhe të drejtave të njeriut (respektivisht nga gjashtë, pesë, dhe dhjetë orë mësimi, nga një total prej 70 orësh për të gjithë lëndën). Sidoqoftë, vetëm një pjesë e vogël e këtyre orëve i dedikohet lirisë së shprehjes, ndërsa të drejtave të tjera dhe legjisllacionit i kushtohet më shumë vëmendje. Pjesa shoqëruese e planeve mësimore për kapitullin e informacionit është disi më e detajuar, dhe fillon me këtë premisë të përgjithshme: “Informacioni është thelbësor për çdo shoqëri demokratike. Është një e drejtë dhe detyrim. Ai është pushtet, dhe për këtë arsye shpesh herë përdoret në mënyrë të padrejtë, në dëm të interesave të individëve, grupeve ose shoqërisë.

³⁵ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit. *Kurrikula bërthamë lënda: qytetari klasa: X* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, 2016). <http://izha.edu.al/Biblioteka/3Programe%20Lendore/4Programet%20e%20Arsimit%20te%20Mesem%20Kurrikula%20e%20re/Programet%20e%20klases%20se%2010/Programet%20e%20Klas%C3%ABs%20s%C3%AB%20X,%20Kurrikula%20B%C3%ABrtham%C3%AB/Qytetari.pdf> (Faqja u vizitua më 15 Dhjetor 2018).

Si i tillë ai duhet të jetë vazhdimisht në qendër të shikimit kritik.³⁶ Ky përkufizim duket se është në linjë me parimet e EMI-t, pasi përmend në mënyrë të veçantë nevojën për ta kuptuar plotësisht median dhe për ta analizuar përmbajtjen e saj, duke evituar kështu marrjen si të mirëqenë të asaj që serviret si informacion.

Problemi është se kur kalohet në analizimin e temave të sugjeruara në program, vihet re se premisa hyrëse nuk përfaqësohet me aq forcë dhe e humbet tonin e saj. Sipas programit të sugjeruar për lëndën qytetari, njohuritë që duhet të përfitojnë nxënësit përfshijnë elemente mbi mjetet e informacionit, llojet e ndryshme të mediave, mitet e TV, etj. Temat e tjera që u sugjerohen mësuesve lidhen më shumë me të drejtën për informim, parime të përgjithshme, dhe legjislacionin ekzistues, duke përfshirë edhe disa nga problemet dhe rreziqet e reja që vijnë veçanërisht nga marrja e informacionit në internet. Disa nga këto tema janë televizioni dhe ligji për minorenët, parime të përgjithshme mbi të drejtën për informim në legjislacionin shqiptar, e drejta për informim, legjislacioni mbi median e shkruar dhe elektronike, abuzimi me të drejtën e informimit, rreziqet e mundshme, etj.³⁷ Në përgjithësi, temat e sugjeruara për mësuesit lidhen më shumë me parime të përgjithshme dhe të drejtat ligjore për informim, dhe përqendrohen më pak mbi lirinë e shprehjes dhe pengesat e mundshme në këtë drejtim. Po kështu, kapitulli i informacionit i kushton një vëmendje shumë herë më të madhe paralajmërimeve për rreziqet ndaj të miturve nga media dhe interneti, dhe flitet shumë pak mbi rrezikun që mund t'i kanoset vetë lirisë së shprehjes, apo ndërgjegjësimit të qytetarëve për problemet e interesit publik dhe medias. Në këtë drejtim, duket se programi i lëndës tenton më shumë që të paralajmërojë nxënësit për rreziqet dhe abuzimet e medias, dhe jo t'i mësojë ata se si të mbajnë një distancë të kujdesshme nga media dhe si ta analizojnë atë me sy kritik.

Përveç udhëzimeve të përgjithshme për programin e lëndës së qytetarisë nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, ka gjithashtu edhe tre tekste shkollorë³⁸ të miratuara nga Ministria e Arsimit për vitin shkollor 2018-2019, dhe mësuesit mund të përzgjedhin një prej tyre. Një analizë e kapitullit mbi informacionin, në tekstet për mësuesit që shoqërojnë këto publikime, tregojnë se vëmendja kryesore është mbi legjislacionin dhe rolin e përgjithshëm të medias në shoqëri, nga njëra anë, dhe njohjes me pasojat negative që mund të ketë media mbi minorenët, nga krahu tjetër. Për shembull, një nga tekstet për mësuesit rreshton kompetencat që duhet të përfitojnë nxënësit deri në fund të vitit shkollor: “Zhvillimin e aftësive mediatike për identifikimin e burimit të informacionit, dhe këndvështrimin analitik për gjykimin

³⁶ Po aty.

³⁷ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit. *Kurrikula bërthamë lënda: qytetari klasa: X.*

³⁸ Tekstet shkollorë janë publikuar nga shtëpitë botuese Albas, Pegi, dhe Erik.

e tyre, si dhe të përcaktojë burimet dhe vërtetësinë e informacionit digjital" (Çelçima s. a., 21). Po kështu, nxënësi duhet të jetë në gjendje që gjatë orës së mësimi të "filtrtojë dhe gjejë informacion online, të zgjedhë midis burimeve më efektive të informacionit, dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin." (Çelçima s. a., 24). Këto kompetenca duket se janë shumë pranë me përkufizimin e edukimit mbi median, dhe vlerësimin në mënyrë kritike të informacionit të marrë nga media.

Megjithatë, po t'i hedhim një sy paraqitjes më të detajuar të temave që propozohen për orë të veçanta mësimi kushtuar medias dhe informacionit, vëmendja duket se kalon drejt gjërave të tjera që nuk kanë lidhje direkte me analizën kritike të përmbajtjes mediatike, apo sjelljes së medias. Ka tre subjekte kryesore që duhet të zhvillohen nga mësuesit gjatë orëve të mësimi për të tre tekstet: të drejtën për informacion, legjisllacioni dhe rregullimi i punës së medias, dhe mbrojtja e minoreneve nga media. Kapitulli mbi legjisllacionin e medias udhëzon mësuesit mbi mënyrën e shpjegimit të garantimit të lirisë së medias nga kushtetuta, dhe marrëveshjet apo rezolutat ndërkombëtare, si Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shtuar edhe disa thënie të përgjithshme mbi rëndësinë e rolit të medias në demokraci. Në të njëjtën kohë, edhe tekstet shkollore për nxënësit dhe mësuesit përmendin faktin se mund të ketë abuzime nga ana e medias me informacionet që përçojnë tek publiku, megjithëse ato duhet të jenë të paanshme dhe objektive. Por këto tekste nuk arrijnë dot që të japin udhëzime mbi mënyrën e identifikimit të njëanshmërisë në media, si të filtrohet informacioni duke u bazuar tek besueshmëria e burimit, apo as si të dallohen elemente të veçanta që tregojnë për probleme të mundshme në raportim. Në këtë aspekt, vëmendja shumë e madhe që i kushtohet legjisllacionit mbi median duket se i ngarkon së tepërmi nxënësit me informacione që mbase nuk janë edhe aq të nevojshme për ta, në krahasim me diskutimin mbi vërtetësinë apo objektivitetin e lajmeve që dëgjojnë çdo ditë. Po kështu, meqë mësuesit nuk kanë marrë ndonjë trajnim të veçantë në lidhje me edukimin mbi median,³⁹ është e paqartë sa të përgatitur janë për të folur mbi legjisllacionin mbi median, një temë që edhe vetë disa gazetarë nuk e njohin shumë mirë.

Një prirje tjetër, që vihet re në të tre tekstet e marra në shqyrtim, është vëmendja e veçantë që i kushtohet të drejtës për informim në një kapitull që duhet të fliste për median dhe rolin e saj në shoqëri. Në fakt, për disa orë mësimi teksti orientues fillon me temën e medias, apo legjisllacionit mbi median, dhe gati përherë përmbajtja e materialit, dhe orientimi i mësuesve, kalon tek e drejta për informim. Për shembull, në një nga këto tekste, tema e një prej orëve të

39 Erida Koleci, intervistë më 30 Korrik 2018.

mësimit është legjislati shqiptar dhe ndërkombëtar mbi median dhe informacionin, ku pikat kyçe janë ligji mbi të drejtën për informim, koordinatori për të drejtën e informimit, dhe komisioneri për informimin (Dosti, Lila dhe Bozhani 2016). Ato fokusohen mbi rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale, dhe rëndësinë e të qenit i mirëinformuar në një shoqëri demokratike. Megjithatë këto tekste vetëm sa e përmenden rrallë ndryshimin midis të drejtës ligjore për t'u informuar mbi dokumenta zyrtare, dhe të drejtës themelore për lirinë e shprehjes dhe shtypit të lirë në një shoqëri demokratike, në shumicën e rasteve termi "e drejta për t'u informuar" nuk shpjegohet me hollësi për nxënësit. Në këtë këndvështrim, ekziston rreziku që ky term të përdoret për t'u referuar të gjithë volumit të informacionit që vjen drejt nesh, në vend që të shpjegohet në mënyrë të qartë se kjo është një e drejtë kushtetuese e të gjithë qytetarëve për të siguruar një qeverisje të përgjegjshme, dhe kjo nuk duhet ngatërruar me të drejtën e marrjes informacion nga media. Përfshirja e të drejtës për informim në një kapitull që duhet të fliste për informacione që vijnë nga burime të jashtme, dhe jo nga dokumente e institucione publike, tregon se këto tekste vetëm sa e prekin në mënyrë sipërfaqësore këtë problem, dhe nuk arrijnë dot që të nxjerrin në pah ndonjë ide konkrete se çfarë duhet të bëjnë qytetarët për të analizuar informacionet që u serviren çdo ditë.

Së fundmi, të treja këto tekste supozojnë në një farë mënyre se media, dhe veçanërisht interneti, shkaktojnë dëm tek fëmijët, dhe duhet që ata të jenë të përgatitur për të shmangur këto rreziqe. Kështu për shembull, në kapitullin mbi informacionin për minorenët, në një nga tekstet për mësuesit, përmenden disa probleme: "mungesa e mbikqyrjes prindërore mbi këto kanale dhe mënyra informimi, informacion i pamjaftueshëm nga ana e të rinjve, akses në informacion të saktë dhe të pamanipuluar, etj." (Tabaku dhe Hoxha s. a., 118). Për më tepër, kur analizohen problemet e lidhura me burime të ndryshme informacioni, përmenden disa nga këto çështje, si: "ato nuk kontrollohen nga prindërit për të evituar përdorimin e përmbajtjes së papërshtatshme për fëmijët; shikimi i këtyre programeve ka një efekt të qartë negativ mbi ta; dhe fëmijët manipulohen me lehtësi, dhe kalojnë në imitimin e sjelljeve negative që shohin në këto kanale, etj." (Tabaku dhe Hoxha s. a., 118). Duket qartë se tekstet përqendrohen mbi efektet negative që mund të kenë mediat dhe interneti mbi fëmijët, dhe duket se e shohin zgjidhjen e problemit tek kontrolli dhe kujdesi prindëror. Librat udhëzues nuk sugjerojnë metoda apo ushtrime për të trajnuar fëmijët në përdorimin e sigurt të internetit apo medias, ndërkohë që zhvillimi i aftësive të tyre analitike do t'u japë mundësi që të filtrojnë dhe shmangin aspektet negative të medias. Po kështu, kapitujt që flasin për mbrojtjen e minorenëve duket se e vënë theksin vetëm mbi efektet negative mbi fëmijët, ndërkohë që nuk ka dyshim se me orientimin e duhur, interneti dhe informacioni mund të kthehen në mekanizma të vyer në shërbim të nxënësve për të thelluar njohuritë e tyre mbi botën që i rrethon.

3.3. Rasti i universiteteve: një mundësi e pashfrytëzuar për futjen e edukimit mbi median dhe informacionin në arsim

Arsimimi në universitetet publike në lidhje me edukimin mbi median dhe informacionin në Shqipëri është aktualisht i rezervuar për studentët e departamenteve të gazetarisë në universitetet e Tiranës, Elbasanit, dhe Shkodrës, si dhe për studentët që diplomohen në shkencat e informacionit. Është e vështirë të gjesh lëndë që kanë lidhje me edukimin mbi median, në morinë e lëndëve të detyrueshme apo me zgjedhje të degëve apo fakulteteve tona.⁴⁰ Degët me zgjedhje që ofrohen nëpër shkolla të larta përfshijnë shkrimin akademik, gjuhë të huaja, studime gjinore, politika ekonomike, madje dhe edukatë fizike. Megjithëse materialet mediatike konsumohen çdo ditë nga studentët dhe nga e gjithë popullata, dhe megjithë përhapjen shumë të gjerë të mediave sociale, nuk vihet re ndonjë përpjekje për të përfshirë si lëndë të detyrueshme, apo me zgjedhje, njohuritë themelore, njohjen e mirë, dhe analizimin e medias. Edhe programet mësimore të shkencave sociale, që janë më afër se degët e tjera me çështjet e medias, nuk kanë ndonjë lëndë që përfshijnë elemente të edukimit mbi median në kurrikulat e tyre. I vetmi përjashtim janë kurset e komunikimit publik, por edhe ato kanë të bëjnë më shumë me të folurën në publik, se sa me analizimin e përmbajtjes mediatike, apo faktorët e ndryshëm që duhet të njohin studentët dhe publiku në lidhje me median dhe aspekte të ndryshme të informacionit. Kjo përkon me mungesën e politikave publike për promovimin e edukimit dhe analizimin kritik të medias, dhe kjo vjen kryesisht si pasojë e mungesës së traditës në këtë fushë.

Në lidhje me degët e specializuara që lidhen direkt me EMI-n, si gazetaria, arsimimi zyrtar kryhet në degët e universiteteve publike në Tiranë, Elbasan, dhe Shkodër, ndërsa universitetet private ofrojnë vetëm diploma në

40 Informacione nga kurrikula të botuara nga departamente të Universitetit të Tiranës, mund të gjenden tek: <http://www.unitir.edu.al/> (Faqja u vizitua më 4 Janar 2019).

shkencat e komunikimit. Departamenti i gazetarisë në universitetin publik të Tiranës ka bërë shumë ndryshime në kurrikulat e veta. Sistemi i diplomave katërvjeçare është ndryshuar, dhe është kaluar në një sistem diplomimi me dy nivele, sipas procesit të Bolonjës. Diploma e nivelit të parë (bachelor) jepet për tre profile gazetarie: gazetari sociale/kulture, gazetari politike, dhe gazetari ekonomike.⁴¹ Edhe diplomat e nivelit të dytë ofrojnë mundësi që të kalohet në profile akoma më të specializuara gazetarie. Profilet që ofrohen janë marrëdhëniet me publikun, marketing në media, administrim media, gazetari evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe komunikimi ndërkulturor. Ndërkohë që diplomat e nivelit të parë përqendrohen më shumë në gazetarinë profesionale, nga katër specializimet që ofrohen nga diplomat e nivelit të dytë, vetëm njëra lidhet me gazetarinë, ndërsa të tjerat merren me marketing dhe marrëdhënie me publikun, duke e vënë theksin kryesisht mbi komunikimin, dhe jo gazetarinë.

Mëgjithëse në fillimin e viteve 1990 gazetaria ishte profesioni i preferuar për shumë studentë, duket se popullariteti i tij ka rënë. Një sondazh i zhvilluar në vitin 2016 me studentë gazetarie në vend zbuloi se vetëm 33.8 për qind e tyre e konsideronte gazetarinë si punë ideale; 30 për qind e tyre kishte zgjedhur gazetarinë si fushë që krijonte mundësi për angazhim shoqëror dhe politik, ndërsa 12 për qind e studentëve e kishte zgjedhur këtë degë për famën dhe popullaritetin që mund të fitosh nga profesioni (Godole dhe Karcanaj 2016). Këto shifra tregojnë edhe për njëfarë zhgënjimi me median midis të rinjve, dhe një dëshirë të vogël për t'u angazhuar në këtë profesion.

I njëjti sondazh tregoi se studentët ishin në përgjithësi të kënaqur në anën teorike të studimeve në gazetari, por disa prej tyre prisnin që të punohet më shumë me aspektin praktik të punës gazetareske. Ndërsa 43.9 për qind e studentëve tha se kishte një ekuilibër të mirë midis teorisë dhe praktikës, një pjesë tjetër prej 52 për qind e studentëve, në shumicën e këtyre fakulteteve, thanë se nuk kryeshin ushtrime praktike (Godole dhe Karcanaj 2016).

Arsyet për këtë pikë të dobët në punën e degëve të gazetarisë në universitetet publike, duket se kanë të bëjnë me mungesën e paisjeve dhe kushtet për zhvillimin e mësimin, si dhe mungesën e organizimit të kurseve praktike të studentëve në organe të medias. Sondazhi tregoi se 41 për qind e studentëve të gazetarisë ishin të kënaqur me pajisjet për punë praktike në fakultet, ndërsa pjesa tjetër prej 49 për qind tha se e kishin patur të vështirë që të

41 Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, plani mësimor i departamentit të gazetarisë 2013-2016, mund të gjendet tek: <https://www.fhf.edu.al/plani-mesimor-ne-gazetari/> (Faqja u vizitua më 4 Janar 2019).

përdornin paisje teknike për punë praktike (Godole dhe Karcanaj 2016). Sidoqoftë, kur vjen puna tek praktika në media, ka një kufi të asaj që mund të arrihet në laboratorët e shkollave, pavarësisht nga gjendja e tyre teknike. Problemi kryesor duket se është paaftësia e fakulteteve për të arritur një marrëveshje afatgjatë me organet e mediave, ku studentët të mund të punojnë si kursantë apo punonjës me kohë të pjesshme. Megjithëse shumë studentë e bëjnë që tani këtë gjë, kjo është arritur me anë të iniciativave personale, dhe jo në nivel institucional. Kjo është një dobësi që është nënvizuar në rekomandimet e dhëna në bazë të rezultateve të këtij sondazhi të zhvilluar me studentë gazetarë në vitin 2016: "Në bazë të informacioneve të mbledhura nga studentët, ka nevojë urgjente për të ngritur një bashkëpunim midis institucioneve arsimore dhe mediave lokale" dhe "ka nevojë për më shumë punë praktike" (Godole dhe Karcanaj 2016). Në vitin 2015, Departamenti i Gazetarisë nënshkroi një marrëveshje me entin rregullator, Autoritetin e Mediave Audiovizive, për të mundësuar punë praktike të studentëve të gazetarisë pranë entit rregullator.⁴² Megjithëse ky është një hap në drejtimin e duhur, nuk ka dyshim se duhet bërë më shumë punë në këtë aspekt, pasi puna praktike në një ent rregullator të medias nuk të jep po ato aftësi që mund të fitosh gjatë një kursi praktik në një redaksi të mirëfilltë lajmesh.

Përveç përgatitjes së gazetarëve të ardhshëm, Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës organizon rregullisht studime dhe takime akademike, zakonisht në mënyrë të përvitshme. Megjithëse këto janë takime që përfshijnë grupe të caktuara brenda profesionit, si akademikë, rregullatorë të medias, redaktorë dhe gazetarë, ato përsëri japin kontributin e tyre në pasurimin e informacionit në lidhje me situatën në media. Temat e konferencave të mëparshme kanë qenë diskutime në lidhje me efektet e digjitalizimit në fushën e medias, perceptimin e publikut mbi punën e radio televizionit publik, të ardhmen e profesionalizmit në media, etj. Prezantimet e bëra në këto konferenca janë përmbledhur dhe publikuar. Sidoqoftë, kontributi i departamentit në këto aktivitete mbetet i kufizuar brenda të njëjtit grup njerëzish, pa e zgjeruar rrethin me përfshirjen e një grupimi më të madh të publikut. Kështu, Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës mbetet i kufizuar në punën e vet për arsimimin e studentëve të gazetarisë, dhe fokusi i punës së tyre mbeten vetëm studentët, por mungon angazhimi në aktivitete të tjera që mund të shërbejnë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit në publik mbi EMI-n, apo probleme kyçe që ndikojnë mbi zhvillimin e medias.

42 Artikull mbi nënshkrimin e marrëveshjes midis degës së gazetarisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, "AMA dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit nënshkruajnë marrëveshjen për praktikën studentore", 20 Nëntor 2015. <http://ama.gov.al/2015/11/20/ama-dhe-departamenti-i-gazetarisë-dhe-komunikimit-nëshkruajnë-marrëveshjen-per-praktikën-studentore/> (Faqja u vizitua më 26 Dhjetor 2018).

Kjo është një prirje e të gjithë sistemit të universiteteve publike në vend. Nuk ka traditë të iniciativave ekstrakurrikulare për të krijuar lidhje dhe bashkëpunim midis mësuesve, studentëve, dhe grupeve të tjera të popullatës për fusha të ndryshme studimi. Kjo mbase ka të bëjë me botëkuptimin e ngushtë të arsimit, si një proces që ndodh vetëm brenda mureve të shkollës, që ka qenë në fakt edhe baza e të gjithë sistemit arsimor shqiptar. Në të njëjtën kohë, shkollave të larta nuk u kërkohet që të përshijnë në politikat dhe programet e tyre angazhimin e pedagogëve në punë apo projekte ndërgjegjësuese me masën e gjerë të publikut jashtë ambienteve të fakultetit. Ka edhe pedagogë që janë aktivë dhe shfaqen vazhdimisht në debate publike, dhe publikojnë punët e tyre në media, por sidoqoftë, kjo është thjesht një zgjedhje individuale e tyre, dhe nuk vjen nga udhëzime, detyra, apo ndonjë traditë institucionale. Për pasojë, edhe kontributi i universitetit në njohjen e popullatës me median duket se mbetet i kufizuar tek shfaqja në publik e pedagogëve të veçantë, dhe nuk kemi akoma një përjasje të planifikuar dhe të koordinuar në këtë drejtim.

4. Institucione publike të mediave që mund të luajnë rol tek EMI

Meqë edukimi mbi median dhe informacionin është një koncept relativisht i ri në Shqipëri, ai nuk është bërë akoma pjesë e vëmendjes së institucioneve publike që lidhen me median dhe informacionin. Miratimi i ligjeve dhe rregulloreve, si dhe krijimi i institucioneve rregullatore nuk janë shoqëruar me përpjekje dhe diskutime publike mbi nevojën e zhvillimit të edukimit mbi median. Si rezultat, institucioneve kryesore që merren me median dhe informacionin nuk u është caktuar me ligj ndonjë rol specifik në lidhje me këtë fushë. Gjatë këtyre dy viteve të fundit ka patur disa përpjekje për një pjesëmarrje më aktive në këtë drejtim, megjithëse këto iniciativa nuk janë angazhime afatgjata apo përpjekje të koordinuara midis faktorëve të ndryshëm. Kapitulli i mëposhtëm përshkruan rolin, kompetencat, dhe iniciativat në lidhje me EMI-n nga këto institucione publike, në veçanti Autoriteti i Mediave Audiovizive, dhe Radio Televizioni Shqiptar.

4.1. Autoriteti i Mediave Audiovizive

Pengesa e parë dhe kryesore për punën e entit rregullator, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në fushën e EMI-t është mungesa e kërkesës nga ana e ligjeve dhe rregulloreve që promovimi i edukimit mbi median të jetë një nga kompetencat apo detyrat e këtij enti. Në fakt, termi edukimi mbi median dhe informacionin nuk përmendet në asnjë dokument politikash apo legjislacioni, duke treguar edhe njëherë përfshirjen shumë të vonuar në debatin publik të këtij termi, si dhe mungesën e përgjithshme të këtij nocioni nga vizioni i politikave mbi median dhe arsimin në vend. AMA është enti rregullator i mediave audiovizive në vend, dhe funksionon si një organizëm ligjor publik i pavarur, që është krijuar pas miratimit të ligjit mbi mediat audiovizive. Ligji rendit një numër të madh kompetencash për këtë autoritet, por nuk i ka caktuar ndonjë rol të veçantë në lidhje me EMI-n. Meqë nuk ka ndonjë detyrim ligjor në këtë fushë, është e kuptueshme se prioriteti kryesor i këtij institucioni është përmbushja e detyrave të caktuara me ligj, dhe jo angazhimi me tema që nuk janë misioni i saj.

Megjithëse ky ent rregullator nuk e ka zyrtarisht për detyrë që të angazhohet me edukimin mbi median, disa aspekte të punës së tij e kanë shtyrë që ta luajë pjesërisht këtë rol. Aspekti i parë i angazhimit në lidhje me edukimin mbi median është mbledhja e ankesave nga publiku, që është një sektor më vete brenda këtij institucioni, për ruajtjen e normave etike dhe standardeve profesionale në mediat audiovizive. Me ligj, Këshilli i Ankesave funksionon si pjesë e AMA-s. Këshilli ka tre anëtarë me eskperiençë në fushën e medias dhe etikës, që zgjidhen nga Bordi i AMA-s. Anëtarët e këshillit kanë për detyrë që t'i kthejnë përgjigje ankesave që vijnë nga publiku, të justifikojnë pranimin apo refuzimin e ankesave, në bazë të Ligjit për Mediat Audiovizive si dhe të Kodit të Transmetimit të miratuar nga AMA.

Këshilli i Ankesave u krijua në vitin 2016, dhe dy nga anëtarët e tij u rizgjodhën për një mandat të dytë në vitin 2018. Këshilli i kthen përgjigje ankesave të qytetarëve, duke paraqitur bazën ligjore për vendimin e marrë në lidhje me

ankesën, dhe sqarimet e nevojshme për pranimin apo refuzimin e ankesës. Në këtë kontekst, mundësimi i ankesave nga ana e qytetarëve, dhe marrja përgjigje nga një autoritet publik mbi vërejtjet e tyre mbi median, është një mënyrë për edukimin e publikut me rregullat e punës së medias, në lidhje me çfarë quhet sjellje etike dhe çfarë jo.

Këshilli i Ankesave shqyrton kërkesa dhe vërejtje që vijnë edhe nga shoqata jo-fitimprurëse, apo organizma private, në lidhje me ndonjë material në media që mund të përbëjë shkelje të dinjitetit njerëzor, apo të cënojë të drejtat e njeriut. Ai funksionon si ndërmjetës midis publikut dhe medias, dhe në këtë proces luan një rol sado të vogël në edukimin e popullatës, me mbledhjen e ankesave nga publiku dhe analizimin e shkeljes së rregullave etike gjatë raportimit në media.

Gjatë këtyre viteve pune, Këshilli i Ankesave ka marrë 24 ankesa në vitin 2016; viti më pas arriti pikun me 33 ankesa, ndërsa më pas, në vitin 2018, ky numër u përgjysmua, me 15 ankesa.⁴³ Nuk ka ndonjë arsye pse të mendojmë se niveli i profesionalizmit në media u përmirësua ndjeshëm në vitin 2018, dhe si pasojë e kësaj të jetë ulur edhe numri i ankesave. Përpjekje të mëparshme, për të krijuar mekanizma vetë-rregulluese që të reagonin ndaj ankesave të qytetarëve për shkrimet në gazeta, nuk sollën thuajse asnjë reagim nga lexuesit, pasi ata preferonin më mirë të merreshin direkt me autorin e shkrimit, se sa të kalonin nëpër procesin formal të dërgimit të ankesave me e-mail. Po kështu, një mungesë njohjeje, besimi, apo edhe mungesë rezultatesh konkrete pas ankesave të bëra në drejtim të medias, mund të jenë disa nga arsyet për rënien e numrit të ankesave në drejtim të Këshillit të Ankesave. Për më tepër, sipas ankesave të publikuara nga këshilli, del se shumica e tyre kanë ardhur nga agjenci shtetërore që merren me të drejtat e fëmijëve, apo nga OJQ, megjithëse ka patur disa ankesa edhe nga qytetarë të thjeshtë,⁴⁴ çka sugjeron se mbase jo shumë qytetarë janë në dijeni se ekziston mundësia e ankimit për shkeljen e etikës nga mediat audiovizive. Në fakt, niveli i ulët i angazhimit qytetar në vend, preferenca për të evituar kanalet zyrtare dhe t'i rënë shkurt duke kontaktuar direkt me median, dhe veçanërisht shfryrja e inatit në rrjetet sociale, duhen marrë në konsideratë si faktorë të rëndësishëm kur analizojmë punën e këtyre institucioneve, dhe pengesave të hasura në krijimin e proceseve vetë-rregulluese në media. Shumica e ankesave kishin të bënin me probleme në raportimin mbi minorenët, shkelje të privatësisë dhe dinjitetit njerëzor.⁴⁵

43 Autoriteti i Mediave Audiovizive, "Buletini i Ankesave" [numri 1, 2, 3, 4] <http://ama.gov.al/buletini/> (Faqja u vizitua më 22 Dhjetor 2018).

44 Po aty.

45 Monika Stafa, ish-kryetare e Këshillit të Ankesave, intervistuar më 15 Shtator 2018.

Po kështu, Këshilli i Ankesave, dhe administrata e AMA-s në përgjithësi, e kanë pritur mirë idenë e angazhimit më të madh me edukimin mbi median. Sidoqoftë, ashtu si u përmend edhe më lart, përparimet në këtë fushë janë shumë të ngadalta, pasi kemi të bëjmë me një aktivitet shtesë, dhe jo një detyrë apo kërkesë ligjore për AMA-n dhe strukturat e saj. Megjithatë, Këshilli i Ankesave është përfshirë në aktivitete të organizuara nga Instituti Shqiptar i Medias për edukimin mbi median, si dhe ka organizuar edhe vetë aktivitete të ngjashme, duke u përqendruar kryesisht mbi lajmet e rreme. Në vitin 2017, në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, Këshilli i Ankesave organizoi një konferencë me titull "Lajmet e rreme dhe sfidat ndaj të vërtetës në media," duke u munduar të risë ndërgjegjësimin mbi rreziqet që vijnë nga lajmet e rreme në një situatë ndryshimesh të shpejta teknologjike (Autoriteti i Mediave Audiovizive 2018). Pas konferencës u botua një përmbledhje me prezantimet dhe punimet e paraqitura në takim nga ekspertët e fushës. Zhvillimi i konferencës solli edhe organizimin e një takimi pune, po në vitin 2018, kur Këshilli i Ankesave organizoi një debat me palët e interesuara në fushën e edukimit mbi median në Shqipëri, duke diskutuar në lidhje me situatën dhe hapat e mëtejshme që duheshin marrë. Në takim morën pjesë anëtarë të Kuvendit, përfaqësues nga Ministria e Arsimit, OJQ, si dhe nga media. Megjithëse u mendua se ky do të ishte takimi i parë, që do t'i hapte rrugën hapave të mëtejshme, nuk pati iniciativa të tjera në këtë drejtim, dhe kjo do të thotë se po nuk pati detyrim ligjor, apo përjasje dhe objektiva strategjike për një institucion të caktuar, është e vështirë që ato t'i hyjnë punës seriozisht, dhe të arrijnë rezultate konkrete.

Paralelisht me iniciativat e veta, AMA ka disa vite që bashkëpunon me organizata të ndryshme në fushën e medias, duke mundësuar zbatimin e projekteve për profesionalizmin në media, duke përfshirë këtu edhe edukimin mbi median. Për shembull, në vitin 2017 Instituti Shqiptar i Medias zbatoi një projekt që kishte elemente të edukimit mbi median – duke organizuar vizita në universitete nga gazetarë të mirënjohur, që flisnin me publikun mbi situatën e medias në vend, problemet e saj, dhe ndikimin e medias në shoqëri.

Së fundmi, AMA po luan aktualisht një rol potencialisht të rëndësishëm për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi situatën e mediave audiovizive në vend. AMA boton një buletin një herë në gjashtë muaj,⁴⁶ duke filluar nga viti 2016, për të paraqitur një raport të detajuar mbi prirjet dhe zhvillimet në tregun e mediave audiovizive. Buletinët japin statistika dhe të dhëna mbi situatën ekonomike dhe nivelin e përfitimeve nga mediat audiovizive, strukturën

46 Faqja e internetit të AMA-s, lista e publikimeve mund të gjendet tek: <http://ama.gov.al/publikime/> (Faqja u vizitua më 24 Dhjetor 2018).

e pronësisë së tyre, ndryshimet dhe karakteristikat e stafëve që punojnë në këto media, si dhe aspekte teknike të transmetimit. Po kështu, buletinët përmbajnë informacione mbi punën monitoruese të entit rregullator, në mënyrë të veçantë mbi përqindjen e kohës së transmetimit që i dedikohet partive apo personazheve politike në edicionet e lajmeve të radio televizioneve publike dhe private me mbulim kombëtar, si dhe të dhëna mbi minutazhin e reklamave dhe volumnin e tyre në radio televizionet kryesore. Buletini jep të dhëna të plota mbi mediat audiovizive në një formë të strukturuar, si për publikun e gjerë ashtu edhe për studiuesit e medias; ai publikohet rregullisht si në faqen e internetit të entit rregullator, ashtu edhe në letër. Sidoqoftë, duke patur parasysh natyrën e të dhënave të paraqitura në këto publikime, përmbajtja e tyre ka më shumë vlerë për një grup të vogël studiuesish dhe punonjësish të medias, dhe jo aq shumë për publikun e gjerë. Megjithatë, ky është një hap përpara dhe tregon angazhim më të madh nga enti rregullator në shpërndarjen sistematike dhe periodike të informacionit, duke bërë dokumentimin e prirjeve dhe zhvillimeve më të fundit në mediat audiovizive, nëpërmjet dokumenteve dhe të dhënave zyrtare.

4.2. Radio Televizioni Shqiptar

Edhe Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) ndodhet në një situatë të ngjashme me AMA-n, për sa i përket edukimit mbi median dhe informacionin: RTSH ka shumë kompetenca dhe funksione të përcaktuara me ligj, por nuk ka ndonjë rol të qartë në lidhje me EMI-n. Kur ligji i mediave audiovizive po diskutohej në parlament, para miratimit të tij në vitin 2013, çështja kryesore kishte të bënte me pavarësinë e entit rregullator dhe Këshillit Drejtues të RTSH-së, ndërsa potenciali i tyre për të luajtur një rol në edukimin e shoqërisë mbi median nuk ishte pjesë e diskutimit.

Ashtu si Këshilli i Ankesave në entin rregullator, edhe radio televizioni publik ka në strukturën e tij Këshillin e Dëgjuesve dhe Shikuesve. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH-së. Disa nga anëtarët e tij mund të jenë gazetarë apo punonjës të RTSH-së, ndërsa dy të tretat e këshillit duhet të zgjidhen nga grupe të tjera shoqërore, duke përfshirë edhe përfaqësimin e personave me nevoja të veçanta. Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve mund të kërkojë prej RTSH-së zhvillimin e sondazheve apo studimeve në lidhje me transmetimin e programeve për të rinj dhe minorenë, moshat e thyera, apo grupe të tjera shoqërore. Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve u zgjodh në vitin 2016, dhe drejtuesit e RTSH-së thotë se rekomandimet e tij janë marrë në konsideratë nga drejtoria e programacionit të RTSH-së,⁴⁷ por nuk ka patur ndonjë komunikim të veçantë me publikun, apo ndonjë angazhim tjetër të kësaj strukture në debatin publik.

Megjithëse RTSH nuk ka ndonjë detyrim zyrtar, apo kërkesë specifike ligjore për angazhimin me edukimin mbi median, në praktikë ka patur edhe rezultate pozitive në ndërgjegjësimin e publikut mbi aspekte të veçanta të medias dhe rrjeteve sociale. Duke filluar që nga viti 2017, emisioni i përditshëm Mirëmëngjes Shqipëri, ka një segment

47 Thoma Gëllçi, drejtor i RTSH, intervistuar më 6 Prill 2018.

30-minutësh çdo të enjte në lidhje me median. Emisioni quhet Algoritëm, dhe aty merr pjesë Ervin Goci, pedagog i gazetarisë në universitetin e Tiranës, që flet mbi zhvillimet më të fundit në media, rrjetet sociale dhe teknologji, kontekstin dhe efektin e tyre në publik. Kjo iniciativë erdhi si rezultat i një bisede midis prezantuesit të programit dhe Gocit, dhe jo nga komunikimi direkt me programacionin e RTSH-së, apo strukturat drejtuese.⁴⁸ Ky rast është ilustrim i hapësirave që ekzistojnë, dhe mundësive për të zhvilluar idea e iniciativa kur ekziston vullneti personal. Por në të njëjtën kohë, një angazhim apo interesim zyrtar nga ana e RTSH-së në lidhje me edukimin mbi median do t'i jepte një shtysë të madhe iniciativave në lidhje me EMI-n.

Emisioni zhvillohet në formën e një interviste midis prezantuesit dhe pedagogut Gocit, në lidhje me ndikimin e medias, dhe veçanërisht teknologjisë dhe rrjeteve sociale, mbi qytetarët. Çdo emision përqendrohet mbi një temë të caktuar, dhe këto përfshijnë prirjen për të marrë lajmet nga mediat sociale dhe jo nga mediat tradicionale, personalizimi i lajmeve, efekti i algoritmeve në informacion, rrjetet sociale dhe mobilizimi publik, rrjetet sociale dhe respektimi i privatësisë, ana e errët e rrjeteve sociale, etj. Po kështu, përveç përshtypjeve të përgjithshme, dhe të dhënave nga sondazhe e studime mbi efektin e rrjeteve sociale, emisioni merret edhe me elemente të kritikës mbi median, dhe mjetet apo metodat që mund të përdorë publiku për të gjykuar vlerën dhe besueshmërinë e informacionit. Këtu përfshihet ndarja e faktit nga opinioni; heqja dorë nga privatësia në rrjetet sociale në epokën teknologjike; perceptimi i realitetit që ndërtohet në rrjetet sociale, në krahasim me realitetin e ndërtuar nga mediat tradicionale; protestat dhe raportimin e tyre nga mediat, në krahasim me rrjetet sociale; administrimi etik i rrjeteve sociale, etj. "Me anë të këtij emisioni po mundohemi të mbushim boshllëkun në fushën e edukimit mbi median, që është një problem shumë i dukshëm për shoqërinë tonë," tha Ervin Goci.⁴⁹

Situata financiare e RTSH-së, dhe nevoja për të përmbushur një mision kompleks dhe një listë të gjatë me detyra të përcaktuara me ligj, e bëjnë disi të vështirë financimin nga ana e RTSH-së të iniciativave që nuk kërkohen prej saj me ligj. Duke folur në lidhje me emisionin, Goci e pranon se kjo është vetëm një pikë uji në shkretëtirë krahasuar me punën që mbetet për të bërë. Ai ka biseduar me RTSH-në për krijimin e një emisioni të veçantë për këtë temë, por për momentin RTSH nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.⁵⁰ RTSH sapo ka përfunduar investimin për ngritjen

48 Ervin Goci, pedagog i gazetarisë në Departamentin e Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, intervistuar më 22 Nëntor 2018.

49 Po aty.

50 Po aty.

e rrjetit të digjitalizimit dhe mirëmbajtjes së tij, duke marrë një kredi që u bë objekt diskutimesh, dhe që është një ngarkesë e rëndë financiare për radio televizionin publik, që aktualisht mbledh taksën më të ulët të televizorit në rajon, me rreth 100 lekë për familje në muaj. Çdo vit kur bëhet prezantimi i buxhetit vjetor në parlament, drejtuesit e RTSH-së përsëritin kërkesën për të rritur këtë taksë, për të përmirësuar gjendjen e tyre financiare, por deri tani nuk kanë patur sukses, pasi kjo është parë si rritje e panevojshme taksash, që mund të shkaktojë pakënaqësi në popullatë. Në këtë situatë, ku radio televizioni publik duhet të mbajë me rrogë një personel shumë më të madh se mediat e tjera, dhe duke qenë i detyruar që të respektojë të gjitha detyrimet ligjore për pagesat, angazhimi për edukimin mbi median nuk mund të jetë prioritet për buxhetin e RTSH-së. Për shembull, radio televizioni publik është i detyruar me ligj që të transmetojë emisione në gjuhët e minoriteteve kombëtare, dhe i ka filluar këto transmetime, por ka akoma probleme me fondet dhe buxhetin për këto programe. Do të jetë shumë e vështirë që RTSH-ja të angazhohet në iniciativa EMI, nëse nuk sigurohen fonde të mjaftueshme, dhe nëse ndërgjegjësimi për edukimin mbi median nuk bëhet pjesë e detyrave të RTSH-së.

5. Përfundime

Edukimi mbi median dhe informacionin është një koncept relativisht i panjohur në Shqipëri, dhe është prekur vetëm nga një numër i vogël individësh dhe organizatash. Politikat zyrtare nuk i referohen këtij subjekti, madje nuk e përmendin fare si term, dhe nuk merren me këtë problem në tërësinë dhe kompleksitetin e tij. Institucionet publike kanë reaguar më shpejt dhe kanë punuar më shumë në drejtim të politikave për edukimin digjital, dhe veçanërisht TIK, që është bërë një lëndë e detyrueshme në arsimin para-universitar; dhe kurrikulat priten që të përmirësohen akoma më shumë në këtë drejtim. Por sidoqoftë, vështirësi teknike, si trajnimi i mësuesve dhe gjendja e infrastrukturës teknike, akoma krijojnë probleme për zhvillimin e një procesi normal mësuesor të kësaj lënde.

Nga ana tjetër, nocioni i njohjes me mënyrën se si funksionon sistemi i medias, dhe analizimi i aspekteve të ndryshme të saj, nuk janë përfshirë akoma në kurrikulat para-universitare, dhe kufizohen vetëm në paraqitjen e pak koncepteve dhe ushtrimeve elementare. Në fakt, një analizë e teksteve shkollore tregon se shpesh koncepti i informacionit kufizohet vetëm me aksesin në informim, dhe nuk ka përpjekje për të arritur një njohje të sistemit të medias, dhe analizimit me sy kritik të informacionit. Po e njëjta situatë ndeshet edhe me kurrikulat universitare, që nuk përfshijnë lëndë me zgjedhje mbi këtë temë, përveç studimeve në degën e gazetarisë. Një nga problemet me Departamentin e Gazetarisë është mungesa e bashkëpunimit dhe shkëmbimit institucional me organet e medias, që t'i mundësojë studentëve të bëjnë punë praktike në media, dhe të shohin se si funksionon një redaksi lajmesh.

Mungesa e politikave zyrtare dhe vizionit për edukimin mbi median nuk i vendos institucionet publike të medias përballë detyrimit që të merren me këtë çështje, si Autoriteti i Mediave Audiovizive, dhe radio televizioni publik, RTSH. Kjo mungesë e detyrimeve ligjore, së bashku me nevojën për të ndjekur prioritetet e tjera, nuk lejojnë që iniciativat

për edukimin mbi median të vihen në qendër të vëmendjes. Kanalet e komunikimit të këtyre institucioneve me publikun, si Këshilli i Ankesave të AMA-s, dhe Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve të RTSH-së, duhet të zhvillohen dhe të përmirësohen më tej, për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit dhe për të inkurajuar kritikën kundrejt çdo mungese profesionalizmi në organet e medias.

Sidoqoftë, si AMA ashtu dhe RTSH janë munduar të angazhohen në iniciativa dhe aktivitete mbi EMI-n, megjithëse akoma mungon një politikë dhe angazhim zyrtar në këtë drejtim. Një element pozitiv në këtë drejtim është se të dy këto institucione janë treguar të hapura ndaj propozimeve që vijnë kryesisht nga shoqëria civile, por edhe nga faktorë të tjerë, për t'u treguar më aktivë në lidhje me fushën e edukimit mbi median dhe informacionin.

6. Rekomandime

Bazuar në këtë raport dhe duke patur parasysh edhe kontekstin shqiptar, duhen marrë në konsideratë këto rekomandime për organizimin e iniciativave të ardhshme për zhvillimin dhe forcimin e përpjekjeve në lidhje me EMI-n në vend:

- Rishikim gradual i politikave zyrtare për të mos u angazhuar vetëm tek TIK, por edhe tek edukimi mbi median, informacionin, dhe edukimi digjital.
- Rishikim gradual i kurrikulave për të përfshirë në sistemin arsimor konceptin e plotë të EMI-t, dhe jo vetëm TIK-un, me ndihmën e ekspertëve të medias, në mënyrë që të pasqyrohen nocione dhe koncepte të rëndësishme, eksperiencat më të mira në këtë drejtim, dhe t'i përshtatim ato me kontekstin shqiptar.
- Të zhvillohen trajnime të vazhdueshme për mësues, punonjës të institucioneve publike, institucioneve të specializuara, dhe OJQ-ve në fusha të lidhura me EMI-n.
- Mbështetje për programe pilot për përfshirjen sistematike të institucioneve publike të arsimit dhe medias në iniciativa të arsimit publik në lidhje me EMI-n.
- Mbështetje e aktiviteteve monitoruese dhe studimeve për EMI-n, duke analizuar aspekte të ndryshme të edukimit mbi median dhe informacionin.

Referenca

Balkan Investigative Reporting Network, Reporterë Pa Kufij. "Monitorim mbi Pronësinë e Medias në Shqipëri." 2018, <https://albania.mom-rsf.org/en/> (Faqja u vizitua më 5 Janar 2019).

Çelçima, Denis. Libër për mësuesin Qytetaria 10. Pegi. https://shkollaime.al/pluginfile.php/29/mod_page/content/70/Qytetaria%2010.pdf (Faqja u vizitua më 23 Dhjetor 2018).

Dosti, Eljana, Jeta Lila dhe Brunilda Bozhani. Libër mësuesi për tekstin shkollor Qytetaria 10. Albas, 2016. <http://www.portalishkollor.al/materiale-ndihmese> (Faqja u vizitua më 23 Dhjetor 2018).

Godole, Jonila, dhe Matilda Karçanajin. "Shqipëria: Nevoja për Dialog me Organet e Medias për Kurse Praktike." Kërkesat për Arsimin Modern në Gazetari, redaktuar nga Viktorija Car, Miroljub Radojković dhe Manuela Zlateva, 11-35. Berlin dhe Sofie: KAS, 2016. https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=1f6f4be1-1d59-f416-78a6-a1105b098a82&groupId=252038 (Faqja u vizitua më 21 Dhjetor 2018).

Hootsuite. Ne Jemi Socialë (We Are Social) Vjetari Digjital 2018. <https://www.slideshare.net/wearesocial/2018-digital-yearbook-86862930> (Faqja u vizitua më 13 Dhjetor 2018).

IDRA. Pandëshkueshmëria – Opinioni publik mbi kuptimin, arsyet dhe rolin e institucioneve. IDRA, 2017. http://www.osfa.al/sites/default/files/studimi_pandeshkueshmeria_1.pdf (Faqja u vizitua më 13 Dhjetor 2018).

Lessenski, Marin. Na Duhet Mendimi Praktik: Rezistenca ndaj 'Post-të-vërtetës' dhe Parashikuesve të Saj në Listën e Treguesve për Edukimin mbi Median (Common Sense Wanted: Resilience to 'Post-truth' and Its Predictors in the New Media Literacy Index 2018.) Sofie: Instituti Shoqëria e Hapur, 2018. http://osi.bg/downloads/File/2018/MediaLiteracyIndex2018_publishENG.pdf (Faqja u vizitua më 3 Janar 2019).

Londo, Ilda. Shqipëria. Çështje të Integritetit në Media: Rikthimi i Vlerave të Shërbimit Publik në Media dhe Gazetari, (Albania. In Media Integrity Matters: Reclaiming Public Service Values in Media and Journalism) redaktuar nga Brankica Petković, 51-118. Ljubljana: Instituti për paqen, 2014.

Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit. Barometri Ballkanik 2018: Sondazh i Opinionit Publik. Sarajevë: Sekretariati i Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit, 2018. <https://www.rcc.int/pubs/66/balkan-barometer-2018-public-opinion-survey> (Faqja u vizitua më 14 Dhjetor 2018).

Tabaku, Anila, dhe Najada Hoxha. Libër mësuesi Qytetari 10. Tiranë: Erik botime. http://erikbotime.com/sq/images/plane-mesimore-mesme/qytetari_10_liber_mesuesi.pdf (Faqja u vizitua më 4 Janar 2019).

Artikuj

Autoriteti i Mediave Audiovizive. "AMA dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit nënshkruajnë marrëveshjen për praktikën studentore", 20 Nëntor 2015. <http://ama.gov.al/2015/11/20/ama-dhe-departamenti-i-gazetarise-dhe-komunikimit-nenshkruajne-marreveshjen-per-praktikat-studentore/> (Faqja u vizitua më 26 Dhjetor 2018).

Qendra për të Drejtën e Fëmijës në Shqipëri (Child Rights Centre Albania - CRCA). "Qendra Kombëtare e Internetit të Sigurtë Hapet në Shqipëri." CRCA, 31 Tetor 2018. <http://www.crca.al/en/news/national-safe-internet-centre-opened-albania> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

Dervishi, Gerta: Qendra e re inovative e Tiranës, laboratori TIK përgatit të rinjtë shqiptarë për sfidat e shekullit të 21-të." Follow Business Albania, 5 Shtator 2018. <https://followbusinessalbania.com/tiranas-new-innovation-center-ictslab-prepares-albanian-youngsters-for-21-st-century-challenges/> (Faqja u vizitua më 20 Shtator 2018).

Dosti, Nevila, dhe Enkel Xhangoli. "3.5 milionë euro për klasat inteligjente pa internet." Pse, 3 Prill 2017. <http://pse2017.com/3-5-milione-euro-per-klasat-inteligjente-pa-internet/> (Faqja u vizitua më 2 Janar 2019).

Erebara, Gjergj. Organizatat e të drejtave të njeriut kritikojnë kryeministrin shqiptar për 'disiplinim' të medias, (Rights Groups Criticise Albanian PM's Push to 'Discipline' Media.) Balkan Insight, 26 Dhjetor 2018. <http://www.balkaninsight.com/en/news/rights-groups-criticise-albanian-pms-push-to-discipline-media>

balkaninsight.com/en/article/rights-organizations-criticize-albania-prime-minister-push-for-online-media-disciplining--12-26-2018 (Faqa u vizitua më 3 Janar 2019).

Top Channel TV. "Mësim me tablet, projekti në pak shkolla. Fondi është përdorur i gjithi". 12 Maj 2018. <http://top-channel.tv/2018/05/12/mesim-me-tablet-projekti-ne-pak-shkolla-fondi-eshte-perdorur-i-gjithi/> (Faqa u vizitua më 3 Janar 2019).

Ligje, rregullore, dhe dokumente zyrtare

Autoriteti i Mediave Audiovizive. "Buletini i Ankesave" [Numri 1, 2, 3, 4] <http://ama.gov.al/buletini/> (Faqa u vizitua më 22 Dhjetor 2018).

Autoriteti i Mediave Audiovizive. Publikim nga konferenca mbi lajmet e rreme. Autoriteti i Mediave Audiovizive, 2018. <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Fakenews.pdf> (Faqa u vizitua më 22 Dhjetor 2018).

Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike. "Treguesit Statistikorë të Tregut të Komunikimeve Elektronike: Tremujori III 2018". https://akep.al/images/stories/AKEP/statistika/2018/Raport_T3_2018.pdf (Faqa u vizitua më 22 Dhjetor 2018).

Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike. Strategjia Ndërsektoriale 'Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020'. Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, 2015. http://www.akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Digjital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf (Faqa u vizitua më 2 Dhjetor 2018).

Këshilli i Ministrave, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit. Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit, 2008-2013. https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/Information-Society-strategy_printed_version_en.pdf (Faqa u vizitua më 2 Dhjetor 2018).

Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Kurrikula bërthamë lënda: qytetari klasa: X. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, 2016. <http://izha.edu.al/Biblioteka/3Programe%20>

[Lendore/4Programet%20e%20Arsimit%20te%20Mesem%20Kurrikula%20e%20re/Programet%20e%20klases%20se%2010/Programet%20e%20Klas%C3%ABs%20s%C3%AB%20X,%20Kurrikula%20B%C3%ABrtham%C3%AB/Qytetari.pdf](#) (Faqja u vizitua më 15 Dhjetor 2018).

Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Programi i lëndës TIK, shkalla e tretë, klasa 6 dhe 7. Tirana: Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit, 2014). http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/09/Prog_TIK_Shkalla-3_shtator-2015.pdf (Faqja u vizitua më 14 Dhjetor 2018).

Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014. http://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015-1.pdf (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014. <http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

Ministria e Arsimit dhe Sporteve. "Plani mësimor i lëndëve, Klasat 1-9, 2014". <http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Plani-Mesimor-1-9-2014-Kurrikula-Re.pdf> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike. Raport Monitorimi për Strategjinë Ndërsektoriale 'Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020'. Tiranë: Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, 2016. <http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/RAPORT-MONITORIMI-VJETOR-2015-2016.pdf> (Faqja u vizitua më 12 Dhjetor 2018).

Nikolla, Lindita. "Edukimi Digjital në Arsimin Para-Universitar", 2 Tetor 2018. <http://arsimi.gov.al/edukimi-digjital-ne-arsimin-para-universitar/> (Faqja u vizitua më 23 Dhjetor 2018).

Statistika

Të dhëna nga Statistika të Internetit nëpër Botë: <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm#al> (Faqja u vizitua më 2 Janar 2019).

Intervista

Aleksandër Çipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, 20 Tetor 2018.

Erida Koleci, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, specialiste, 30 Korrik 2018.

Ervin Goci, pedagog i gazetarisë në Departmentin e Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, 22 Nëntor 2018.

Lutfi Dervishi, ekspert i medias, 20 Korrik 2018.

Monika Stafa, ish-kryetare e Këshillit të Ankesave, 15 Shtator 2018.

Thoma Gëllçi, drejtor i RTSH, 6 Prill 2018.

Edukimi mbi Median dhe Informacionin në Vendet e Ballkanit Perëndimor: Një Mundësi Emancipimi Akoma e Përealizuar

Pasqyrimi i situatës në rajon

Brankica Petković dhe
Sandra Bašić Hrvatinić

1. Hyrje

Rreth 20 vjet më parë pasardhësit e Zhyl Vernit, shkrimtarit të famshëm francez të shekullit të 19-të, po bënë punime për rinovimin e shtëpisë që kishte qenë pronë e familjes prej shumë brezash. Aty gjetën një kasafortë të vjetër dhe të braktisur, dhe brenda saj gjetën një dorëshkrim akoma më të vjetër të një romani të pabotuar të Zhyl Vernit. Romani ishte shkruar në vitin 1863 dhe ngjarjet zhvilloheshin në Parisin e shekullit të 20-të (Verne1996). Shtëpia botuese që kontaktoi në fillim Zhyl Verni refuzoi ta botonte romanin dhe më pas edhe trashëgimtarët dhe administratorët e pronës letrare të shkrimtarit nuk donin që romani të botohej, pasi sipas tyre përmbajtja e romanit ishte tepër e pabesueshme dhe jo realiste, edhe për një shkrimtar të librave fantastiko-shkencorë si Zhyl Verni. Për pasojë dorëshkrimi mbeti i harruar në kasafortë për afro 150 vjet.

Personazhi kryesor i romanit, Mishel Dufrenua, mendonte se kishte lindur dhe po jetonte në periudhën historike më të keqe për një njeri si puna e tij. Fakulteti ku po kryente studimet sapo i kishte dhënë një çmim për poemën më të bukur në latinisht. Në këtë periudhë shoqëria dominohej nga njohuria e shkencave të natyrës dhe zotësia për sipërmarrje, ndërsa poetët konsideroheshin si dështakë. Elita e shoqërisë përbëhej nga inxhinierët që ndërtonin projekte gjigande infrastrukture, dhe sipërmarrësit e fushës së financës. Ata kishin shtënë në dorë edhe postet drejtuese në qeveri dhe administrata, që më parë u takonin politikanëve dhe punonjësve civilë. Nuk mund të shikoje më vepra arti as nëpër muzeume, pasi edhe vetë muzeumet nuk ekzistonin më. Kishte mbetur vetëm një dorë profesorësh letërsie në pension, që akoma mbanin mend emrat e shkrimtarëve dhe poetëve francezë që dikur kishin qenë të famshëm.

Mishelit i duhej që të mësonte si të mbijetonte në këtë situatë, me ndihmën e atyre pak gjërave që akoma mbaheshin mend nga njerëzit e moshuar. Këtu i vinte në ndihmë xhaxhai i tij Hugueni, delja e zezë e familjes, që kishte qenë

profesor i shkencave sociale deri sa kishte dalë në pension. Ndërsa shëtisnin një ditë nëpër Paris, xhaxhai i shpjegonte se shumë nga profesionet e të kaluarës tanimë nuk ekzistonin më, si pasojë e ndryshimeve shoqërore. Një nga profesionet e zhdukura ishte edhe gazetaria. Arsyet që jepte Zhyl Verni për eliminimin e gazetarisë ishin pak a shumë të ngjashme me ato që ndeshim sot, 150 vite më pas. Në një botë që udhëhiqej nga inxhinierët dhe mentaliteti i sipërmarrësit, nuk kishte më vend për mendimin politik. Partitë politike ekzistonin akoma, por programet dhe ideologjia e tyre nuk dallonin më nga njëra-tjetra. Kjo shoqëri burokratike nuk dinte (dhe nuk kërkonte) alternativë tjetër. Zhdukja e mendimit politik nuk goditi vetëm politikanët por edhe gazetatat që i kishin shërbyer klasës politike gjatë gjithë ekzistencës së tyre, si dhe ata që i vendosnin politikanët në pushtet dhe i mbështesnin financiarisht. Meqë politika nuk përbënte më asnjë interes për publikun, gazetarët humbën sektorin më të rëndësishëm për raportim. Për pasojë gazetatat u transformuan në formë pamfleti si në përmbajtje ashtu edhe në volum. Pronarët e tyre u munduan që të zëvendësonin sektorët dhe subjektet tradicionale të raportimit, me përmbajtje dhe material të ri, që të tërhiqnin vëmendjen e publikut që kishte interes të lexonte shkrime me karakter kritik dhe opinione ekspertësh, në lidhje me probleme të ndryshme shoqërore. Sikur të mos mjaftonte kjo, gazetaria u godit nga një fatkeqësi tjetër. Elitat politike dhe ekonomike ishin acaruar së tepërmi nga njëanshmëria e medias; dhe për pasojë kërkuan që çdo gazetë që publikonte shkrime kritike, duhet të lejonte edhe publikimin e vërejtjeve, korrigjimeve dhe kundërshtimeve, në mënyrë që të sigurohej një raportim sa më i balancuar, dhe mbrojtja e të drejtave qytetare. Redaktorët filluan të kishin probleme serioze që nga momenti i miratimit të këtij ligji, pasi ishin të detyruar që të botonin dhjetëra vërejtje dhe komente për çdo artikull të botuar. Gazetat që vazhdonin të botonin raportime të natyrës kritike po bëheshin gjithmonë e më të trasha, ndërsa përmbajtja e tyre po bëhej e palexueshme dhe e pakuptueshme për publikun. Më në fund shumica e tyre u mbyllën. Problemet që hasën mediat kritike i trembën shumë drejtuesit e atyre gazetave që akoma ishin në qarkullim, dhe për pasojë këto të fundit i kërkuan gazetarëve të tyre që të shkruanin vetëm artikuj që nuk kritikonin asgjë, dhe nuk kishin arsye për vërejtje apo korrigjime. Sidoqoftë, këto lloj gazetash nuk donte t'i lexonte kurrkush.

Xhaxha Hugueni shpjegoi më tej se këto ndryshime shoqërore po ndodhnin në një periudhë të pasur me ndryshime teknologjike. Në kohët e mëparshme, numri i lexuesve kishte qenë shumë herë më i madh se numri i gazetarëve dhe shkrimtarëve. Librat shkruheshin dhe botoheshin nga një numër i vogël autorësh. Po kështu edhe gazetatat. Kostoja e shtypjes dhe shpërndarjes (të librave dhe gazetave) ishte shumë e lartë për shumicën e njerëzve të thjeshtë. Më pas, revolucioni teknologjik e kishte bërë shtypjen dhe shpërndarjen e materialeve aq të lirë, saqë kushdo mund

të botonte dhe të hidhte në qarkullim çfarëdo lloj botimi që i shkonte për shtat. Në pamje të parë këto ndryshime teknologjike kishin pasoja pozitive: u shembën barrierat në fushën e shkrimit dhe publikimit, dhe në këtë mënyrë u arrit në demokratizimin e të drejtës për të patur akses në publik. Sidoqoftë, entuziazmi në lidhje me këto ndryshime nuk zgjati shumë. Nuk kishte më kritika apo kritikë (nga frika e hedhjes në gjyq), dhe për pasojë hapësira mediatike ishte mbushur plot e përplot me përmbajtje që nuk shqyrtohej, korrigjohej apo klasifikohej më nga kurrkush. E vërteta dhe gënjeshttrat kishin të njëjtën vlerë. Autorët e rinj shkruanin më tepër për veten e tyre, dhe për ata pak njerëz që mendonin si ata. Numri i shkrimtarëve ishte më i madh se numri i lexuesve, dhe kjo gjë që e bëri industrinë e botimit një sipërmarrje krejtësisht të panevojshme.

Gati 150 vite më pas, të krijohet përshtypja sikur ky vizion i Zhyl Vernit për botën po bëhet realitet. Sidoqoftë, kjo është vetëm një përshtypje e momentit, dhe nuk ka pse të krijohet ideja se nuk bëjmë dot më asgjë për ta ndryshuar situatën. Vëmendja kryesore dhe reagimi ynë duhet të drejtohet për të ndryshuar atë mënyrën e famshme të të menduarit SKA (s'ka alternativë). Ka gjithmonë alternativë (ose, më saktë, alternativa). Alternativa ofrohen vazhdimisht nga individë apo grupe, që punojnë në fushat e tyre respektive, me burime të kufizuara dhe mbështetje politike të kufizuar, që mundohen të ideojnë dhe të bëjnë ndryshimin. Për afro dy dekada studiuesit po mundohen që të gjejnë përgjigje për një pyetje në dukje të thjeshtë: pse kemi këto sisteme mediatike aktualisht? Jemi duke kërkuar që të gjejmë përgjigje komplekse dhe po mundohemi që të ofrojmë mënyrë të reja për të analizuar sistemin aktual dhe për të gjetur alternativa të reja. Ka mbi 10 vjet që kemi ngritur zërin në lidhje me rrezikun që i kanoset pluralizimit në media si pasojë e përqendrimit të pronësisë të organave të medias në pak duar (Hrvatit dhe Petković 2004); kemi arritur në përkufizimin e nocionit të integritetit në media, dhe kemi kërkuar që kjo të bëhet një referencë kyçe në politikat mediatike, dhe në krijimin e një sistemi mediatik që bazohet në punën e medias në shërbim të interesit publik (Hrvatit dhe Petković 2014); kemi shqyrtuar dhe kemi sugjeruar alternativa të mundshme për financimin e medias (Živković 2016); dhe kemi tërhequr vëmendjen në lidhje me rolin e radio-televizionit publik në mbrojtjen e të drejtës të qytetarëve për të marrë informacion, dhe të funksionimit të hapësirës publike të komunikimit (Hrvatit dhe Petković 2004, 2014; Petković, Panić dhe Hrvatit 2016). Ne mendojmë se është e mundur që të arrihet në një reformim thelbësor të sistemeve mediatike (dhe jo vetëm përmirësime kozmetike me anë të ndryshimeve sipërfaqësore të ligjeve), në mënyrë që të kthehen në instrumente kyç për formëzimin e mendimit kritik dhe fuqizimin e qytetarëve. Për këtë arsye, ky studim është përqendruar tek edukimi mbi median dhe informacionin, dhe rolin e tij në krijimin e njohurive

të nevojshme nga ana e publikut për të kuptuar më qartë botën që i rrethon. Sidoqoftë, ashtu si do të shikoni nga aktivitetet dhe situatat që kemi identifikuar në disa shtete që kemi marrë në analizë, qytetaria aktive mbi të gjitha ka nevojë për një shtet aktiv. Kemi nevojë për më shumë ndërhyrje nga ana e shtetit, dhe një administratë shtetërore që nuk kënaqet vetëm me qënien në qeveri por që angazhohet edhe në qeverisje (Brown 2015, 135).¹

Përhapja e informacioneve të rreme me qëllim manipulimin e opinionit publik; abuzimet me të dhënat personale të qytetarëve për qëllime komerciale apo politike; mungesa e transparencës në lidhje me algoritmet, dhe vendimet se cilat informacione duhet të shpërndahen në hapësirën publike dhe cilat jo; kriza e gazetarisë në një moment kur media është tashmë vetëm një nga burimet e informacionit, dhe madje nuk është as burimi kryesor; të gjitha këto probleme kërkojnë, nga pikëpamja e shumë qytetarëve, një politikë aktive dhe ndërhyrje nga ana e shtetit. Këto manipulime të hapësirës mediatike mund të luftohen vetëm atëherë kur interesat monopoliste në kapitalizmin informativ nuk do të marrin më prioritet në kurriz të interesave të qytetarëve, dhe respektimit të të drejtave të tyre themelore për komunikim. Pa këto të drejta dhe mbrojtjen e tyre është e pamundur që të mbështeten në mënyrë aktive ndryshimet shoqërore. Algoritmet dhe celularët smart nuk arrijnë kurrë ta kryejnë këtë funksion. Pronarët e medias nuk munden (apo nuk duan) që ta sigurojnë këtë të drejtë; së bashku me pronarët e portaleve të komunikimit dhe politikanët teknokratë, ata kanë privatizuar një nga të drejtat themelore të qytetarëve në një shoqëri demokratike: të drejtën për të patur media të besueshme, që thotë të vërtetën, dhe që punon për interesat e publikut.

Edukimi mbi median dhe informacionin, apo si e quan Douglas Kellner (1995) "pedagogjia kritike në fushën e medias," ofron mundësinë e krijimit të mënyrave të reja të komunikimit nga qytetarët në hapësirën publike, dhe në këtë mënyrë ata nuk mbeten thjeshtë në rolin e konsumatorit në një marrëdhënie shkëmbimi komercial. Media në ditët e sotme (apo në përgjithësi, edhe media përgjatë gjithë historisë së saj) nuk krijon akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në debatin publik. Ata që kanë në pronësi mjetet e prodhimit (në rastin tonë platformat e medias dhe komunikimit) vendosin se kush mund të flasë, dhe për kë mund të flitet. Hapësira mediatike është thjesht një "treg" ku njerëz me opinione të ndryshme mundohen që të tërheqin vëmendjen e audiencës së medias. Qytetarët transformohen nëpërmjet këtij procesi në konsumatorë të përmbajtjes mediatike, që shitet me përfitim për reklama nga pronarët e medias. Edukimi mbi median dhe informacionin, megjithë disa përpjekje pozitive, paraqet një përpjekje për të zgjidhur

¹ Sipas Brown, *qeverisja (governing)* i referohet veprimit aktiv politik, dhe ndryshon nga qënia në *qeveri (governance)*, që i referohet një sërë praktikash dhe mënyrash pune individuale, negociatash dhe garancish që ndërmerren në përgjithësi nga qeveria për llogari të qytetarëve.

në mënyrë të njëanshme disa nga problemet e akumuluar ndër vite nga industria e medias: ajo kërkon që të edukojë dhe fuqizojë konsumatorët, por në të njëjtën kohë kjo çliron drejtuesit e medias (pronarët e medias, redaktorët dhe gazetarët) nga të gjitha përgjegjësitë. Demokratizimi i sistemit mediatik kërkon prej nesh që të analizojmë në mënyrë kritike faktin se ka mbetur shumë pak, apo thuhet asgjë, nga parimi liberal i publikut si një hapësirë për diskutim publik, ku përballen ide dhe opinione të ndryshme. Edukimi mbi median dhe informacionin, ashtu si perceptohet prej nesh, kërkon që të edukojë dhe fuqizojë të gjithë aktorët e sistemit mediatik: që nga qytetarët deri tek media dhe politikanët. Është e rëndësishme të shtojmë se edukimi mbi median dhe informacionin nuk është një sistem i organizuar për formëzimin e gjykimeve apo paragjykimeve morale mbi përmbajtjen mediatike; po kështu nuk është as (vetëm) një mënyrë që të mëson si të kthehesh dhe vetë në një media, por është një proces ku mësojmë si të komunikojmë, si të zgjidhim konflikte komunikimi, dhe si të zbatim demonët e demokracisë.

Në mënyrë që të kuptojmë plotësisht rëndësinë e edukimit mbi median dhe informacionin, duhet që më parë të analizojmë përse kemi këto media dhe këto sisteme mediatike. Cilat janë prirjet dhe tendencat kryesore që i kanë dhënë formë këtij sistemi; si ka ndikuar liberalizimi i politikave mbi median në lidhje me pluralizmin në media; si ka ndryshuar pozicioni dhe roli i punës të organeve publike të medias; si kanë reaguar ligjvënësit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (Bashkimi Evropian) në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes, dhe lirisë së medias; dhe si ka ndryshuar audienca dhe zakonet e tyre ndër vite? Në momentin kur të jemi në gjendje t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve, do ta kemi më të lehtë që të kuptojmë se sa e rëndësishme është që edukimi mbi median dhe informacionin të bëhet pjesë përbërëse e politikave të arsimit publik. Fragmentarizimi dhe copëzimi i kërkesës dhe ofertës mediatike; monetarizimi i të dhënave personale të qytetarëve në mediat sociale; dhe humbja e besimit në media nga ana e popullatës (që përkon me humbjen e besimit edhe ndaj elitave politike dhe përfaqësimit demokratik) kërkojnë prej nesh që të bëjmë një analizë kritike për t'i dhënë përgjigje pyetjes se për çfarë lloj mediash kemi nevojë.

2. Harta e botës

Megjithëse duket sikur media nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në edukimin dhe arsimimin e audiencës - madje disa përfaqësues të medias thonë se kjo nuk është fare puna e tyre – kjo nuk është aspak e vërtetë. Shërbimi publik, si një nga funksionet thelbësore të mediave publike, që nga krijimi i tyre gati një shekull më parë, është bazuar që nga fillimet e veta në edukimin e publikut. Edukimi, informimi dhe zbatimja e publikut (në këtë renditje) kërkohet nga të gjithë krijuesit e përmbajtjes të programeve mediatike. Natyrisht, ky funksion edukativ i medias publike nuk ishte menduar ndonjëherë që të zëvendësonte sistemin arsimor, që ka qenë gjithmonë nën kontrollin dhe zotërimin ideologjik të shtetit. Krijuesit e përmbajtjes mediatike e kishin të qartë sa e rëndësishme ishte puna që kryenin në informimin e publikut të gjerë. Përgjegjësia, përgjegjshmëria dhe reagimi ndaj publikut u kthyen në parimet thelbësore organizative të mediave publike. Përgjegjësia ka të bëjë me punën në shërbim të interesave të publikut; përgjegjshmëria ka të bëjë me standardet e larta profesionale të punonjësve të saj; dhe reagimi ndaj publikut ka të bëjë me lidhjen e një marrëdhënieje të ngushtë me publikun të cilit i shërben media. Në rastin e medias së shkruar, nuk ka patur asnjëherë ndonjë kontratë apo kërkesë formale për përmbushjen e këtyre standardeve nga punonjësit. Natyrisht, gazetarët janë munduar gjithmonë që të respektojnë dhe përmbushin standardet profesionale, dhe përgjatë viteve janë ngritur mekanizma vetë-rregulluese për të parandaluar marrjen e masave represive nga ana e shtetit kundër gazetarëve, ndërkohë që detyra e të gjithë punonjësve të medias ka qenë krijimi i një produkti që do të sillte fitime për pronarin e medias (duke respektuar të gjitha standardet e përmendura më lart). Platformat e komunikimit dhe mediat sociale nuk janë media tradicionale ashtu si media e shkruar, radio, televizioni, apo shërbimet mediatike audiovizive. Ato janë platforma teknologjike komunikimi, ku publikohen dhe shkëmbehen mesazhe nga miliona përdorues, që i japin formë hapësirës të komunikimit publik, por këto platforma, në ndryshim nga mediat tradicionale, nuk mbajnë ndonjë

përgjegjësi për informacionin që përçojnë. Ato nuk kanë ndonjë detyrim që t'i shërbejnë interesit publik (përveç ofrimit të shërbimit të aksesit të klientëve të tyre në këto platforma), por në të njëjtën kohë janë bërë burimi më i rëndësishëm i informacionit, dhe mjeti më i rëndësishëm i komunikimit për një pjesë të madhe të popullatës.

Përpara se të flasim për mënyrën se si roli dhe përgjegjësia e atyre që marrin pjesë në konsumimin e përmbajtjes mediatike ka zëvendësuar rolin dhe përgjegjësinë e atyre që marrin pjesë në krijimin e përmbajtjes mediatike, duhet që të kuptojmë se si ndikon media mbi mënyrën se si publiku arrin të perceptojë botën që e rrethon.

Media luan një rol të rëndësishëm në krijimin dhe legjitimizimin e këndvështrimeve dominante mbi botën përreth. Mediat janë, ashtu si thonë vazhdimisht edhe studiuesit e medias, instrumente kyç në realizimin e "projektit radikal demokratik" të krijimit të hapësirës publike, ku qytetarë të mirëinformuar dhe aktivë në fushën sociale të mund të mendojnë dhe veprojnë lirshëm. Media jo vetëm vendos se cilat tema do të diskutohen në publik, por mbi të gjitha ofrojnë edhe interpretime të pranueshme mbi këto subjekte: na shpjegojnë si dhe pse ka ndodhur diçka. Bota është tepër e komplikuar dhe e padepërtueshme që të përjetohej drejtpërsëdrejti në tërësinë e saj. Ne si individë nuk kemi njohuri të mjaftueshme për të kuptuar të gjitha dimensionet e një problemi të caktuar, të gjitha këndvështrimet e ndryshme dhe interpretimet e pafundme. E megjithatë, jemi të detyruar që të punojmë në këtë ambient, ta rindërtojmë dhe transformojmë atë, si dhe të kuptojmë si funksionon bota që na rrethon, duke përdorur një model interpretimi të thjeshtësuar. "Për të udhëtuar nëpër botë, njeriu ka nevojë që të ketë me vete një hartë të botës," shkruan Walter Lippmann në librin e tij *Opinionin publik* (Public opinion 2003). Është pikërisht media ajo që na jep këto "harta"; që na tregojnë shtigjet që duhen kaluar dhe shenjat drejtuese që na ndihmojnë të kuptojmë ngjarjet që ndodhin përreth nesh në jetën e përditshme. Mediat mbledhin informacione dhe analizojnë ngjarje që nuk i kemi përjetuar, dhe për shumicën e të cilave nuk kemi ndonjë opinion apo këndvështrim. Media konsiderohet prej nesh si një burim i besueshëm informacioni, një "kronikane" ngjarjesh, dhe kjo na jep garanci se ajo që raportohet në media ka ndodhur me të vërtetë. Media krijon dhe përforcon besueshmërinë e saj duke u bërë burimi kryesor i informacionit dhe interpretimit të tij. Shumica e njerëzve e gjykojnë besueshmërinë e informacionit në bazë të burimit të këtij informacioni: në varësi të personit që na thotë diçka ne gjykojmë sa e besueshme është ajo fjalë. Për këtë arsye nuk mund ta konsiderojmë punën e medias si një aktivitet i thjeshtë komercial si gjithë fushat e tjera.

Mediat (veçanërisht radio dhe televizioni) janë një institucion historik shumë i rëndësishëm i shekullit të 20-të. Në librin e tyre *Një Histori Sociale e Medias – Nga Gutenbergu deri tek Interneti* (*A Social History of The Media - from*

Gutenberg to The Internet, 2009) historianët britanikë Asa Briggs dhe Peter Burke i njohin medias një rol shumë të rëndësishëm në krijimin dhe forcimin e shteteve-kombe. Radiot dhe televizionet kombëtare lidhin së bashku qytetarët e shtetit-komb, burra dhe gra, në një njësi të përbashkët gjuhësore dhe kulturore – në një komunitet mediatik. Masmedia dhe audienca e masmedias luajtën rol parësor në përçimin e ideve të teoricienëve politikë të pas luftës, që ndikuan në forcimin e demokracive liberale, të cilët mbështesnin idenë se qytetarë të lirë dhe të mirëinformuar duhet të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre politikë në zgjedhje të lira, të ndihmuar nga informacioni që u jepej nga media. Nocioni i përfaqësimit demokratik i ka lejuar ndërmarjet mediatike që të gëzojnë statusin e privilegjuar të “mbrojtësve të demokracisë.” Ato ishin të vetmet që mund të hynin njëkohësisht në dhomat e ndenjes të klasave të ndryshme shoqërore duke prezantuar një program mediatik të përbashkët në sferën politike, kulturore dhe zbavitëse. Mediat ishin “mbrojtëse të demokracisë” me kuptimin e plotë të fjalës. Ato kanë luajtur një rol tejet të rëndësishëm në mbarëvajtjen e një modeli tipik organizativ dhe krijues në botën e pasluftës.

Nga mesi i shekullit të 20-të, sistemi mediatik me dy nivele (një radio-televizion publik i fuqishëm, dhe radio-televizionet private që sapo kishin nisur transmetimet e tyre), që kishte mbizotëruar deri në ato momente filloi të ndryshonte. Liberalizimi i tregut të medias u shoqërua me daljen e një numri gjithmonë e më të madh të mediave elektronike private që mundoheshin të tërhiqnin vëmendjen e audiencave të veçanta dhe kompanive që donin të bënin reklama. Në vitet 80-të shtetet-kombe filluan të lëshonin gjithmonë e më shumë liçensa transmetimi për stacione radio-televizioni private, por shumë shpejt tregu kombëtar rezultoi shumë i vogël për këta operatorë. Mediat kombëtare në disa vende duhet edhe të konkurronin me radio televizione globale (veçanërisht korporata mediatike amerikane) dhe hapësira mediatike kërkonte gjithmonë e më shumë programe të reja për t’u mbushur. Ndërkohë, edhe tregu i mediave të shkruara, që kishte thithur për shekuj me rradhë shumicën e parave që shkonte për reklama, tani po përballej me një konkurent shumë të fortë, si televizioni. Në fllim, ideja e shpërndarjes së gazetave pa pagesë tërhoqi një numër të madh lexuesish brenda një kohe të shkurtër, por me kalimin e viteve kjo lëvizje shkatërroi tregun dhe krijoi një publik që nuk ishte më i gatshëm që të paguante për marrjen e lajmeve. Nga ana tjetër, edhe përqendrimi i mediave në pak duar avancoi me hapa të shpejta, dhe gjithmonë e më shumë organe mediatike po ndryshonin pronarë, duke kaluar në formimin e konglomerateve të mëdha mediatike. Ligjvënësit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (BE) ishin të paafte për t’iu kundërvënë kësaj situate. Mbështetja për pluralizmin në media ishte thjesht një fjalë goje, pasi ajo retorikë nuk u shoqërua me mekanizma efektivë për të siguruar mbarëvajtjen e tij në praktikë. Pas kalimit nga sistemi

socialist, në fillim të viteve 90-të, vendet e Evropës juglindore iu bashkuan një komuniteti mediatik botëror, ndërkohë që ishin akoma të papërgatitur për ta ndërmarrë këtë hap. Privatizime jo të suksesshme, legjislacion i mangët që nuk siguronte mbikqyrje në zbatimin e ligjeve, instrumentalizimi i medias, dhe korrupsioni në tregun e reklamave hodhën themelet e një sistemi mediatik disfunksional, ku gazetarët dhe qytetarët ishin ata që humbën më shumë nga të gjithë. Më pas, kriza financiare globale e vitit 2008 vetëm sa i përkeqësoi problemet e akumuluar ndër vite në industrinë e medias. Doli qartë në pah se askush nuk po mbronte më interesat e qytetarëve dhe të drejtën e tyre për të marrë lajme nga burime të ndryshme informacioni. Emigrimi i mediave, reklamuesve, dhe audiencës drejt internetit ishte vetëm goditja e fundit që vulosi fatin e mediave tradicionale. Të gjendur përballë kësaj situate, ideja e edukimit mbi median, dmth. përforcimi i pozitave të "konsumatorëve të medias",² u bë pjesë e axhendës politike të shumë shteteve. Nga ana tjetër, ishte disi e paqartë mënyra se si kjo ide mund të zbatohet në praktikë. Kërkimi për të gjetur modele që mund të funksionojnë në praktikë iu la në dorë shoqërisë civile. Ky kërkim vazhdon edhe sot e kësaj dite.

2 Në përdorim terma të ndryshëm në materialin tonë kur marrim në shqyrtim marrëdhëniet midis palëve në procesin e komunikimit. Termi "konsumatorë të medias" i referohet audiencës të sistemit privat të komunikimit, ndërsa termi "përdorues të medias" i referohet përdoruesve të shërbimeve të platformave dhe teknologjive të ndryshme informative. Në fund të fundit, mediat publike, edhe për nga vetë emri i tyre, duhet ta konsiderojnë publikun e tyre si qytetarë, dhe jo si klientë.

3. Kriza e një sistemi që i reziston reformave

Në librin e tij *Humbja e Lajmit (Losing the News, 2009)*, gazetari dhe redaktori amerikan Alex Jones analizon pasojat e krizës ekonomike mbi median dhe gazetarinë. Ai bën një përshkrim të modelit ekonomik mbi të cilin bazohet industria mediatike, duke shpjeguar se modeli që mbështetet në reklama dhe shitjen e kohës televizive për të siguruar fonde për funksionimin e organeve të medias nuk mund të funksionojë më. Kriza në media dhe gazetari u shoqërua me shkurtime vendesh pune nëpër redaksi, mbylljen e zyrave në vende të huaja, shfrytëzimin në masë të stafit që punon me kohë të pjesshme, presion në rritje nga sektori i financës mbi redaktorët, rritje e volumit të punës për stafin e medias, si dhe rritja e influencës të ndërmjetësve të informacionit (si lobistëve, dhe punonjësve të marrëdhënieve me publikun); e gjitha kjo ka çuar në një përqindje më të madhe të përmbajtjes mediatike që mbushet me tema, forma, dhe mënyra interpretimi të ricikluara. Sipas mendimit të Jones, modeli i vjetër i biznesit nuk funksionon më, edhe sikur të kalohet në një periudhë zhvillimi ekonomik. Kjo është arsyeja përse gazetarët duhet të gjejnë burime të reja financimi, në radhë të parë për të vazhduar raportimin e çështjeve të rëndësishme, pa të cilin nuk mund të ketë qytetarë të mirëinformuar dhe shoqëri demokratike.

Po kështu mendon edhe shumica e studiuesve dhe punonjësve të medias. Gazetarët po e përjetojnë krizën që ka mbërthyer industrinë e medias dhe mbylljen e gazetave, në të njëjtën mënyrë si punonjësit e industrisë së rëndë që humbën vendet e punës në vitet 70-të dhe 80-të – minatorët, punëtorët e linjave të prodhimit, dhe shumë të tjerë – që u përballën me krizën e prodhimit masiv, globalizimit dhe automatizimit. Gazetarët dhe pronarët e medias kanë tashmë një qëllim të përbashkët: si të shpëtojnë fabrikën e medias nga falimentimi. Deri më tani pronarët janë munduar ta shpëtojnë median duke shkurtuar vendet e punës, duke blerë më shumë organe mediatike, duke njësuar redaksitë, dhe duke u munduar që të influencojnë politikanët dhe ligjvënësit që të mbrojnë pozitat e tyre në treg, dhe

të kufizojnë veprimtarinë e konkurrentëve të tyre në internet. Gazetarët tani shpresojnë se pas krizës mund të vijë një pronar më i mirë (zakonisht flitet për mundësinë e afrimit të një "investitori strategjik"), apo mendojnë ta marrin vetë drejtimin e medias ku punojnë, ose edhe të krijojnë fabrikën e tyre të medias. Por asnjë nga këto dy grupe nuk po mendon se si ta rifitojnë publikun e humbur, dhe t'i shpegojnë qytetarëve përse media dhe gazetaria kanë rëndësi të veçantë për shoqërinë.

Në librin e tij *Gazetaria në Funksion të Tregut – Qytetarët të Tregojnë Kujdes? (Market-Driven Journalism – Let the Citizen Beware? 1994)*, John H. McManus shpjegon mekanizmat e tregut që bënë të mundur kontrollin e përmbajtjes mediatike nga kompanitë e reklamave, pasi duke devijuar rrjedhën e fondeve nga reklamat ato kontribuonin direkt në suksesin apo falimentimin e ndërmarrjeve të caktuara mediatike. Për pronarët e rinj të korporatave mediatike, puna gazetareske ishte me rëndësi për aq kohë sa bënte të mundur thithjen e reklamave dhe sillte fitime. Kërkesat e pronarëve për fitime gjithmonë e më të mëdha u shoqëruan me mbylljen e redaksive që kërkonin shumë fonde, por që ishin pa vlerë për korporatën pasi nuk sillnin fitime për aksionerët e kompanisë. Komercializimi i gazetarisë u zhvillua paralelisht me zhvillime të tjera në fushën politike dhe ekonomike: liberalizimi i tregut të medias, përqendrimi i pronësisë të medias në pak duar, dhe dobësimi i pluralizmit në media. Për dekada me rradhë, këto zhvillime ishin burim shqetësimi vetëm për studiuesit e medias, shoqatat e gazetarëve dhe aktivistët e shoqërisë civile, që ngritën zërin për pasojat që do të sillte kjo situatë, duke përfshirë edhe kufizimin e lirisë së shprehjes. Edhe pronarët e medias filluan ta ndienin krizën në momentin kur reklamuesit tradicionalë e kuptuan se media nuk ishte më platforma më e mirë për reklama dhe publicitet. Reklamat në internet, rrjetet sociale, programe kërkimi dhe aplikime, si mbledhësit e lajmeve, ofronin më shumë publik për më pak shpenzime. Google, Facebook, Amazon dhe pronarë të tjerë të platformave të komunikimit i njihnin përdoruesit dhe publikun e tyre shumë më mirë se sa pronarët e medias. Ata regjistronin çdo klikim, çdo kërkim në internet, çdo blerje që bëhej online, dhe çdo material që lexohej në kompjuter. Interneti tregoi se sa shumë varësi kishin krijuar ndërmarrjet mediatike nga një model biznesi: shitja e reklamave. Pagesat direkte nga konsumatorët e medias – shitja e gazetave, pagesat nga taksa e televizorit, shitja e paketave digjitale – nuk sillte dot fitime të mjaftueshme për atë mori organizatash mediatike. Gjithsekush do të krijonte idenë se media duhet të kishte nxjerrë mësim nga pasojat e një modeli biznesi "monokulturor," por doli se edhe kompanitë online bënë të njëjtin gabim. Edhe të ardhurat e mediave online varen nga reklamat dhe paratë e reklamuesve, që e shohin infrastrukturën informative si burim fitimi. Presioni i tregut që përmend McManus është edhe më i madh në

internet si pasojë e perfeksionimit të punës, dhe algoritmeve kompjuterike që bëjnë të mundur që çdo klikim, artikull apo material i hedhur nga përdoruesi të shfrytëzohet për reklama: një postim në blog, një mesazh në Twitter, hedhja e pamjeve në internet, apo një postim në mediat sociale. Sidoqoftë, sundimi i modelit të reklamave në industrinë mediatike ka marrë fund, por akoma nuk është identifikuar ndonjë model i ri që ta zëvendësojë me sukses. Gazetarët po përballen me humbjen e të ardhurave nga reklamat që financonin punën e tyre, dhe tani janë vënë në kërkim të mënyrave të reja për të gjetur fonde për punë gazetareske, si dhe të gjejnë një motiv dhe domethënie të re për gazetarinë (apo të rizbulojnë ato të mëparshmet). Me sa duket, kriza nuk është strukturale por është e një natyre sistemike, dhe ka sjellë pasoja shkatërrimtare për gazetarinë.

Gjatë pjesës më të madhe të shekullit të 20-të, funksionimi i fabrikës së medias karakterizohej nga standardizimi i punës gazetareske dhe përbajtjes mediatike. Henry Ford po shikonte makinën e parë që po montohej në linjën e prodhimit në fabrikën e tij, dhe tha: "Morën edhe njëherë në analizë vlerësimin dhe klasifikimin e vendeve më të lehta të punës, për të parë sa prej tyre kërkonin angazhim të plotë fizik. Zbuluam se 670 vende pune mund të ziheshin nga njerëz pa këmbë, 2,637 nga njerëz me një këmbë, dy vende pune nga njerëz pa krahë, 715 nga njerëz me një krah, dhe 10 nga të verbër. Kështu, nga 7,882 vende pune, 4,034 prej tyre – megjithëse kërkonin njëfarë force fizike – nuk kërkonin angazhim të plotë fizik" (Ford 1923, 109). Në ditët tona, fabrikat mbarëbotërore të prodhimit masiv që nxjerrin produkte për konsum jo-masiv nga individë të caktuar, bazohen mbi një nivel akoma më të lartë standardizimi pune, falë algoritmeve. Momenti kur pronari i një fabrike mbarëbotërore (si për shembull Google) merr punën që kryhej nga një fabrikë lajmesh tradicionale, kjo shënon një pikë kthese në ciklin historik të medias, që përshkruhet nga studiuesi ligjor kanadez Tim Wu në librin e tij *Pronarët e Rinj - Shkëlqimi dhe Rënia e Perandorive të Informimit (The Master Switch – The Rise and Fall of Information Empires, 2010)*.

Wu thotë se kompanitë që kanë sot monopolin mbi informacionin po mundohen që të shmangin me të gjitha mundësitë mallkimin e perëndisë greke Kronos. Kronos kishte frikë nga profecia, sipas të cilës një nga fëmijët e tij do ta hidhte nga froni që mbante si perëndia supreme. Për këtë arsye ai hante fëmijët e tij të porsalindur, por biri i tij Zeus arriti të shpëtonte dhe përmbushi profecinë. Po kështu edhe këta Kronos të epokës së vjetër të informacionit (media) e përdorën të gjithë forcën dhe influencën e tyre për të parandaluar Zeusët e bizneseve të reja online që të mos kërcënonin dominimin e tyre në treg (shpeshherë edhe me ndihmën e shtetit dhe organizmave rregullatore). Monopolistët e telegrafit u munduan të ndalonin zhvillimin e telefonisë. Vite më vonë, perandoritë e telefonisë u

munduan të pengonin zhvillimin e radios, ndërsa më pas pronarët e radios arritën që të pengonin për disa dekada zhvillimin e televizionit, si radio me figurë.

Gjatë dekadës së fundit, industritë e medias dhe telekomunikacionit e gjetën veten të përfshirë në një cikël të ngjashëm konkurrence, duke u munduar me të gjitha mënyrat që të kufizonin suksesin dhe ndikimin e industrisë së internetit. Për shembull, kompani mediatike spanjolle dhe gjermane nuk e lejojnë Google që të publikojë në internet, në shërbimin e saj Google News, materiale pa pagesë nga gazeta dhe revista. Po kështu, një numër shtëpish botuese kërkojnë nga Google që të ndalojë projektin e saj, Google Books, për skanimin e librave, me anë të të cilit ka kaluar në format digjital miliona libra, duke shkelur të drejtat e autorit. Pronarët e infrastrukturës të telekomunikacionit – kompanitë kombëtare të telefonisë, komunikimit kabllor, dhe operatorë të tjerë të telekomunikacionit – po mundohen, duke shkelur parimin e mosdiskriminimit të klientëve, që të kufizojnë aksesin e kompanive online (kryesisht Netflix) që ofrojnë shërbime online me çmime konkurruese: si për shembull, tregti në internet, muzikë dhe video, ofrimin e hapësirës për përpunim dhe magazinim informacioni, telefoni dhe mesazhe në tekst. Në ndryshim nga monopolistët e informacionit në të shkuarën, kompanitë e telekomunikacionit kanë kontroll gati të plotë mbi teknologjinë dhe përmbajtjen, dhe kjo i bën ato redaktorë dhe kuratorë të konsumit tonë mediatik.

Ekonomisiti politik kanadez Vincent Mosco (2014) paralajmëron se në ditët e sotme bazat e të dhënave mund të krijohen dhe mirëmbahen vetëm nga kompanitë më të mëdha në treg, dhe nga shtete të fuqishme, dhe për këtë arsye industria online është shumë më e përqëndruar dhe më e centralizuar se industria e medias. Sistemet komplekse të informacionit kanë nevojë për një proces pune më të harmonizuar se sa fabrikat tradicionale të medias në të kaluarën. Në vend të qenieve njerëzore, këto procese komplekse zhvillohen nga algoritme dhe robotë, ndërsa ritmi i punës së tyre diktohet nga procesorë kompjuteri gjithmonë e më të shpejtë. Google ka mbledhur së bashku aq shumë materiale për përdoruesit e tyre që as vetë shtetet nuk kanë qenë në gjendje të mbledhin: kërkimet në internet; përmbajtja e mesazheve personale elektronike; vendndodhjen; shijet dhe zakonet e konsumatorëve; lidhjet shoqërore në mediat sociale; orientimet seksuale; dhe bindjet politike. Sa herë që bëjmë ndryshime në faqen tonë në Facebook, sa herë që zgjedhim ndonjë video në YouTube, apo hedhim foto në Instagram, ne lëmë gjurmë në këto platforma, dhe këto informacione mbledhen dhe shiten nga pronarët e tyre. Në rastin e industrisë së medias, kompanitë shisnin tek reklamuesit publikun e tyre, ndërsa në rastin e platformave në internet shiten të dhënat tona personale. Ky proces ka filluar që tani të japë ndikimin e vet. Përdoruesit e shërbimeve të ofruara nga platformat në internet kanë filluar

ta përshtatin sjelljen e tyre online (p.sh., përzgjedhjen e informacionit) sipas asaj që ofrohet nga algoritmet, që nuk funksionojnë në mënyrë transparente. Në ditët e sotme programuesit kanë zotësinë që të analizojnë dhe parashikojnë se cila këngë do të ketë sukses, të përkthejnë materiale nga gjuhë të huaja, si të shkruajnë një simfoni apo sonetë, apo të krijojnë algoritme që mund të përdoren edhe për të shkruar artikuj (Steiner 2012). Studimi ynë nuk duhet të kufizohet vetëm në analizimin e teknologjisë që po i jep formë dhe kushtëzon konsumin mediatik nga ana jonë, por duhet të shikojmë edhe tendencat apo zhvillimet shoqërore dhe ekonomike që kontribuojnë në përdorimin më të gjerë të këtyre mjeteve teknologjike: automatizimi; ulja e kostos së punës; dhe besimi se vetëm duke përdorur në mënyrë sa më efikase mjetet e informacionit mund të sigurojmë zhvillim ekonomik të fuqishëm, dhe të zgjidhim disa nga problemet më serioze me të cilat përballet njerëzimi (ndryshimet klimaterike, zhfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore, varfëria), pa iu nënshtruar asnjë analize serioze rreth qëndrueshmërisë të organizimit shoqëror aktual.

Erik Brynjolfsson dhe Andrew McAfee (2016) janë të bindur se që me valën e parë të automatizimit, pajisjet elektronike inteligjente do të shkaktojnë humbjen e afro gjysmës të vendeve të punës që sot zihen nga njerëzit. Shembull për këtë janë makinat pa shofer. Ato që punojnë në sektorët e ashtuquajtur krijues kujtojnë se i kanë të sigurta vendet e tyre të punës. Por, algoritmet janë më efikase pikërisht kur u kërkohet të kryejnë punë të natyrës logjike dhe procese të strukturuar të analizimit të të dhënave: kontabilitet, përkthime, shkrimi i teksteve dhe muzikës shabllon, apo diagnostikimi mjekësor. Për shumë vite tashmë algoritmet në gazetari janë përdorur në prodhimin e teksteve gazetareske të standardizuara. Brynjolfsson dhe McAfee (2016) mendojnë se sektori më i vështirë për t'u prekur nga automatizimi do të jetë e ashtuquajtura ekonomia emocionale (kujdesi për të tjerët, kontakti personal në vend të shërbimit të automatizuar), ku vendet e punës zihen kryesisht nga punonjëse femra që paguhen shumë pak ose aspak.

Edhe sistemi arsimor aktual, që orientohet drejt trajnimit të një personeli tërësisht të specializuar për të kryer punë në pozicione tërësisht të specializuara duhet të ndryshojë. Brynjolfsson dhe McAfee nuk japin vlerësime pesimiste të situatës aktuale por paraqesin alternativa, dhe japin sugjerime se si duhen përdorur këto teknologji në të mirë të gjithë njerëzimit. Nuk duhet të harrojmë për asnjë moment një fakt të rëndësishëm: copa më e madhe e tortës (parave) do të shkojë për llogari të pronarëve të super kompjuterave, algoritmeve dhe platformave elektronike, dhe për rrjedhojë kjo do të sjellë rritjen (dhe jo zvogëlimin) e padrejtësisë sociale, si dhe akumulimin e një fuqie më të madhe shoqërore dhe ekonomike në duart e pak njerëzve. Sot më shumë se kurrë, është i vërtetë fakti se

ata që kontrollojnë kanalet e komunikimit, kontrollojnë edhe çfarë kalon nëpër ato kanale, dhe çfarë konsumojnë përdoruesit e këtyre kanaleve të informimit.

Respektimi i të drejtave të qytetarëve për informacion dhe komunikim, liria e shprehjes, aksesit i lirë në informacion, dhe mbrojtja e privatësisë kërkojnë që shteti të luajë një rol aktiv. Pa këto të drejta është e vështirë që të imagjinohet një qytetar aktiv në fushën sociale, dhe aktivizëm social që mund të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri. Historia politike dhe ekonomike e shteteve moderne ka treguar se rritja e nivelit të survejimit elektronik nuk duhet kuptuar thjesht si problem i lidhur me zhvillimet teknologjike. Në fund të fundit, survejimi teknologjik mund të shmanget duke përdorur teknologji të tjera për të mbrojtur të drejtat tona për informacion. Por kjo kërkon njohuri që nuk ofrohen nga institucionet e sistemit arsimor.

Sipërmarrësit e fushës së teknologjisë, që gjatë dy dekadave të fundit janë bërë edhe pronarë të mediave, apo kanë krijuar ndërmarje të reja mediatike, e paraqesin veten në publik si mbrojtësit e të drejtave të informimit të konsumatorëve të tyre (jo qytetarëve!). Këtu mund të marrim si shembull Mark Zuckerberg, krijuesin e Facebook, të cilit iu desh kohëve të fundit që të justifikohet në publik në lidhje me abuzimet e shërbimeve që ofroreshin nga kompania e tij. Në çdo material të publikuar prej tij përdoret gjerësisht fjala komunitet. Facebook ka bërë të mundur formimin e komunitetit më të madh të komunikimit në histori. Facebook i ka dhënë mundësi miliarda njerëzve që të bëhen pjesë e një komuniteti komunikimi. Një nga argumentet e përdorura në mbrojtje të Facebook është se, kjo platformë është kanali më i rëndësishëm për informacion dhe komunikim për një miliardë përdorues, dhe kjo kompani nuk mund të dënohet për faj të një numri të vogël njerëzish që abuzojnë me shërbimet e ofruara prej saj. Argumenti tjetër që ngul këmbë se shteti nuk duhet të cënojë lirinë e shprehjes, është i ngjashëm me konceptin e **legjislacionit mirëdashës**, një përjasje që nxitej nga pronarët e stacioneve televizive në vitet 90-të. Të gjithë sipërmarrësit në fushën e teknologjisë mendojnë se platformat e komunikimit paraqesin një alternativë pozitive kundrejt mediave të tejngarkuara me ideologji, që i shërbejnë politikave të ngushta kombëtare. Nga ana tjetër nuk është e vështirë të imagjinosh se kujt i shërbejnë platformat online: interesave të pronarëve të tyre, që nuk mund të mbikqyren nga askush – as nga shtetet-kombe, dhe as komuniteti ndërkombëtar si BE. Dhe kjo është pikësisht arsyeja përse edukimi mbi median dhe informacionin ka rëndësi të dorës së parë. Kemi nevojë të mësojmë si funksionojnë platformat e informacionit dhe komunikimit, duhet të mësojmë si funksionojnë algoritmet, dhe kush e kontrollon procesin e komunikimit. Edukimi mbi median dhe informacionin nuk është vetëm një detyrë individuale për secilin prej nesh, por është edhe një përgjegjësi e politikave publike.

4. Kulti i informacionit

Gjatë 20 viteve të fundit termi informacion është bërë i pashmangshëm në diskutet akademike apo politike në lidhje me median dhe komunikimin. Për këtë arsye flasim për shoqëri informacioni (që trumbetohet nga të gjithë), ekonomi informacioni, vlerën e informacionit, dhe privatësinë e informacionit. Ajo që ka rëndësi për studimin tonë është problemi se, termi informacion përdoret pak a shumë si xhol: që nga formulat matematike, parashikimi i motit dhe cilësia e rrugëve, deri tek artikujt e gazetarisë. Ky term u huazua nga shkencat humane prej kibernetikës, dhe fillimisht i referohej jo vetëm komunikimit njerëzor por edhe komunikimit të njerëzve me makinat, apo edhe të makinave me makinat. Studimet e kryera nga Norbert Wiener frymëzuan teoritë e para të komunikimit, që kishin për qëllim të zbulonin se si ndikon komunikimi në funksionimin e një sistemi: "Informacioni është emërtimi që i japim tërësisë të shkëmbimeve tona me botën që na rrethon ndërsa mundohemi të përshtatemi me të, dhe kjo përshtatje ndikon direkt mbi të" (Wiener 1989, 17). Norbert Wiener interesohej në lidhje me mekanizmat e komplikuar të kontrollit fiziologjik që sigurojnë gjetjen e ekuilibrit të brishtë (homeostazës) në trupin e njeriut. Sipas tij këto mekanizma fiziologjike ishin një lloj sistemi informacioni që funksiononte në bazë të reagimit nga stimujt e jashtëm. Në vitet 60-të dhe 70-të, kibernetika ishte një fushë me shumë interes për studentët e shkencës së informacionit, shkencëtarëve që punonin për zhvillimin e inteligjencës artificiale, dhe pionierët e kulturës kibernetike që mendonin se "makineria informative" paraqiste një mundësi revolucionare për të rivendosur ekuilibrin, apo homeostazën, në shoqëri nëpërmjet reagimit ndaj stimujve nga jashtë. Sidoqoftë, Wiener nuk ishte vetëm një matematicien dhe pionier i kibernetikës. Ai ishte i pari që paralajmëroi për problemet e mundshme me të cilat mund të përballej shoqëria. Ai ishte kundër çdo lloj kulti informativ që filloi të shpërndahej kudo nëpër botë si një virus. Ai kishte frikë se inteligjenca artificiale dhe automatizimi mund të keqpërdorej nga faktorë "anti-homeostatikë," që në të kaluarën kishin shpërdoruar zhvillimet teknologjike

të revolucionit industrial: kapitali, konkurrenca, diktatura e konkurrencës, si dhe etja për fitime. Ai kundërshtonte me forcë pikëpamjen se tregu i lirë është për nga vetë natyra e tij një sistem homeostatik, dhe ngulte këmbë se përplasja e interesave private nuk mund të çonte kurrsesi në formimin e një bote në balancë të përsosur. Ai e krahasonte kapitalizmin me lojën e Monopolit, ku në fund fiton vetëm njëri nga lojtarët, ndërsa të gjithë të tjerët humbasin. Sipas Wiener, një rol të rëndësishëm në krijimin apo prishjen e “homeostazës shoqërore” luan edhe media, e cila funksionon në bazë të rregullave jo-homeostatike të sistemit kapitalist.

Në kapitullin e fundit të librit të tij *Kibernetika (Cybernetics, 1965)*, Wiener shkruan se sistemet informative kapitaliste nuk janë neutrale. Ai na shpjegon se gazetat nuk shiten po nuk patën brenda një dozë të caktuar besimi fetar, pseudoshkence, dhe pornografie. Programet e radios influencohen nga numri i dëgjuesve, analizat e konsumit, dhe sondazhet publike, nëpërmjet të cilave një pronar mediash arrin të mësojë se sa i ndikueshëm është publiku i tyre nga gënjeshttrat dhe manipulimet, me ndihmën e të cilave shiten produkte apo shërbime të caktuara. Për këtë arsye është e vështirë që të identifikojmë informacionin e duhur në media, megjithëse mund të jetë i vërtetë, pasi një numër i madh informacionesh të tjera (po aq të rëndësishme) janë lënë jashtë raportimit, apo nuk janë përmendur qëllimisht. Për të zbuluar se kush po e prish homeostazën në shoqëri, në fillim duhet të gjejmë se kush kontrollon mjetet e komunikimit në shoqëri. Janë pikërisht këto sisteme komunikimi, dhe problemet në funksionimin e tyre, që ndalojnë arritjen e homeostazës. Problemi i parë ka të bëjë me nevojën dhe aspiratat e sistemit për të nxjerrë fitime: mediat jo fitimprurëse, apo mediat që nuk nxjerrin fitime të mjaftueshme, zëvendësohen nga media që sjellin më shumë fitime. Problemi i dytë ka të bëjë me pronësinë mbi mjetet e komunikimit në një shoqëri. Pronarët e këtyre mjeteve të komunikimit janë një grup i vogël njerëzish të pasur që duan që sistemi të mos ndryshojë asnjëherë. Problemi i tretë lidhet me dëshirën e pronarëve të medias për të patur pushtet politik. Sa më shumë kohë që mediat të lihen në mëshirë të kësaj loje pushteti dhe parash, aq më e vështirë do të jetë që të funksionojnë në të mirë të interesit publik. Duket qartë se këndvështrimi i Wiener-it mbi “shoqërinë e informacionit” është shumë larg nga opinioni dominant mbi depolitizimin e teknologjisë të informacionit në ditët tona. Është pra e kuptueshme përse të gjitha paralajmërimet e tij në lidhje me forcën shkatërruese të teknologjisë së informacionit janë fshirë nga debati publik.

Determinizmi teknologjik (“shoqëria e informacionit sjell avantazhe për të gjithë”) nuk ka patur ndonjëherë bazë as në teori e as në praktikë. Doktrina zyrtare e ekonomisë së re të informacionit (ekonomia digjitale, sektorët krijues të biznesit) bazohen kryesisht mbi idenë se teknologjia bën të mundur lëvizjen e lirë të kapitaleve dhe shërbimeve

(por jo njerëzve), duke anashkaluar kufizimet e vendosura nga shtetet-kombe, pa kufizime dhe pa tatime. Një nga mësimet e vyera të historisë është se, përdorimi jodemokratik i informacionit dhe teknologjive të komunikimit në ditët e sotme vetëm mund të përkeqësohet në të ardhmen. Wiener e dinte shumë mirë këtë gjë. Në librin e tij *Kibernetika dhe Shoqëria (Cybernetics and Society)*, ai shkroi: "Mjerë ne, nëse e lëmë atë [makinë] që të diktojë veprimet tona, përveç rastit kur e njohim shumë mirë mënyrën e saj të funksionimit, dhe e dimë me siguri se aktiviteti i saj do të bazohet në parime dhe kushte të pranueshme për ne! (...) Ai që nuk është i sigurtë për këtë, dhe përsëri heq dorë nga një pjesë e vullnetit dhe përgjegjësisë së vet në favor të makinës, pavarësisht nëse ajo është në gjëndje të mësojë apo jo, është njëlloj sikur ta hedhësh përgjegjësinë rrugëve, dhe më pas të rrëshqasësh në momentin e parë që shkel mbi të" (Wiener 1989, 185).

Punëtorët u detyruan që të angazhoheshin në rezistencë të organizuar për t'i detyruar politikanët që të mos mendonin mbi të drejtat e punëtorëve vetëm në raport me rritjen apo uljen e rendimentit të prodhimit, por të merrnin në konsideratë edhe shfrytëzimin e padrejtë të punëtorëve, dhe të drejtën e tyre për shpërblim të drejtë dhe kushte të sigurta pune. Pjesëtarët e një grupi shoqëror që cilësohej si "jo normal," sipas standardeve burokratike të kohës, iu desh të luftonin për të drejtat e tyre politike dhe njerëzore për dekada dhe shekuj me radhë, në përpjekje për barazi. Ndotja e ambientit konsiderohej për një kohë të gjatë si një pasojë e pashmangshme e industrializimit, deri sa kjo çështje u bë problem nga grupet e organizuara të aktivistëve ambientalistë, që mbronin tezën se mbrojtja e natyrës është detyrë për të gjithë ne, për të mbrojtur hapësirën e përbashkët jetike, dhe jo interesat private të pronarëve të fabrikave. E njëjta gjë edhe me edukimin për median. E drejta për një media të besueshme, që i shërben interesave të publikut dhe siguron aksesin e masave të gjera në informacione me rëndësi për publikun, është një e drejtë themelore e komunikimit, dhe respektimi i saj duhet të sigurohet nga shteti, duke pranuar faktin se liria e shprehjes është një e drejtë që i përket të gjithëve, dhe jo vetëm atyre që zotërojnë mjetet e komunikimit.

5. Edukimi mbi median dhe informacionin - përgjegjësi e shtetit

Në kuadër të studimit tonë, e kemi përkufizuar edukimin mbi median dhe informacionin si "aftësi njohëse, teknike dhe shoqërore, dhe zotësi të qytetarëve për të patur akses, të vlerësojnë në mënyrë kritike, të përdorin dhe të prodhojnë informacion e përmbajtje mediatike në platformat teknologjike tradicionale dhe digjitale mediatike dhe informative, duke e njohur mirë mënyrën e funksionimit të këtyre platformave dhe teknologjive; duke ditur si të mbrojnë të drejtat e veta dhe të tjerëve ndërkohë që përdorin këto platforma; duke ditur si të identifikojnë dhe të shmangin përmbajtje të dëmshme ndërkohë që kërkojnë për informacion, për përmbajtje dhe platforma mediatike, me qëllim që të përmbushin nevojat e tyre të komunikimit dhe interesat e tyre si individë, dhe si pjesëtarë të komunitetit, dhe pjesëmarrjes aktive dhe të përgjegjshme në sferat tradicionale dhe digjitale dhe në proceset demokratike." Sipas mendimit tonë, ky përkufizim mundohet të përmbledhë të gjitha elementet kryesore dhe mbulon plotësisht objektivat e edukimit mbi median. Studiues nga pesë vende të rajonit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia) kanë marrë pjesë në këtë proces analizimi të situatës mbi edukimin e medias në disa mënyra të ndryshme, dhe duke u përqëndruar në tema të ndryshme: që nga palët e përfshira në proces, iniciativat e shoqërisë civile, dhe roli i mediave publike, deri tek qëndrimet që mbajnë studentët dhe pedagogët në raport me efektshmërinë e modeleve aktuale të sistemit arsimor në lidhje me edukimin për median. Duket qartë se asnjë nga këto vende nuk ka ndonjë politikë sistematike afatgjatë në këtë fushë, dhe shpesh nxitja për futjen e këtij subjekti në sistemin arsimor apo zbatimin e projekteve studimore vjen nga organizma apo donatorë ndërkombëtarë. Edukimi mbi median përmendet vetëm si fjalë goje, por nuk ka ndonjë ide të qartë përse është aq e rëndësishme, dhe nuk dihet akoma si të sigurohemi nëse modelet aktuale për edukimin e medias po funksionojnë ashtu si duhet. Në shumicën e rasteve, detyra për të përmirësuar edukimin

mbi median tek qytetarët i lihet në dorë sistemit arsimor, shoqërisë civile, dhe institucioneve rregullatore të medias, por angazhimi aktiv i vetë mediave në këtë proces është shumë i rrallë.

Duke patur parasysh gjendjen e medias dhe zhvillim e formave të reja të komunikimit në platforma të ndryshme, edukimi mbi median dhe informacionin është një element kyç i politikave mbi median. Politikat dhe dokumentet evropiane në këtë fushë ia lënë në dorë shteteve që të hartojnë dhe zhvillojnë modele sa më të efektshme për edukimin mbi median. Në disa vende, një rol të rëndësishëm në këtë fushë po luajnë mediat publike; në vende të tjera ky rol luhet nga institucionet rregullatore të medias; ndërsa shumica e vendeve kanë përfshirë elemente të këtij subjekti në programet shkollore. Sidoqoftë, edukimi mbi median dhe informacionin duhet të ngrihet në një sistem që të arrijë të edukojë të gjithë qytetarët, dhe duhet të bëhet pjesë e pandarë e edukimit të përgjithshëm, me qëllim që të kemi qytetarë të arsimuar dhe të mirëinformuar.

Në këtë moment, kur hapësira mediatike është kthyer në një rrjet të dendur burimesh të ndryshme informacioni, gjëja më e rëndësishme për të gjithë ne është të zhvillojmë aftësinë për të zgjedhur një burim të besueshëm informacioni me lajme të vërteta, dhe kjo është mënyra më e mirë për të kuptuar problemet që ndikojnë në perceptimin tonë për botën. Në këtë kakofoni zërash, media është vetëm një nga burimet e informacionit, madje për shumë njerëz nuk është as burimi më i rëndësishëm për lajme. Për një kohë të gjatë, në vend që të ndërmerren reforma serioze dhe masa për rregullimin e sistemit në mënyrë që të rikthehet besimi i njerëzve tek media dhe institucionet, politika për median e BE-së është përqëndruar tek edukimi mbi median, si një masë për të zbutur problemet e shkaktuara nga papërgjegjshmëria e mediave dhe platformave të komunikimit. Njerëzit duhet të edukohen mbi median, për të qenë në gjendje të vendosin se cili organ mediatik me të vërtetë e meriton besimin e tyre (apo nuk e meriton). Në vend që të kërkohet nga media që të respektojë standardet profesionale të gazetarisë, dhe të ndëshkohet mungesa e profesionalizmit, tani është konsumatori i medias ai që duhet të sigurohet mbi profesionalizmin e përmbajtjes mediatike. Nga ana tjetër individ i nuk ka thuar asnjë ndikim mbi vetë politikën e medias, apo mënyrën si funksionon media në fjalë. Problemi qëndron edhe në faktin se nuk jemi në gjendje as të përcaktojmë se kush ka njohuri të mjaftueshme mbi median dhe kush jo (si dhe ideja se është faji yt nëse je i paditur). Po kështu nuk e dimë akoma nëse programet aktuale për edukimin mbi median arrijnë vërtetë ta edukojnë publikun. Në rastin e edukimit dhe arsimimit kundër analfabetizmit e dimë kush di shkrim e këndim, kush është analfabet, dhe kush është pjesërisht analfabet. Kështu, e dimë që personat që nuk janë

analfabetë dinë shkrim e këndim, dhe supozohet se duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë përmbajtjen e tekstit, dhe të arrijnë të kuptojnë se çfarë po lexojnë. Kjo garantohet falë sistemit arsimor dhe mekanizmave të shumta institucionale që sigurohen mbi nivelin e alfabetizimit të secilit individ. Natyrisht që ka edhe sisteme të dobëta arsimore, shkolla të këqija, mësues jo të zotë, programe të dobëta arsimore dhe studentë që kanë vështirësi të mësojnë. Sidoqoftë, sistemi ka mundësi dhe kapacitete që t'i riparojë këto të meta. Nga ana tjetër, në rastin e edukimit mbi median askush nuk mban përgjegjësi, edhe nëse shumica e popullatës është analfabete në lidhje me median dhe informacionin. Po kështu, as sektori i medias që prodhon përmbajtjen mediatike nuk mban asnjë përgjegjësi mbi vete, megjithëse është pjesë e problemit. Ideja se më parë duhet të njohim mirë teknologjinë përpara se të njihemi me median është krejtësisht e gabuar. Nuk ka nevojë të dish si shtypet një libër që ta lexosh me qejf. Kemi redaktorët, shtëpitë botuese, kritikët, dhe bibliotekat që kujdesen për përmbajtjen e librave. Por, imagjino pak sikur të gjithë këto të mos ekzistonin. Kush do të na ndihmonte për të zgjedhur një libër të mirë? Persona anonimë që shkruajnë recensione në librari online, apo algoritmet që përcaktojnë renditjen e informacioneve në programet e kërkimit? Analfabetët mediatikë nuk kanë ndonjë ide të qartë, apo kritere, që të dallojnë midis informacioneve të vërteta dhe të rreme në internet. Dhe jo vetëm kaq. Analfabetët mediatikë mund të shpërndajnë tek të tjerët informacionet që kanë zgjedhur për vete në internet (që në shumë raste mund të jenë lajme të rreme). Është disi naive të mendohet se mund ta zgjidhim këtë problem duke arsimuar dhe edukuar sa më shumë persona të kemi mundësi në lidhje me median. I gjithë sistemi mediatik ka nevojë të "edukohet". Koncepti i politikave mediatike si pjesë përbërëse e politikave publike nuk është një nocion ideologjikisht neutral. Edukimi mbi median nuk mund të jetë thjesht një element mbështetës i sistemit. Në thelb, edukimi mbi median i ndihmon njerëzit që të njohin mënyrën si funksionon industria e medias dhe platformat e komunikimit. Për këtë arsye, do t'i referohemi autorëve që studiojnë pedagogjinë kritike të medias, dhe do të sugjerojmë rrugën që duhet ndjekur për të zhvilluar një sistem të shëndoshë edukativ dhe arsimor.

Trajtimi teorik i këtij problemi nga Iris Marion Young, në studimin e saj mbi multi-kulturalizmin, sugjeron një drejtim të mundshëm që mund të marrë zhvillimi i një sistemi kritik (radikal) për edukimin mbi median dhe informacionin. Sipas Young, ajo që ne konsiderojmë pjesëmarrje në demokraci ka kaluar në fazën e demokacisë paradoksale, pasi zëri i grupeve shoqërore jo të privileguara është mbytur, dhe vetëm klasa e privileguar mund të ketë pushtet në shoqëri. Ajo mendon se është e nevojshme një njohje më e thellë e politikës, dhe se nuk duhet

të ngecim tek një sistem që kërkon të depolitizojë çdo politikë publike. Po kështu edhe proceset e miratimit demokratik të vendimeve janë elemente të rëndësishme dhe të domosdoshme për krijimin e një shoqërie të drejtë (Young 2005, 17). Njohja dhe pranimi i grupimeve të ndryshme në shoqëri, si dhe inkurajimi i grupeve të ndryshme shoqërore që të vetë-organizohen në mënyrë të pavarur, dhe më pas të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në jetën publike, duhet të jetë në themel të politikave demokratike (Young 2005, 222). Young flet për një publik heterogjen, që inkurajon grupimet shoqërore që të vetë-organizohen dhe të angazhohen në proceset vendim-marrëse, megjithëse ky proces përfshin edhe përplasje opinionesh dhe debat publik. Një publik heterogjen është një publik ku pjesëmarrësit diskutojnë mbi problemet e shoqërisë dhe bien dakord me vendimet e marra, në bazë të parimeve të drejtësisë. Çdo politikë publike duhet gjithashtu që të marrë në konsideratë edhe opinionet e atyre që përjashtohen në mënyrë sistematike nga debati publik (Young 2005, 231). Modeli i një publiku heterogjen është krejtësisht i kundërt nga publiku njëbllokësh (monolitik), gjë që lidhet në mënyrë të pandashme me punën dhe funksionimin e medias. Mediat informojnë dhe formëzojnë audiencat e tyre. Ata vendosin se kush mund të flasë dhe për kë mund të flitet, si dhe vendosin se cili këndvështrim është i pranueshëm dhe cili jo.

Mediat janë një burim i rëndësishëm pedagogjike kritike, por shpesh ky rol keqkuptohet. Ato na sugjerojnë si të sillemi, çfarë (dhe për çfarë) të mendojmë, çfarë të ndiejmë, çfarë të besojmë, cilës gjëje duhet t'i trembemi, dhe çfarë duhet të dëshirojmë – dhe për rrjedhojë mediat na sugjerojnë edhe gjërat që nuk duhet të bëjmë. Media kryejnë rolin e një "sistemi arsimor" jozyrtar (një lloj plani mësimor shoqëror) që na mëson si të rritemi dhe të bëhemi burrë apo grua, si të vishemi, çfarë imazhi do të paraqesim në publik, si t'i shpenzojmë paratë, si të komunikojmë me pjesëtarët e grupeve të tjera shoqërore, si të bëhemi të pëlqyeshëm nga të tjerët, si të bëhemi të suksesshëm dhe të shmangim dështimet, si të përshtatemi me vlerat dhe normat e shoqërisë, deri tek metodat e punës dhe kërkesat e institucioneve. Emisionet dhe spektaklet në media na tregojnë se kush e ka në dorë pushtetin në shoqëri, dhe kush është pa pushtet. Na tregojnë gjithashtu se kujt i lejohet të përdorë forcë dhe dhunë, dhe kujt jo. Media legjitimizon pozitat e atyre që kanë pushtetin, dhe ekspozon pafuqinë e atyre që nuk kanë pushtet (Kellner 2003, 11).

Pedagogjia kritike (ashtu si edhe pedagogjia kritike e medias) kërkon që studiues dhe akademikë të ndërtojnë konceptet e qytetarisë kritike, të krijojnë një terminologji të re, si dhe të jenë të vetëdijshëm në lidhje me pozicionin e tyre kulturor dhe politik (Giroux 1996, 77). Problemi kryesor në këtë pikë është çështja nëse mediat

janë "aleate" apo "armike" në këtë proces, dhe kjo pyetje zë vend parësor në studimet kritike të medias, sidomos në veprat e Douglas Kellner (1995, 2003). Është me vend të mendohet se reflektimi mbi fuqinë që ushtron media nuk mund të jetë vetëm e drejta (apo detyra) e qytetarëve, por kjo duhet të jetë mbi të gjitha detyrë e vetë sistemit të mediave. Po kështu, edhe vetë pedagogjia e medias duhet të reflektojë mbi vetë pozitën e saj në pushtet në atë fushë që ne e quajmë "mësimi mbi median".

Sipas Kellner, përfitimi i njohurive dhe aftësive në lidhje me njohjen e thellë të medias është mënyra më e mirë për të bërë zgjedhjen e duhur në mes të morisë së informacionit përreth nesh. Të mësosh shkrim e këndim, të mendosh në mënyrë kritike, dhe t'i rezistosh manipulimeve social-kulturore të medias, është mënyra më e mirë për të qenë sovran i vetes tënde gjatë konsumimit të kulturës mediatike (Kellner 2003, 9-10). Sidoqoftë, përmirësimi i pozitave në sferën e konsumit mediatik nuk ndikon në asnjë farë mënyre në ekuilibrin e pushteteve përbrenda sistemit mediatik. Të qëniti i ndërgjegjshëm mbi ekzistencën e manipulimeve mediatike dhe limitet e medias nuk sjell asnjë ndryshim në raportet e pushtetit në fushën e komunikimit. Konsumatori "kritik" i medias ngelet po konsumator, dhe jo prodhues i përmbajtjes mediatike. Pushteti i individit, sado i madh të jetë, nuk mund të krahasohet me pushtetin e vetë medias. Ndërsa, në rastin e mediave sociale, aftësia për të bërë zgjedhjen e informacionit të duhur dhe përgjegjësia në komunikimin publik janë elemente kyçe në procesin e edukimit mbi median.

Edukimi mbi median dhe informacionin duhet t'i nxitë njerëzit që të zbulojnë mënyrat se si strukturat e pushtetit dhe dominimit ndërthuren me mesazhin e medias dhe praktikat e punës në media. Ne duam të theksojmë edhe njëherë se thjesht të kesh dijeni, dhe të dallos ndikimin e pushtetit dhe dominimit në media, kjo nuk shkakton vetvetiu korrigjimin e situatës dhe zgjidhjen e problemit. Edukimi mbi median dhe informacionin duhet të ndihmojë jo vetëm në identifikimin e formave të ndryshme të praktikave apo manipulimeve mediatike, por duhet të shërbejë edhe si mjet për të sjellë ndryshimin, dhe për të krijuar një hapësirë të komunikimit publik ku parimet e pluralizmit, integritetit, besueshmërisë, dhe respektit për interesin publik respektohen dhe zhvillohen më tej.

Kur flet për studime kulturore, Kellner thotë se edukimi mbi median dhe informacionin nuk është thjesht një trill akademik por mund (dhe duhet) të kthehet në një mjet për të luftuar për një shoqëri më të mirë (Kellner 2003, 19). Edukimi mbi median dhe informacionin duhet të mundësojë një paraqitje të medias në disa aspekte të ndryshme: a) në aspektin e prodhimit dhe ekonomisë politike, b) në aspektin e analizës të prodhimit mediatik, c) në aspektin e marrjes dhe përdorimit të teksteve të medias, ku termi tekst i referohet të gjitha llojeve të produkteve mediatike

(Kellner 2003, 12). Edhe David Buckingham, në librin e tij *Edukimi i Medias (Media Education 2003, 54-69)*, bën një paraqitje të studimit kritik mbi median që përmban katër nivele analizash: niveli i prodhimit në media; niveli i "gjuhës" të përdorur në media; niveli i përfaqësimit në media; dhe niveli i analizimit të audiencës. Siç duket qartë, këto elemente janë përfshirë edhe në përkufizimin tonë të edukimit mbi median dhe informacionin.

Procesi i edukimit për të vlerësuar median me sy kritik (pedagogjia kritike e medias) nuk ka të bëjë vetëm me përmirësimin e njohjes së medias nga nxënësit dhe studentët duke i mësuar si të lexojnë, analizojnë dhe zbërthejnë tekstet në media, si të përdorin teknologjinë e informacionit si mjet për të shprehur dhe prodhuar tekstet e veta; në fakt pedagogjia kritike e medias është më shumë se kaq. Frazja "më shumë se kaq" i referohet formimit të një qëndrimi kritik kundrejt produkteve mediatike dhe interpretimeve të tyre, dhe mënyrës se si ta përdorim median si mjet shprehës dhe në funksion të aktivizmit social (Kellner, 2003, 551). Kellner paralajmëron se pedagogjia kritike e medias dhe aktivizmi social kërkon që intelektualët të luajnë një rol të ri në shoqëri, veçanërisht tani që teknologjia e informacionit po krijon hapësira të reja për konflikt politik dhe ndërhyrje.

Sipas një politike demokratike mediatike, teknologjia e informacionit duhet të zhvillohet në shërbim të popullit, për të informuar dhe edukuar individët, dhe jo (vetëm) të përdoret për të mbrojtur interesat e pronarëve të medias. E ardhmja e demokracisë varet shumë nga fakti se kush do të jetë në kontroll të platformave të medias dhe komunikimit, sa akses do të ketë publiku në këto platforma, dhe si do të vlerësohet përgjegjshmëria dhe besueshmëria e mediave, financimi dhe funksionimi institucional i tyre në shërbim të publikut. Për pasojë nuk mjafton vetëm aktivizmi qytetar (megjithëse ka rëndësi shumë të madhe), por nevojitet edhe një angazhim aktiv nga ana e shtetit, që duhet t'i "kthejë" popullit lirinë e shprehjes. Për këtë arsye, përjasjet aktiviste dhe analitike janë në një farë mënyre të gërshetuara bashkë në nocionin e edukimit mbi median dhe informacionin. Përpjekjet për të ravijëzuar qartazi edukimin mbi median dhe informacionin si një mjet analitik, për të kuptuar se si funksionon industria mediatike, përqëndrohen kryesisht në formëzimin e një qëndrimi aktivist të individëve përballë konsumit mediatik.

Natyrisht, ky është një koncept i hapur dhe mund të diskutohet kryesisht në nivel demonstrativ – nëpërmjet krahasimit të praktikave të ndryshme të punës (shumica janë praktika ekzistuese). Qëllimi kryesor i studimit tonë ishte që të krijonim një hartë të fushës që po analizohet. Gjatë punës sonë kemi evidentuar praktika të mira pune dhe përpjekje për të transformuar ide në politika konkrete publike në secilin nga vendet që kemi marrë në

studim. Ky bagazh me njohuri fillestare ka rëndësi të veçantë për ndërmarrjen e përpjekjeve të mëtejshme në këtë fushë. Këto përpjekje të copëzuara, që janë ndërmarrë kryesisht nga individë aktivistë dhe nga shoqëria civile, duhet të transformohen në politika publike koherente me objektiva të qarta, me palë të interesuara që identifikohen qartazi, si dhe me tregues të qartë performance.

Rezultati më negativ që mund të vijë si pasojë e këtij procesi do të jetë që edukimi mbi median dhe informacionin të kthehet në një kalë troje të politikave liberale që relativizojnë të drejtat e njerëzve, duke i reduktuar ato deri tek mundësia për të zgjedhur midis formave të ndryshme të konsumit mediatik. Në këtë këndvështrim relativist, shqyrtimi me sy kritik i medias, dhe përballja me median dhe përmbajtjen mediatike në pozita të forta analitike, është vetëm një nga opsionet që kemi ne si qytetarë. Po çfarë mundësish të tjera na vihen përpara? Të mbetemi analfabetë mediatikë, dhe të katandisemi të pranojmë pa u ankuar të gjitha manipulimet që na vijnë nga media? A mund të konsiderohet kjo me të vërtetë një alternativë? Kjo lloj politike shmang në mënyrë të papranueshme çdo lloj përgjegjësie në lidhje me respektimin dhe ushtrimin e një të drejte themelore të qytetarëve. Nga ana tjetër, situata që përjetojmë në ditët e sotme, ku njerëzit mbyllen brenda një fluske xhami duke filtruar çdo informacion që arrin tek ta, nuk është edhe shumë larg kësaj. E drejta për lirinë e shprehjes po përdoret shpesh për të mbrojtur forma të papranueshme diskriminimi kundër individëve apo grupeve që nuk kanë mundësi komunikimi (p.sh., refugjatët). Kundërpërgjigja ndaj kësaj vale dezinformimi dhe manipulimi është edukimi dhe krijimi i një konsumatori mediatik që nuk humbet rrugën në labirintin e informimit, dhe që di të bëjë dallimin ndërmjet informacionit të vërtetë dhe gënjeshtreve. Sot mund të gjesh një sasi të madhe informacioni në platforma që legjislacioni aktual nuk i konsideron fare si media. Të dhënat personale janë kthyer në monedha që përdoren nga kompanitë e mëdha të telekomunikacionit në këmbim të aksesit në platformat që kanë në pronësi. Pluralizmi në media është shndërruar në një pafundësi mundësish për të zgjedhur gjithmonë po të njëjtën gjë. Monokulturat mediatike mund të sjellin pasoja drastike për mediat sociale. Mbyllja brenda fluskave personale të filtrimit krijon një hapësirë komunikimi ku njerëz që mendojnë në të njëjtën mënyrë komunikojnë vetëm me njëri-tjetrin brenda grupit, dhe kalojnë kështu në pozicione akoma më të radikalizuara. Kemi arritur në një pikë ku, megjithëse jemi në komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin, nuk arrijmë dot as të biem dakord se cilat janë faktet. Relativizimi i të vërtetës, relativizimi i të drejtave të qytetarëve, dhe në fund edhe relativizimi i demokracisë mund të kenë pasoja shkatërrimtare për të ardhmen e të gjithë neve. Edukimi mbi

median dhe informacionin nuk është një formulë magjike që do të zgjidhë të gjitha problemet e akumuluar ndër vite. Sidoqoftë, po ndërmarrim hapin e parë dhe po e pranojmë që kemi një problem që duhet t'i gjejmë zgjidhje. Edward O. Wilson thotë se pranimi i relativizmit kulturor total na pengon që të kuptojmë se çfarë kemi të përbashkët, dhe çfarë do të thotë të jesh pjesë e shoqërisë njerëzore. Nëse bazat etike të një shoqërie kushtëzohen nga normat kulturore, dhe nëse kulturat janë pafundësisht të ndryshme dhe të barabarta, mbi çfarë baze mund t'i kundërvihemi regjimeve teokratike, skllavërisë, torturës, apo punës së të miturve (Wilson 1999, 201)? Shkenca nuk është thjesht manifestimi i një botëkuptimi i veçantë, as nuk përfaqësohet vetëm nga njëra prej nënkulturave intelektuale përreth nesh, thotë Wilson.

Ideja se është e mundur që të kemi një debat publik racional, megjithëse palët janë në pozita të pabarabarta përsa i përket pushtetit në fushën e komunikimit, është një koncept i komplikuar nga ana akademike, por është edhe e vështirë të vihet në zbatim si praktikë mediatike. Të komunikosh do të thotë të kërkosh që të arrish një marrëveshje apo mirëkuptim në lidhje me çështjet thelbësore që e mbledhin shoqërinë së bashku (communis – opinione të përbashkëta) dhe interpretimin e tyre. Kjo nënkupton dialog të vazhdueshëm dhe respekt për opinionet e bashkëbiseduesit. Pjesa më e madhe e komunikimit në ditët tona nuk bazohet në këtë parim. Komunikimi mediatik bazohet në formimin e një publiku sa më të madh që të jetë e mundur, dhe më pas në shitjen e kësaj audience në tregun e reklamave. Për median, çdo lloj audience është e rëndësishme për sa kohë që sjell para nga reklamat. Media nuk është një hapësirë që mundëson komunikim të hapur publik (parim mbi të cilin bazohet koncepti liberal i sferës publike), por është një treg njëbllokësh ku informacioni, prodhimi dhe konsumi mediatik bazohet mbi rregullat e tregut. Deri më sot, ideja e pedagogjisë kritike të medias ka ngelur "përgjysëm." Domethënë, sistemi mediatik mund të transformohet në krahun e konsumit por jo në krahun e prodhimit. Në këtë pikë del në pah pjesa më kritike dhe potenciali emancipues i edukimit mbi median dhe informacionin: që qytetarët të dalin me kërkesën radikale që platformat e medias dhe komunikimit të punojnë në favor të interesit publik (Sen 2006; Nussbaum 2006).

6. Studimi rajonal

Ky studim rajonal u ndërмор për të hartuar një tablo dhe për të krijuar një ide më të qartë të situatës dhe nivelit të zhvillimit në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, dhe u zhvillua gjatë periudhës prill - tetor 2018. Ky studim pati si pikënisje rëndësishme që i kushtojnë edukimit mbi median dhe informacionin shumë institucione dhe organizata evropiane, çka sugjeron se edukimi mbi median dhe informacionin mund të jetë përgjigja për një sërë problemesh të akumuluar ndër vite, dhe mangësitë në politika dhe praktika mediatike, si për shtete të veçanta ashtu për të gjithë Evropën.³

Baza konceptuale, ashtu si dhe axhenda, programi i aktiviteteve, dhe përqsja strategjike ndaj edukimit mbi median dhe informacionin në rajonin tonë, është formëzuar më së shumti nga organizatat ndërkombëtare si UNESCO, UNICEF, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, dhe OSBE. Ato punojnë me qeveri dhe OJQ, dhe nxitin lëvizjen e lirë të dijeve dhe njohurive, si dhe luajnë rolin e donatorëve për aktivitete të ndryshme në këtë fushë. Negociatat dhe përgatitjet për hyrjen në BE përcaktojnë axhendën politike, dhe ndikojnë mbi mënyrën se si trajtohet edukimi mbi median në vendet e rajonit nëpërmjet miratimit dhe adoptimit të direktivave të BE-së mbi shërbimet e mediave audiovizive, kushteve e kërkesave të këtij akti ligjor dhe dokumenteve të tjera të BE-së që

3 Një përshkrim i tillë për edukimin mbi median dhe informacionin mund të gjendet, për shembull, në një raport të përgatitur nga një grup ekspertësh të caktuar nga Komisioni Evropian për të bërë një analizë të situatës dhe për të propozuar masa dhe politika mediatike për të luftuar "lajmet e rreme dhe dezinformimin në internet". Raporti *Një Përqsje Multi-dimensionale ndaj Dezinformimit (A Multi-dimensional Approach to Disinformacion)* u publikua në Mars 2018. Në të njëjtën kohë Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi dokumentin *Rekomandime për Shtetet Anëtare mbi Pluralizmin në Media dhe Transparencën* (Këshilli i Evropës 2018), që përfshin një listë masash në fushën e edukimit mbi median që duhet të merren nga shtetet për të mbrojtur pluralizmin në media dhe transparencën.

janë adoptuar nga legjislacionet kombëtare. Faktorët ndërkombëtarë mobilizojnë organizata partnere në rajon dhe ofrojnë goxha mbështetje për projekte, në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Studimi ynë u krye në një kohë kur koncepti i hershëm i edukimit mbi median po zgjerohej më tej, që të përfshinte edhe edukimin mbi informacionin, si dhe koncepte të tjera si edukimi mbi të dhënat kompjuterike, dhe njohja me teknologjinë digjitale. Për këtë arsye, hapi i parë në studimin tonë ishte që të binim dakord për një përkufizim të edukimit mbi median dhe informacionin, që më pas u përdor në punën tonë kërkimore, dhe shërbeu si bazë për hapat e mëvonshëm në këtë studim. Kjo u pasua nga shqyrtimi i literaturës përkatëse, analiza të studimeve të mëparshme, dokumentacione ligjore dhe strategjike në lidhje me edukimin mbi median dhe informacionin në secilin nga të pesë shtetet. Pjesa më e rëndësishme e fazës së parë të punës studimore ishte identifikimi i palëve të interesuara, iniciativave kryesore mbi këtë proces, projekteve dhe aktiviteteve që merren me avancimin e edukimit mbi median dhe informacionin në të pesë shtetet e përfshira në këtë studim.

Kemi krijuar 11 kategori të ndryshme për lehtësi referimi dhe shpërndarje të njëtrajtshme të palëve të interesuara. Këto janë organizma dhe institucione shtetërore që hartojnë politika dhe drejojnë fushën e promovimit dhe zhvillimit të edukimit mbi median dhe informacionin; institucione dhe palë të angazhuara në sistemin arsimor; institucione dhe organizata që bëjnë trajnimin e trajnerëve në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin; organizata të shoqërisë civile; faqe interneti, platforma dhe portale që merren kryesisht me promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin; palë të angazhuara në industrinë mediatike (media private, publike dhe media jo-fitimprurëse, media tradicionale dhe media digjitale); palët e angazhuara në industrinë e filmit dhe lojërave të fatit; institucione dhe komunitete kërkimore e akademike; rrjete me një numër të madh palësh të interesuara, që janë krijuar për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin; si dhe bibliotekat.

Po kështu, kemi ndarë në disa kategori edhe projektet kryesore, iniciativat dhe aktivitetet në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin. Gjatë këtij procesi, u bazuam në një përqasje metodologjike në krijimin e një tabloje aktivitetesh për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin në 28 shtete të BE-së, që është përdorur nga Observatori Audioviziv i Këshillit të Evropës në vitin 2016. Ky model u modifikua pjesërisht dhe krijuam një listë me pesë kategori aftësish dhe zotësish (kompetenca) që kanë dalë në pah si rezultat i një projekti apo aktiviteti të caktuar në rajon. Këtu po renditim pesë aftësitë dhe zotësitë: aftësia për të kërkuar

dhe për të përdorur informacion, përmbajtje dhe shërbime mediatike në mediat tradicionale e digjitale, dhe platformat e teknologjitë e informacionit; aftësia e krijimit, prodhimit, dhe shpërndarjes së përmbajtjes mediatike dhe informacionit në formate të ndryshme dhe me zgjuarsi; aftësia për mendim kritik, vlerësim dhe përvetësim të medias dhe informacionit; ndërgjegjësimi dhe angazhimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe barazisë sociale; si dhe zotësia për pjesëmarrje dhe bashkëveprim social. Ne analizuam me hollësi informacione mbi aktivitetet dhe iniciativat më të rëndësishme që promovonin dhe zhvillonin më tej edukimin mbi median dhe informacionin: aftësitë që promovohen; sektorin (apo kategorinë) ku po zbatohet projekti si dhe institucionin apo organizatën që po e drejton; grupet që synohen të arrihen; periudhën e zhvillimit; financimin; si dhe arsyen pse një aktivitet i caktuar mendohet të ketë rëndësi të veçantë.

Morëm në analizë 58 nga aktivitetet dhe iniciativat më të rëndësishme që promovonin dhe zhvillonin më tej edukimin mbi median dhe informacionin në pesë vende: nëntë në Shqipëri, 14 në Bosnjë dhe Hercegovinë, 12 në Maqedoni, shtatë në Mal të Zi, 11 në Serbi; si dhe pesë aktivitete në nivel rajonal, që mund të jenë aktivitete të zhvilluara në disa vende njëkohësisht, apo aktivitete ku merrnin pjesë palë të interesuara nga disa vende të rajonit.

Vumë re se shoqëria civile ishte angazhuar në këtë proces shumë më tepër se të gjitha palët e tjera të interesuara, duke marrë pjesë aktive në projektet kryesore, iniciativat dhe aktivitetet në fushën e promovimit dhe zhvillimit të edukimit mbi median dhe informacionin: shumica e atyre që drejtonin dhe merrnin pjesë në këto aktivitete vinin nga ky sektor. Pas shoqërisë civile u renditën organizmat dhe autoritetet shtetërore dhe institucionet arsimore, palë të interesuara nga komuniteti akademik dhe shkencor, faqet e internetit, platforma dhe portale që fokusohen mbi elementë të ndryshëm të edukimit mbi median dhe informacionin. Disi më pak aktive ishin media, industria e filmit dhe teknologjisë së informacionit, si dhe bibliotekat. Biblioteka kombëtare ka luajtur rol aktiv në Mal të Zi, por jo dhe aq në Shqipëri dhe Serbi, ku janë bibliotekat e shkollave ato që bashkëpunojnë më shumë me projektet e shoqërisë civile, dhe angazhohen në iniciativa që të transformohen në infoteka shkollash dhe organizma për edukim mbi median.

Shumica e 58 iniciativave, projekteve dhe aktiviteteve që kemi veçuar për studim kishin në qendër të vëmendjes nxënës, veçanërisht të shkollave të mesme. Shumica më e madhe e iniciativave dhe aktiviteteve synonin të

zhvillojnë aftësitë për kërkimin dhe përdorimin e informacionit, përmbajtjes mediatike dhe shërbimeve të medias; e ndjekur më pas nga aftësitë për mendim kritik, vlerësim dhe përvetësim të medias dhe informacionit; si dhe zotësia për pjesëmarrje dhe bashkëveprim me të tjerët. Vumë re se ka patur më pak aktivitete dhe iniciativa për zhvillimin e aftësive në krijimin, prodhimin dhe publikimin e përmbajtjes mediatike dhe informacionit.

Në secilin vend, kemi identifikuar, renditur dhe përshkruar me hollësi pesë nga aktivitetet dhe iniciativat më të rëndësishme në fushën e promovimit dhe zhvillimit të edukimit mbi median dhe informacionin, duke përfshirë aktivitetet kryesore, buxhetin, dhe rezultatet (e pritshme).

Table 1: Iniciativat kryesore në promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin (EMI) në pesë shtete të rajonit, sipas vlerësimit të studiuesve

	1	2	3	4	
Shqipëri	Elementë PIM (Procesi i Interpretimit të Mesazheve) në programet mësimore në shkolla	Aktivitete të agjencisë rregullatore - Autoriteti i Mediave Audiovizive – debate publike, punë me universitete	Studime në fushën e EMI-t, debate dhe aktivitete promovimi nga Instituti Shqiptar i Medias	Iniciativa për internet më të sigurtë	Faktoje, faqe interneti për zbulimin e deklaratave të rreme në publik
Bosnjë dhe Hercegovinë	Projekti "Përmirësimi i edukimit mbi median në Republika Srpska", e organizuar nga Ministria e Transportit dhe Komunikimit të RS	Hartimi i një strategjie EMI nga Ministria e Çështjeve Sociale të B-H	Projekt "Forcimi i Besimit ndaj Medias në Vendet e Evropës Juglindore dhe Turqi", nga Instituti për Studime Sociale	Raskrinkavanje, faqe interneti për zbulimin e deklaratave të rreme, dhe analiza kritike të përmbajtjes mediatike	Aktivitete të entit rregullator, Agjencia Rregullatore e Komunikimit, studime, debate, fushata, udhëzime

Maqedoni	Rrjet për edukimin mbi median që mbledh bashkë afro 40 palë të interesuara, nën drejtimin e entit rregullator (Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive)	Makedox – kinema lëvizëse, klube filmi për të rinj në rrethe, film dokumentar, manuale dhe seminare për mësues dhe studentë	Vistinomer, faqe interneti për zbulimin e deklaratave të rreme	Suplementi Medium në gazetën Nova Makedonija, prodhuar nga nxënës të shkollave të mesme; faqe interneti Medium; kamp mediatik, dhe laboratorë media në shkolla	Fushata “Dr. Dragan - ekspert manipulator”, që organizohet nga Instituti Maqedonas i Medias, me fragmente video dhe audio për të mësuar se si të identifikojmë manipulimet në media, propagandën dhe dezinformimin
Mali i Zi	Aktivitete të entit rregullator (Agjencia për Mediat Elektronike), fushata dhe sondazhe	Aktivitete të Bibliotekës Kombëtare në zhvillimin e studimeve, trajnime mësuesish dhe përkthime të literaturës mbi EMI-n	Aktivitete shtesë nga Biblioteka Kombëtare – hartimi i një strategjie EMI, si dhe seminare trajnimi për mësues dhe punonjës bibliotekash	Edukimi mbi Median si lëndë me zgjedhje në sistemin arsimor	Trajnimi i mësuesve për Edukimin mbi median si lëndë me zgjedhje
Serbi	Projekti Fushatë Krijuese: seminare trajnimi për mësues dhe punonjës bibliotekash, kampe verore, festival i organizuar në shkollën e gazetarisë në Novi Sad	Shkolla e edukimit mbi median për nxënës të shkollave të mesme dhe studentë universiteti, e organizuar nga Qendra Margin	Lënda Gjuha, Media dhe Kultura si lëndë me zgjedhje në ciklin e dytë të shkollave nëntë-vjeçare (duke filluar nga viti shkollor 2018 / 2019)	Aktivitete të Ministrisë së Kulturës dhe Informacionit në koordinimin e palëve të interesuara në procesin e hartimit të një plani strategjik, dhe përshtatjen e normave ligjore bazuar në eksperiencat më të mira në fushën e promovimit të EMI-t	Program mbështetës i delegacionit të BE-së për reformën në media, duke përfshirë edhe mbështetje për punën e Ministrisë së Kulturës dhe Informacionit në hartimin e një plan aksioni për promovimin e EMI-t, si dhe nxitjen e radio televizionit publik për prodhimin e programeve për rininë

Shumica e aktiviteteve në nivel rajonal ishin projekte afatshkurtra të financuara nga partnerë ndërkombëtarë, si UNESCO, dhe Komisioni Evropian. Një iniciativë e tillë ishte edhe Koalicioni i Përdoruesve të Medias dhe Informacionit në Evropën Juglindore (CIMUSE), që zgjati për një periudhë trevjeçare, nga viti 2016 deri në 2018. Ky projekt krijoi hapësira për debat publik dhe konsultime mbi strategjitë për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në vendet e rajonit, si dhe i nxiti qytetarët që ta gjykonin median me sy kritik, dhe të bënin ankesa apo denoncime për rastet e shkeljeve nga ana e medias. Projekti u zbatua nga rrjeti rajonal i qendrave dhe instituteve të medias SEENPM. Gjatë viteve të fundit ka patur bashkëpunim në nivel rajonal midis palëve të angazhuara në këtë proces, që kombinojnë njohuritë në fushën e mediave digjitale dhe teknologjisë, me përpjekjet për të përforcuar demokracinë, ndërgjegjshmërinë qytetare dhe pjesëmarrjen në lëvizje shoqërore. Një iniciativë e tillë afatgjatë është edhe konferenca e përvitshme POINT, që u organizua në Sarajevo në 2018, për të shtatën herë.

Pjesa e dytë e studimit rajonal kishte të bënte me punë kërkimore tematike dhe empirike në secilin nga vendet e rajonit, në lidhje me subjekte të ndryshme që duheshin analizuar më në thellësi për të kuptuar më mirë situatën në terren, dhe për të nxitur hartimin e strategjive të punës, dhe veprimeve në terren për të zhvilluar më tej edukimin mbi median dhe informacionin. Në Mal të Zi dhe Serbi, studiuesit u përqendruan mbi sistemin arsimor dhe u morën me qëndrimet e studentëve dhe pedagogëve në lidhjen me përfshirjen e lëndës të Edukimit mbi Median si një lëndë me zgjedhje në shkollat nëntë-vjeçare. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, zhvilluam një studim tematik, duke analizuar përpjekjet e sektorit publik në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Në Maqedoni, fokusi ishte mbi detyrimin ligjor të radio televizionit publik për prodhimin dhe transmetimin e programeve për promovimin e edukimit mbi median, dhe prezantimin e situatës në terren, dhe ky aktivitet u krahasua me punën e kryer nga radio televizionet publike në dy vende evropiane (Britani e Madhe, dhe Belgjikë). Në Shqipëri, u bë një analizë e aktiviteteve të organizmave dhe institucioneve publike në lidhje me promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median.

7. Puna me politikat dhe aktivitete të autoriteteve shtetërore

Në dokumentet zyrtare për politikat shtetërore dhe publike, si dhe në legjislacionet e vendeve të rajonit që u morën në analizë, edukimi mbi median dhe informacionin nuk përmendet qartazi, në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme, si objektivi që duhet arritur. Sidoqoftë, disa aspekte të edukimit mbi median dhe informacionin përmenden në dokumente për hartimin e strategjive, si dhe akteve legjislative që lidhen me median, shoqërinë e informacionit dhe zhvillimin e arsimit. Në Maqedoni dhe në Shqipëri, dokumentet strategjike dhe politikat publike në fushën e arsimit dhe shoqërisë së informacionit e vënë theksin mbi zhvillimin e infrastrukturës digjitale të informacionit, aftësive teknike për futjen e teknologjisë së informacionit në procesin arsimor, si dhe për akses në informacion dhe shërbime të administratës publike dhe sektorit privat. Edhe në Serbi, edukimi mbi median dhe informacionin figuron në strategjitë për informacion publik dhe arsim, ndërsa në ligjin maqedonas të viti 2013 për mediat audiovizive parashikohet detyrimi që ka enti rregullator (Agjencia për Shërbimet Audio dhe Audiovizive në Media) për të promovuar edukimin mbi median, dhe detyra e radio televizionit publik, MRT, që të transmetojë programe që promovojnë edukimin mbi median. Sidoqoftë, objektivat strategjike dhe detyrimet ligjore nuk janë respektuar plotësisht.

Kemi identifikuar, pothuajse në të gjitha vendet e marra në studim, zhvillime pozitive dhe stimuj direktë për autoritetet shtetërore për të hartuar strategji kombëtare për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Aktivitetet e zhvilluara në këtë kuadër kanë mbledhur së bashku autoritete shtetërore dhe institucione publike nga disa sektorë (p.sh., kultura dhe media, shoqëria e informacionit, arsimi), si dhe palë të angazhuara në proces, si organizata të shoqërisë civile, bibliotekat, akademikë, etj. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, zhvillimi i strategjisë u mor përsipër nga Ministria e Çështjeve Sociale, që u frymëzua nga projekti rajonal

“Rritja e Besimit në Media,” dhe puna e vazhdueshme e Institutit për Kërkime Sociale. Në Mal të Zi, biblioteka kombëtare hartoi një strategji për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin, dhe Ministria e Kulturës pritet që të angazhohet së shpejti në këtë proces. Në Serbi, Ministria e Kulturës ka ngritur një grup pune dhe është angazhuar në konsultime mbarëkombëtare për të koordinuar dhe inkurajuar një përjasje strategjike të problemit, dhe ka propozuar përmirësime ligjore, bazuar në eksperiencat më të mira të punës për promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Këto iniciativa dhe aktivitete mund të rezultojnë në miratimin e strategjive kombëtare për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin, si dhe aprovimin e masave ligjore dhe përmirësimin e legjislacionit – por këto përpjekje edhe mund të shterojnë, si pasojë e mungesës së mbështetjes politike dhe përpjekjeve nga organizma shtetërore vendim marrëse. Entuziazmi i disa punonjësve civilë, që nganjëherë mbledhin së bashku përfaqësues të institucioneve publike në aktivitete për promovimin e edukimit mbi median, edhe kur nuk ka fonde të përcaktuara për këtë qëllim - si në rastin e projektit të ngritur me iniciativën e disa punonjësve të Ministrisë të Transportit dhe Komunikimit të Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë - tregon qartë se kemi aritur në një nivel ndërgjegjësimit, se duhet të bëjmë më shumë përpjekje në këtë drejtim, dhe se është e mundur të bëhen përparime në këtë fushë. Sidoqoftë, kërkohet një angazhim sistematik dhe afatgjatë për t'i transformuar këto përpjekje të izoluara individuale në politika shtetërore, të përfshira në ligje dhe institucione.

Studimi ynë vuri në dukje se entet rregullatore të mediave elektronike apo shërbimeve të mediave audiovizive, si agjencitë rregullatore në Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Mal të Zi, dhe pjesërisht edhe në Shqipëri, mund të luajnë një rol të rëndësishëm, jo vetëm në studimin dhe promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin, por edhe në koordinimin e faktorëve të ndryshëm për ndërmarrjen e një veprimi të harmonizuar dhe gjithëpërfshirës në këtë fushë. Kjo vihet re në rastin e entit rregullator në Maqedoni, që merret si shembull, jo vetëm në atë vend por edhe në të gjithë rajonin, se çfarë duhet të bëjë një institucion rregullator për të promovuar edukimin mbi median dhe informacionin, kur ligji e kërkon këtë dhe enti rregullator mund të punojë në këtë fushë në mënyrë të lirë dhe profesionale. Përveç punës për përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe analizimit të situatës në lidhje me edukimin mbi median, agjencia për mediat audio dhe audiovizive në atë vend organizoi dhe koordinoi një grupim me afro 40 palë të interesuara – institucione dhe organizata të angazhuara në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin në Maqedoni.

Rekomandimi i Këshillit të Evropës për pluralizmin në media, që u aprovua nga Komiteti i Ministrave në mars 2018, i inkurajon shtetet që të aprovojnë një politikë të koordinuar për edukimin mbi median, dhe ta bëjnë të zbatueshme nëpërmjet hartimit të planeve të veprimit, ndërkohë që duhet të sigurojnë fonde dhe elemente të tjerë të nevojshëm për këtë proces. Një nga përfaqesat strategjike që i rekomandohet shteteve është krijimi dhe koordinimi i një rrjeti me palët e prekura nga procesi i edukimit mbi median, dhe shkëmbimi i eksperiencave pozitive të punës. Këshilli i Evropës gjithashtu rekomandon që orë mësimi të edukimit mbi median të përfshihen në sistemin arsimor në të gjitha nivelet, si pjesë e iniciativave të mësimi gjatë gjithë jetës, si dhe që të zhvillohen trajnime të rregullta me mësuesit, dhe të krijohen mjetet e duhura mësimore (Këshilli i Evropës 2018).

8. Sistemi arsimor

Sistemi arsimor është identifikuar si një nga elementet më të rëndësishme për një përjasje strategjike drejt një zhvillimi masiv, afatgjatë dhe gjithëpërfshirës të edukimit mbi median dhe informacionin në vendet e rajonit, jo vetëm në dokumentet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare, por edhe nga rekomandimet që dalin nga studimet akademike dhe puna kërkimore e kryer nga organizata të shoqërisë civile në rajon. Kjo përjasje është akoma edhe më e rëndësishme po të kemi parasysh kontributin që jep edukimi mbi median dhe informacionin në përf forcimin e mekanizmave demokratike dhe qytetarisë aktive.

Organizata të shoqërisë civile në disa vende të rajonit e kuptuan që nga fillimi i kësaj dekade (2010 dhe 2011) rëndësinë strategjike dhe potencialin e sistemit arsimor; kështu Instituti Maqedonas i Medias, dhe Instituti Shqiptar i Medias krijuan bashkëpunime të ngushta me autoritetet shtetërore përgjegjëse për sistemin arsimor në Maqedoni dhe Shqipëri, duke i inkurajuar ato që ta fusnin edukimin mbi median si lëndë në shkolla, apo përfshirjen e elementeve për edukimin mbi median në tekste shkollore. Ky proces përfshiu zhvillimin e programeve mësimore, organizimin e trajnimeve për mësues (në Maqedoni u trajnuam rreth 1,000 mësues), dhe përgatitjen e teksteve shkollore. Sidoqoftë, që të dyja këto iniciativa nuk patën sukses si pasojë e ndryshimeve të shpeshta në strukturat e administratës, dhe mbështetjes politike të paqëndrueshme të institucioneve shtetërore për këto përpjekje.

Sot, gati 10 vjet më pas, edukimi mbi median nuk figuron si lëndë më vete në shkollat e këtyre dy vendeve, ndërsa vetëm disa aspekte të veçanta të edukimit mbi median dhe informacionin janë shpërndarë nëpër lëndë të ndryshme (si Gjuhë-letërsi, dhe Qytetari). Ndërkohë, lëndë që fokusohen mbi aftësitë teknike të përdorimit të teknologjisë së informacionit janë bërë pjesë e sistemit arsimor, por shkollat kanë mangësi teknike, dhe

mësuesit nuk janë trajnuar aq sa duhet për ta kryer me sukses rolin e tyre, dhe e gjitha kjo i pengon shkollat që të luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e edukimit digjital për nxënësit e tyre.

Nga ana tjetër, në Malin e Zi lënda e edukimit mbi median u fut si lëndë njëvjeçare me zgjedhje për klasën e pestë ose të gjashtë në vitin 2008. Kjo erdhi si rezultat i bashkëpunimit midis shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore në kuadër të reformës të sistemit arsimor që po kryhej në atë kohë, dhe si pjesë e përpjekjeve për të decentralizuar dhe përmirësuar sistemin arsimor. Sidoqoftë, deri më sot Mali i Zi është i vetmi vend në rajon që ka një lëndë të veçantë për edukimin mbi median, megjithëse problemet dhe kufizimet e veta. Një përjashtim tjetër për rajonin është edhe Sllovenia, ku për më shumë se dy dekada tashmë nxënësit e tre klasave më të larta të shkollës fillore kanë mundësi të ndjekin Edukimin në Media si lëndë me zgjedhje.

Një hap përpara drejt integritit të lëndës të edukimit mbi median në sistemin arsimor është hedhur në Serbi, ku lënda me zgjedhje e Gjuhës, Medias dhe Kulturës u fut në shkollat e ciklit të dytë të arsimit nëntëvjeçar për vitin shkollor 2018/2019.

Studimi empirik që u zhvillua në Serbi dhe Mal të Zi, si pjesë e projektit tonë, nëpërmjet intervistave, grupeve të diskutimit, dhe anketave me nxënës dhe mësues treguan se nuk mjafton thjesht përfshirja formale e kësaj lënde në shkolla. Pa përgatitjen e duhur në institucionet shkollore, pa trajnim të mirë dhe të vazhdueshëm të mësuesve, pa tekste të mira shkollore, pa akses në pajisje dhe mjete mësimore, nuk mund të arrihet dot realizimi me sukses i kësaj lënde. Në Mal të Zi, numri i nxënësve që ndjekin orën e Edukimit mbi Median si lëndë me zgjedhje është përgjysmuar gjatë një periudhë dhjetëvjeçare. Nga 20 shkolla të ciklit të dytë të nëntëvjeçares në atë vend, deri më tani 11 prej tyre e kanë futur këtë lëndë në programet mësimore, por gjatë vitit shkollor 2016/2017 kjo lëndë jepej vetëm në gjashtë shkolla, me 164 nxënës që e zgjedhën këtë lëndë, ndërsa në vitin 2017/2018 lënda jepej vetëm në katër shkolla, me 60 nxënës nëpër klasa. Kjo erdhi si pasojë e mungesës së vazhdimësisë, dhe dështimit për të përfitur nga fillimi i mbarë i punës, problemeve me përzgjedhjen edhe trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve, mangësive me mbështetjen teknike dhe pajisje, dhe dështimit në hartimin e teksteve shkollore për të zëvendësuar materialet mësimore provizore të përdorura në fillim të procesit. Mbase duheshin përfshirë edhe profesionistë të medias në mësimdhënie. Po kështu, është bërë shumë pak për të promovuar vetë lëndën nëpër shkolla dhe tek publiku, pasi as institucionet shtetërore dhe as media nuk kanë treguar ndonjë interes në këtë drejtim.

Në Serbi, studimi ynë tregoi se vetë mësuesit ishin të shqetësuar në lidhje me informacionin e mangët dhe përgatitjet e dobëta për të futur në shkolla lëndën e Gjuhës, Medias dhe Kulturës si lëndë e re me zgjedhje. Po kështu, ata theksuan se shpesh janë vetë mësuesit që bëhen pengesë për suksesin e reformave në shkolla, pasi janë të painformuar dhe të painteresuar. Sidoqoftë, mësuesit mendonin se kishte nevojë për më shumë materiale dhe metoda mësimore për të përmirësuar edukimin mbi median dhe informacionin, si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit, për ta bërë procesin mësimor më funksional dhe për të mbushur hendekun e komunikimit midis mësuesve dhe nxënësve.

Nxënësit dhe studentët që morën pjesë në studimin tonë prisnin një komunikim më të mirë me mësuesit dhe shkollën e tyre, përdorim më të gjerë të teknologjive digjitale, çiltërsi në komunikim, dhe mundësinë për të analizuar me ta në mënyrë kritike informacionin dhe përmbajtjen mediatike.

Institucione dhe organizata të ndryshme në vendet e rajonit ka disa vite tashmë që organizojnë seminare dhe takime pune për të trajnuar mësues që të japin mësim mbi elemente të edukimit mbi median dhe informacionin. Këto janë më së shumti organizata të shoqërisë civile që i zhvillojnë me entuziazëm këto aktivitete, në kuadër të projekteve sporadike afatshkurtra që financohen nga donatorë të huaj. Gjatë punës tonë kërkimore, mësuesit në Mal të Zi dhe Serbi i lavdëruan këto seminare dhe konfirmuan faktin se mësuesit tregonin më shumë interes për trajnim kur e kuptonin se seminarët ishin të cilësisë së lartë. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë përpjekje sistematike afatgjatë për këtë lloj trajnimit, dhe madje nuk ka as ndonjë monitorim cilësie. Në Mal të Zi, organizmi shtetëror Instituti i Arsimit filloi akreditimin e seminareve të ndryshme të trajnimit për mësuesit, në lidhje me edukimin mbi median, vetëm në vitin 2015, dhe më pas shtoi disa prej tyre në katalogun zyrtar të programeve të zhvillimit profesional për mësuesit. Dhjetë vjet pas futjes së lëndës të Edukimit mbi median në shkollat nëntëvjeçare, kjo lëndë u fut edhe në universitet, për vitin akademik 2018/2019, për studentët e gazetarisë dhe studimeve të medias në Fakultetin e Shkencave Politike në Podgoricë. Në këtë mënyrë i kalohet gazetarëve të ardhshëm një përqsaje sistematike në lidhje me zhvillimin e edukimit mbi median. Të njëjtin hap përpara hodhën edhe universitetet në Sarajevën Lindore dhe në Banja Luka, në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku lënda e Edukimit mbi Median u fut në departamentet e gazetarisë duke filluar që nga viti akademik 2016/2017. Studimet e kryera për luftën kundër dezinformimit identifikojnë gazetarët, përveç mësuesve, si persona që duhet të përmirësojnë nivelin e tyre të ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin,

dhe që më pas kanë mundësitë, me këtë bagazh të ri njohurish, që të kontribuojnë për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e njohurive të një numri të madh qytetarësh, duke shumëfishuar efektin e njohjes nga ana e tyre e medias dhe informacionit (Komisioni Evropian 2018, 25).

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, elementet e edukimit mbi median dhe informacionin janë përfshirë vetëm pjesërisht në studimin e lëndëve të ndryshme në të dy ciklet e shkollave nëntëvjeçare. Ashtu si edhe në vendet e tjera më këtë lloj përjasje, aspekte të edukimit mbi median që duhet të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik, zotërimit të kuptimit dhe analizimit, si dhe prodhimit të përmbajtjes mediatike janë lënë pas dore nga sistemi arsimor. Iniciativat që duan të arrijnë një integrim sistematik të edukimit mbi median dhe informacionin në programet mësimore dhe sistemit arsimor në Bosnjë dhe Hercegovinë, kanë hasur në pengesa të mëdha, duke u përballur me një sistem administrativ kompleks ku kompetencat ndahen midis 14 ministrive të ndryshme, si dhe me mungesë fondesh dhe interesi nga ana e vendim-marrësve. Sidoqoftë, entuziazmi i individëve, ashtu si edhe në segmente të tjera të promovimit të edukimit mbi median dhe informacionin, sjell aty-këtu përparime të vogla në sistemin arsimor, si futja e lëndës të Edukimit mbi Median në Fakultetin e Filozofisë në Tuzla.

Është akoma e paqartë përse, edhe kur në disa vende të rajonit kapërcehen pengesat dhe arrihet një marrëveshje për të futur në shkolla lëndë që zhvillojnë edukimin mbi median dhe informacionin, kjo mbetet në nivelin e lëndës me zgjedhje, dhe nuk shkon më lart se shkolla nëntëvjeçare. Një lëndë që më në fund pranohet si pjesë integrale e programit mësimor – dhe që të gjitha studimet dhe dokumentet strategjike të organizatave vendase dhe ndërkombëtare e shohin si parakusht për pjesëmarrje aktive në proceset shoqërore dhe demokratike – lihet në dëshirën e studentëve dhe konkurren me lëndët e tjera me zgjedhje, dhe për më tepër kufizohet vetëm në shkolla që ndiqen nga nxënës që kanë ambicie të vazhdojnë studimet në universitet. Në shumicën e vendeve të rajonit, rezultatet e nxënësve në testet e aftësive funksionale të leximit (testet PISA – Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Studentëve) nuk janë fare inkurajuese, dhe kjo përmendet si një nga pengesat për futjen më të gjerë të subjektit të edukimit mbi median në të gjitha nivelet e arsimit, dhe në të gjitha llojet e shkollave. Nga ana tjetër, një nga metodologjitë për matjen e nivelit të edukimit mbi median, i shikon rezultatet e dobëta në testin PISA, si dhe treguesit e dobët mbi lirinë e medias në rajon, si prova të një niveli të ulët të edukimit mbi median, në nivelet më të ulëta në Evropë (Lessenski 2018).

9. Shoqëria Civile

Organizatave të shoqërisë civile janë në pararojë kur vjen fjala tek promovimi dhe zhvillimi i edukimit mbi median dhe informacionin në vendet e rajonit. Këto organizata kanë qenë aktive në përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe aftësive të qytetarëve, veçanërisht të rinjve, për të analizuar median në mënyrë kritike, dhe për t'i përfshirë ata në funksionimin e medias dhe platformave digjitale, madje edhe kur koncepti i edukimit mbi median dhe informacionin nuk ishte kaq i përpunuar sa në ditët e sotme. Ato ishin të parat që promovuan këtë koncept në vendet e tyre respektive, dhe bashkëpunuan me ekspertë të huaj dhe organizata ndërkombëtare, me qëllim që të thithnin sa më shumë njohuri dhe të nxisnin institucionet dhe organizmat shtetërore për të bërë përpertime në nivel sistemi për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Këto përpjekje direkte kanë zgjatur tashmë për më shumë se dhjetë vjet. Në shumicën e rasteve, ato ia kanë arritur me sukses që të trajnojnë dhe të edukojnë në mënyrë informale një numër të madh të rinjsh dhe trajnerët e tyre (duke organizuar seminare dhe takime në nivel lokal), si dhe të organizojnë aktivitete profesionale, fushata ndërgjegjësimi, analiza kritike, studime dhe publikime.

Lista e organizatave të shoqërisë civile në rajon dhe aktivitetet e zhvilluara prej tyre për edukimin mbi median dhe informacionin është shumë e gjatë, ashtu si doli edhe nga puna jonë kërkimore me palët e angazhuara në proces dhe iniciativat e marra prej tyre. Nga ana tjetër, ky numër i madh aktivitetesh dhe organizatash nuk ka sjellë përpertime të mëdha në këtë fushë: organizatat duket se janë të shpërndara, aktivitetet e tyre zgjatin pak; dhe janë kryesisht të varura nga donacione të huaja. Donatorët më të rregullt janë Bashkimi Evropian, dhe fonde të qeverisë amerikane, si USAID, dhe NED. Megjithatë aktiviteti i tyre varet nga fondet për projekte, disa organizata të shoqërisë civile kanë arritur që të sigurojnë vazhdimësi në kontributin e tyre rreth edukimit mbi median. Nëpërmjet politikave të tyre dhe mekanizmave për lëshimin e fondeve, si dhe prioriteteve të momentit mbi tema të caktuara, donatorët ndërkombëtarë

ndikojnë shumë në funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile në rajon, duke përfshirë edhe këtë fushë. Përveç ndërgjegjësimit dhe ideve të vetë shoqërisë civile, edhe axhenda e donatorëve të huaj ka ndikuar mbi përpjekjet e shoqërisë civile për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin, duke i bërë ato më dinamike, më të shumta dhe dominante.

Sektori i shoqërisë civile në vendet e rajonit mundohet të kompensojë për pasivitetin e organizmave shtetërore, ngadalësinë në përmirësimin e sistemit, dhe masave të marra për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Organizatat e shoqërisë civile lidhen me institucione akademike dhe studimore, dhe kontribuojnë me analiza të rëndësishme dhe rekomandime. Në sektorin e shoqërisë civile është akumuluar një sasi e madhe njohurish dhe eksperience, duke përfshirë edhe fushën e arsimit informal, dhe gjithë kjo njohuri duhet vënë në përdorim përkrah aktiviteteve të sektorit publik. Organizmat ndërkombëtare, veçanërisht Bashkimi Evropian, ka më shumë të ngjarë të nxitin sektorin publik që të veprojë, duke hartuar strategji kombëtare dhe përmirësime të sistemit, por edhe bashkëpunimi i shoqërisë civile në këto procese është absolutisht i nevojshëm.

Problemet e shpërndarjes së dezinformimit, manipulimeve dhe propagandës, që tentojnë të minojnë mekanizmat dhe potencialet demokratike që burojnë nga komunikimi publik dhe aksioni qytetar, dhe që duan të nxitin polarizimin dhe radikalizimin në shoqëri, kanë ndikuar në shtimin e përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile në rajon për të ekspozuar këto praktika, përmbajtje dhe platforma. Pothuajse në të gjitha vendet e rajonit ku u shtri studimi ynë, janë krijuar faqe interneti dhe ekipe që punojnë në mënyrë aktive për të zbuluar dezinformimin, vërtetojnë fakte, dhe publikojnë analiza për të rritur nivelin e përgjegjësimit dhe për të përmirësuar edukimin e qytetarëve mbi median dhe informacionin. Në Shqipëri kemi faqen **Faktoje**, në Maqedoni **Vistinomer**, në Serbi **Istinomer** dhe **Tragač**, në Bosnjë dhe Hercegovinë **Raskrinkavanje**. Organizata të shoqërisë civile, si Instituti Maqedonas i Medias, dhe fondacioni serb Share përdorin pamje filmike dhe dokumentare në fushatat e tyre në internet dhe televizion, duke u munduar që të mësojnë sa më shumë qytetarë se si të dallojnë dhe të luftojnë dezinformimin dhe manipulimet në media dhe platformat digjitale të informacionit dhe komunikimit.

Praktika të mira pune mund të vërehen edhe në aktivitete që kanë mbledhur së bashku organizata të shoqërisë civile, institucione shtetërore dhe organizata ndërkombëtare me qëllim mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Megjithë shumëllojshmërinë e aktiviteteve të shoqërisë civile për promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median

dhe informacionin, ky sektor përballet me një sërë problemesh kur vjen puna tek vazhdimësia, përqendrimi, dhe cilësia e aktiviteteve, si dhe koordinimi i dobët midis organizatave për të evituar duplikimin e aktiviteteve. Mungon informacioni dhe analiza se në cilën fushë duhen përpjekje më të mëdha, dhe se sa efikase kanë qenë aktivitetet e zhvilluara deri më tani. Po kështu, nuk ka njohuri dhe eksperiencë të mjaftueshme për të organizuar aktivitete dhe lëvizje avokimi të koordinuara mirë për të ndikuar mbi strukturat vendim-marrëse në institucione dhe organizma shtetërore. Një projekt avokimi nga organizata të shoqërisë civile për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin mund të ushtrojë presion mbi organizmat shtetërore që të ndryshohen procedurat jo-transparente dhe të korruptuara për financimin e medias me fonde publike, dhe krijimin e mekanizmave shtetërore transparente për të mbështetur pluralizmin në media, duke përfshirë këtu edhe financime të rregullta të projekteve të shoqërisë civile për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin.

10. Media, filmi dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK)

Mediat nuk janë edhe aq aktive në promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin në vendet e rajonit. Edhe kur tregohet njëfarë interesi nga ky sektor, kjo vjen kryesisht nga shoqata mediatike dhe organizma vetë-rregulluese të medias. Këshilli i Shtypit në Bosnjë dhe Hercegovinë (që mbulon si shtypin e shkruar ashtu dhe mediat online) ka vite që është bërë shembull i një eksperience pozitive në angazhimin e qytetarëve për raportimin e ankesave në lidhje me median, dhe në të njëjtën kohë rrit ndërgjegjësimin mbi standardet etike në media dhe të drejtat e qytetarëve, me promovimin e mekanizmave vetë-rregulluese, përgatitjen e emisioneve në radio mbi këto tema, me aktivitete, si dhe duke treguar transparencë në punën e vet. Një veprimtari e tillë emancipuese kryhet edhe nga Këshilli i Shtypit në Serbi, dhe Këshilli për Etikën në Media në Maqedoni. Këto përpjekje pozitive të strukturave vetë-rregulluese konsistojnë në shpjegimin e qytetarëve mbi mënyrën se si funksionon media, dhe cilat aspekte të punës së tyre janë të dyshimta nga ana etike, por nga ana tjetër i shpjegojnë medias edhe sa e vlerësojnë qytetarët punën e tyre, dhe për cilat aspekte kanë vërejtje. Ky dialog i vazhdueshëm, me shpjegime dhe diskutime, është një element i rëndësishëm në mes të morisë së aktiviteteve dhe faktorëve që angazhohen në procesin e edukimit mbi median për qytetarët, por edhe për vetë pjesëtarët e komunitetit të medias.

Disa nga eksperiencat pozitive me industrinë e medias në rajon përfshijnë aktivitete të Koalicionit të Medias dhe Shoqatës së Medias në Serbi, si fushata dhe projekte edukative, që kishin si synim të promovonin një njohje më të mirë të medias dhe zhvillimin e aftësive mediatike të qytetarëve, veçanërisht me nxënësit e shkollave fillore.

Edhe në Maqedoni, ka shembuj të shkëlqyer të bashkëpunimit afatgjatë midis organizatave të shoqërisë civile, institucioneve kërkimore, dhe medias. Shkolla e gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun është bërë një faktor i

rëndësishëm në arsimimin jo zyrtar, dhe shërben si qendra e organizimit të rrjetit të aktivistëve dhe punës në terren. Kështu për shembull, që nga viti 2014 kjo shkollë organizon Ditën e Medias, ku nxënës të shkollave nëntëvjeçare vizitojnë organe të medias dhe shohin me sytë e tyre si prodhohen lajmet. Në bashkëpunim me Shkollën e gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun, gazeta e përditshme **Nova Makedonija** boton, që nga viti 2011, suplementin **Medium** me artikuj që shkruhen nga nxënës të ciklit të dytë të shkollave nëntëvjeçare.

Nga ana tjetër, radio televizionet publike në vendet e rajonit nuk bëjnë gati asgjë për promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin, megjithëse puna për edukimin dhe fuqizimin e qytetarëve duhet të jetë pjesë përbërëse e misionit të tyre. Që nga viti 2013, radio televizioni publik maqedonas, MRT, është i detyruar me ligj që të prodhojë dhe transmetojë programe të kësaj natyre, por përparimet në këtë drejtim janë shumë të ngadalta, dhe këto programe speciale po futen në trasmetim vetëm në mënyrë graduale, në bashkëpunim me shoqërinë civile. Në Shqipëri, radio televizioni publik, RTSH, transmeton një program një herë në javë në mëngjes, ku një pedagog i studimeve mbi median flet për teknologjinë e medias dhe informacionit, duke kontribuar në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin për qytetarët.

Në sektorin e filmit, mund të veçojmë vetëm aktivitetet e realizuara nga MakeDox në Maqedoni, ku që nga viti 2010 një kinema lëvizëse projektton dokumentarë në zonat rurale. Kjo organizatë punon edhe me sektorin e arsimit, duke përgatitur kurikulume, manuale dhe trajnime për mësues të ciklit të dytë të shkollave nëntëvjeçare, për të futur në shkolla elemente të prodhimit dhe analizimit të filmave dokumentarë. Një nga aktivitetet e tyre kryesore është edhe Festivali i Filmave Dokumentarë Krijues, MakeDox. Në vitet 2013 dhe 2015, në bashkëpunim me organizata të ngjashme nga vende të tjera, kanë organizuar një shkollë rajonale të filmave dokumentarë me të rinj nga rajoni.

Kompanitë e teknologjisë të informacionit dhe komunikimit në vendet e rajonit kanë organizuar për shumë vite tashmë seminare dhe takime për t'i mësuar nxënësve programimin dhe aftësi të tjera. Në këtë aspekt këto kompani kanë gjithashtu një interes komercial pasi promovojnë produktet dhe teknologjitë e tyre. Nga ana tjetër, një shembull pozitiv vjen nga Mostari, ku në vitin 2018 një kompani lokale telekomunikacioni, HT Mostar, nënshkroi një kontratë afatgjatë me Universitetin e Mostarit, ku merrte përsipër që të pajiste me teknologji të reja të nevojshme për studime universitare, të bashkëpunonte me projekte kërkimore, dhe të krijonte mundësi për vizita studimore dhe bursa studimi.

11. Studime rreth edukimit mbi median dhe informacionin

Shumë projekte kërkimore dhe studimore në vendet e rajonit kanë si objekt studimi edukimin mbi median dhe informacionin. Disa nga këto studime janë gjithëpërfshirëse, pasi marrin në konsideratë dhe analizojnë të gjitha elementet përkatëse të edukimit mbi median dhe informacionin në një vend të caktuar, dhe më pas japin rekomandime për politikat publike. Studime të tjera merren me futjen e lëndëve dhe temave të veçanta në shkolla, apo merren me analizimin e treguesve të nivelit të edukimit mbi median tek fëmijët, prindërit, apo qytetarët në përgjithësi. Këto projekte kërkimore zhvillohen nga studiues të organizatave të shoqërisë civile dhe universiteteve. Studime janë kryer gjithashtu edhe nga entet rregullatore të mediave elektronike (si për shembull, në Maqedoni dhe Mal të Zi). Në nivel rajonal, rrjeti i instituteve dhe qendrave të medias në Evropën juglindore, SEENPM, ka zhvilluar një numër studimesh dhe punësh kërkimore mbi çështje të edukimit mbi median (Londo dhe të tjerë, 2017). Kjo çështje është trajtuar edhe në tema diplomash, tema master dhe doktorature nga studentë në vendet e rajonit. Nganjëherë ka mbivendosje dhe duplikime aktiviteteve apo studimesh, si dhe përsëritje përfundimesh dhe konkluzioneve. Studimet dhe aktivitetet shpesh varen nga projektet e donatorëve të huaj dhe nga donacionet e tyre, dhe për pasojë edhe fokusi i studimeve përzgjidhet nën këtë ndikim.

Një element i përbashkët nga raportet e thuajse të gjitha studimeve është rekomandimi që të gjitha vendet e rajonit duhet t'i japin prioritet hartimit të strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin.

Megjithë numrin e madh të studimeve dhe analizave, nuk ka akoma një përkufizim plotësisht të harmonizuar të konceptit të edukimit mbi median dhe informacionin – një problem ky që haset edhe nga studiues në vende të tjera

jashtë rajonit tonë. Kemi nevojë të zhvillojmë një analizë të detajuar të programeve studimore në secilin nga vendet e rajonit; që të përcaktohen fushat që nuk janë studiuar aq sa duhet; të krijohen kushtet e duhura për studime serioze të detajuara mbi subjekte të caktuara për një kohë relativisht të gjatë (studime gjatësore); të sigurohen fonde të përhershme në buxhetet e enteve rregullatore dhe agjencive kombëtare të kërkim-studimit; si dhe fonde speciale për projekte mbi pluralizmin në media, për të siguruar studime të vazhdueshme dhe pjesëmarrjen e studiuesve në tryeza ndërkombëtare diskutimi në nivele akademike dhe profesionale. Edhe Komisioni Evropian mund të kontribuojë në këtë drejtim duke përfshirë studiues dhe ekspertë nga vendet e rajonit në takime tematike dhe strategjike, si dhe në komisione ekspertësh e studiuesish në fushën e edukimit mbi median dhe informacionin.

12. Përfundime

Kur flasim për krizën e medias apo krizën e gazetarisë në ditët e sotme duhet të përmendim para të gjithash humbjen e besimit ndaj punës së medias nga ana e qytetarëve. Kriza nuk doli sot për nesër, si ndonjë lloj fatkeqësie natyrore që nuk mund të parashikohej, madje ajo ka qenë pjesë e sistemit të medias nga fillimet e saj. Sa më shumë që media shkëputej dhe distancohej nga audiencat e saj, aq më shumë ajo afrohej me pushtetin politik dhe ekonomik, dhe po kaq shumë puna e tyre humbiste integritet dhe besueshmëri. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me politikën. Shpronësimi politik dhe nënshtrimi mendor janë tipare themelore të ditëve tona, thotë Mastnak. Depolitizimi i qytetarëve nuk është fundi i politikës, por është disfata e tyre politike. Kjo është fitore e politikës pa popullin dhe kundër popullit. Demokracia si proces i përfaqësimit politik të qytetarëve është kthyer në një farsë që luhet nga qytetarët pa u përfaqësuar nga kurrkush (Mastnak 2015, 148-149). Media luan një rol të rëndësishëm në këtë lojë.

Për të kuptuar se me çfarë lloj sistemi mediatik kemi të bëjmë, duhet të mendojmë seriozisht në lidhje me këtë. Duhet të mësojmë si të analizojmë në mënyrë kritike, jo vetëm përmbajtjen mediatike që na serviret, por duhet të mendojmë edhe për alternativa ndaj një sistemi mediatik që shkakton ato pasoja që përmend Mastnak. Vala e dezinformimit; mohimi i fakteve dhe shkencës; gjuha e urrejtjes; shitja e privatësisë; eliminimi i debatit publik serioz mbi të kaluarën, të tashmen apo të ardhmen; populizmi që servir zgjidhje të momentit për probleme komplekse; mungesa e besimit në institucionet politike; të gjitha këto janë rezultate të shkatërrimit të demokracisë, një proces që është zhvilluar gjatë një periudhe të gjatë kohe. Për vitin 2018 revista *Time* emëroi si njeriun e vitit profesionin e gazetarit, dhe i quajti ata "mbrojtës të demokracisë" – të gjithë ata gazetarë, burra dhe gra, të cilët nëpërmjet punës së tyre pa kompromis kanë kontribuar në shërbim të interesit publik. Njëri prej tyre, Jamal Khashoggi nga Arabia Saudite, u vra në një mënyrë të atillë sa që trupi i tij mbase nuk do të

gjendet kurrë. Dy gazetarë të agjencisë Reuters, Wa Lone dhe Kyaw Soe Oo, që raportuan mbi gjenocidin kundër popullatës Rohingya po vuajnë dënime me burgim të gjatë. Personeli i gazetës amerikane Capital Gazette u sulmua për vdekje nga një person që nuk binte dakord me raportimin e tyre. Gazetarja fituese e disa çmimeve Maria Ressa, që ngre zërin kundër vrasjeve të paligjshme në Filipine, po përballet me presione të vazhdueshme nga autoritetet që e akuzojnë për mospagim taksash. Mbrojtësit nuk ka se kush t'i mbrojë. Sot më shumë se kurrë, kemi nevojë për gazetari që punon në interes të publikut, dhe gazetarë që e vlerësojnë integritetin e tyre dhe interesin e publikut mbi interesat personale dhe interesat e grupeve të veçanta. Po kështu, kemi nevojë për një publik me mendim kritik që të mbështesë punën e tyre dhe të bëhen ata mbrojtës të mediave që punojnë në interes të publikut. Qytetarët që mendojnë në mënyrë kritike janë mbrojtësit më të fortë të demokracisë.

Edukimi mbi median dhe informacionin nuk është një shkop magjik që do të zgjidhë të gjitha problemet e akumuluar në fushën e medias. Sidoqoftë, ky mund të jetë hapi i parë në rrugëtimin e gjatë për transformimin e sistemit, dhe për ta bërë përmbushjen e nevojave të qytetarëve për informacion dhe komunikim një prioritet të politikave aktive shtetërore në shërbim të interesit publik. Përcaktimi i prioritetëve, krijimi i aleancave të gjera për reformimin e sistemit mediatik (në nivel kombëtar dhe suprakombëtar), dhe mbrojtja aktive e të drejtës për të marrë informacion të besueshëm, krijojnë një bazë të shëndoshë politike për këto ndryshime. Një studim i mëparshëm mbi integritetin e medias evidentoi nevojën e marrjes të këtyre hapave, që janë prezantuar qartazi dhe në këtë studim mbi zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në pesë vendet e rajonit, si dhe në rekomandimet e studiuesve tanë.

Megjithë numrin e madh të aktiviteteve dhe palëve të angazhuara me promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në vendet e rajonit, dhe megjithëse janë hedhur disa hapa përpara nga organizma shtetërore drejt hartimit të strategjive kombëtare për edukimin mbi median dhe informacionin në disa vende të rajonit, këto mbeten vetëm disa hapa sporadike që nuk dihet nëse do të sjellin ndonjë rezultat. Të gjitha hapat e hedhura deri më sot – qofshin ato të suksesshme apo jo – drejt miratimit të një strategjie dhe ndërgjegjësimit se sa e rëndësishme është të hartohet kjo strategji, tregojnë qartë se duhet koordinim dhe bashkim forcash midis autoriteteve shtetërore të arsimit, medias, dhe shoqërisë së informacionit. Po kështu është e domosdoshme edhe përfshirja në këtë proces e të gjitha palëve të interesuara, sidomos shoqatave të shoqërisë civile dhe mediave publike në hartimin e politikave publike dhe zhvillimin e aktiviteteve të koordinuara midis palëve.

Përpyekjet e bëra nga entet rregullatore të mediave elektronike tregojnë se këto organizma shtetërore kanë potencialin që të luajnë një rol kyç në promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin, nëse u caktohet kjo detyrë, dhe u jepet mundësia që ta kryejnë këtë mision në mënyrë serioze dhe profesionale.

Sipas rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare, entet rregullatore të pavarura mund të luajnë fare mirë rolin e koordinatorëve të rrjeteve dhe koalicioneve të palëve të interesuara në promovimin dhe zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin. Ka shumë të dhëna dhe prova që tregojnë sa rol të rëndësishëm luajnë aktivitetet e koordinura midis palëve, veçanërisht kur projekte strategjike dhe aktivitete të përbashkëta ndërmerren në bashkëpunim me organizma shtetërore, shoqërinë civile, por edhe me përfshirjen e faktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe median. Media dhe gazetarët duhet të nxiten që të marrin një rol më aktiv në promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin, veçanërisht mediat publike, mediat jo komerciale, si dhe shoqatat e gazetarëve. Mungesa e pjesëmarrjes së mediave dhe gazetarëve në rajon në procesin e hartimit të masave strategjike dhe aktiviteteve për përmirësimin e edukimit të qytetarëve mbi median dhe informacionin është një dështim serioz nga ana e tyre. Fokusi i ngushtë i vëmendjes dhe energjive të mediave në orvatjet për të siguruar mbijetesën e tyre, dhe përpjekjet për të neutralizuar sulmet kundër mbijetesës dhe dinjitetit të tyre, janë të kuptueshme, por mospjesëmarrja e tyre në proceset e përmirësimit të edukimit të qytetarëve mbi median tregon se ato po humbasin një moment historik, dhe nuk po e kuptojnë dot mundësinë që u jepet për t'u afruar edhe njëherë me qytetarët, dhe për të investuar në fuqizimin e tyre si qytetarë aktivë, mbrojtës të demokracisë.

Mediave publike, si pjesë e komunitetit mediatik, duhet t'u kërkohet me ligj që të luajnë një rol më të rëndësishëm në promovimin e edukimit mbi median dhe informacionin për qytetarët. Ato mund ta kryejnë këtë rol nëpërmjet transmetimit të programeve, por mund ta afrojnë publikun edhe nëpërmjet organizimit të vizitave dhe hapjes të ambienteve e tyre për publikun; për kurse praktike për nxënës dhe studentë; për marrjen e ankesave dhe për diskutime publike; për transparencë në punën e tyre dhe për t'i treguar qytetarëve se këto media i japin llogari publikut; si dhe për bashkëpunim me shkollat.

Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme që të krijohen mekanizma për arsimimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të gazetarëve dhe gjithë personelit të medias për të përmirësuar edukimin e vetë atyre mbi median dhe informacionin, duke patur parasysh sfidat që dalin si rezultat i teknologjive të reja dhe strukturave

komplekse për shpërndarjen e organizuar të dezinformimit, që kërcënojnë mbijetesën dhe rolin kritik të medias dhe gazetarëve.

Sistemi arsimor i çdo vendi është një strukturë komplekse që reagon ngadalë ndaj reformave, por ka të gjithë potencialin e nevojshëm për fuqizimin dhe emancipimin masiv të qytetarëve, nëse lënda e edukimit mbi median dhe informacionin futet në shkolla dhe zbatohet si duhet. Mësuesit janë hallka më e rëndësishme në këtë proces, pasi në fund të fundit janë ata që duhet të bëjnë shumicën e punës me nxënësit e tyre për edukimin mbi median. Për këtë arsye, mësuesit duhet të përfshihen në hartimet e planeve strategjike të reformave, dhe po për këtë arsye duhen investime serioze për trajnime zyrtare dhe jo-zyrtare të mësuesve, ndërsa cilësia e këtyre trajnimeve duhet të jetë e lartë.

Jetojmë në kohëra ku pabarazia politike dhe ekonomike ka marrë përmasa kaq të mëdha, saqë 26 individë të pasur (duke përfshirë edhe pronarët e platformave më të rëndësishme të komunikimit që i japin tonin botës sonë të komunikimit) kanë po aq fuqi financiare sa katër miliardë qytetarët më të varfër të botës, të marrë së bashku (Oxfam 2019). Vaidhyathan e konsideron botën tonë të komunikimit si një botë monopoli, privilegji, varësie dhe manipulimesh: "Amazon Echo, Google Home dhe Oculus Rift janë për momentin produkte luksi për më të pasurit. Por modeli i të ardhmes duket qartë: sistemi operativ i jetës sonë do të drejtojë trupat tanë, vetëdijen tonë, dhe vendimet tona. Ndërgjegjja do të jetë vetëm një opsion. Pushteti do të jetë i përqëndruar në më pak duar dhe manipulimi do të jetë konstant. Do të jetë një botë që nuk toleron autonominë, dhe nuk lejon hapësira për demokracinë. Do të jetë një botë përtace, një botë narkotike." (Vaidhyathan 2018,105)

E gjithë bashkësia e prodhuesve të informacionit, producentëve të mediave komerciale dhe jo-komerciale, mediave digjitale, dhe specialistëve të teknologjisë duhet të bëhen aleatë në hartimin e politikave dhe praktikave për zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin, si dhe për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit dhe aftësive të qytetarëve. Përgjegjshmëria dhe përpjekjet e tyre në këtë fushë kanë rëndësinë madhore. Të mëdhaja apo të vogla, të gjitha idetë dhe veprimet kanë rëndësinë e tyre; ne kemi nevojë si për përpjekjet e faktorëve globalë, ashtu edhe për punën e aktivistëve lokalë, si dhe organizatave apo individëve që e kuptojnë botën digjitale, dhe mund të kontribuojnë duke e përdorur teknologjinë për progres dhe për të ndihmuar në emancipimin e qytetarëve, dhe jo për shkatërrimin e dijes, arritjeve në kulturë dhe demokraci.

Referencat

Briggs, Asa, dhe Peter Burke. *Një Histori Sociale e Medias – Nga Gutenbergu deri tek Interneti (A Social History of the Media - from Gutenberg to The Internet)*. Cambridge: Polity Press, 2009.

Brown, Wendy. *Shkrrirja e Popullit. Revolucioni Tinzar Neoliberal (Undoing the Demos. Neoliberalism's Stealth Revolution)*. New York: Zone Books, 2015.

Brynjolfsson, Erik, dhe Andrew McAfee. *Epoka e Dytë e Makinës. Punë, Progres dhe Mirëqënie në Kohën e Teknologjive Gjeniale (The Second Machine Age. Work, Progress and Prosperity in a Time of Brilliant Technologies)*. New York: W.W. Norton and Company, 2016.

Buckingham, David. *Edukimi Mediatik. Edukimi mbi Median, Nxënia dhe Kultura Bashkëkohore (Media Education. Literacy, Learning and Contemporary Culture)*. Cambridge: Polity Press, 2003.

Këshilli i Evropës. Rekomandime CM/Rec(2018) të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Pluralizmin në Media dhe Transparencën e Pronësisë të Medias. Strasbourg: Këshilli i Evropës, 2018.

Observatori Evropian Audioviziv. Një Tabllo e Praktikave dhe Aktiviteteve për Edukimin mbi Median në BE – 28. (*Mapping of Media Literacy Practices and Actions in EU-28*). Strasbourg: European Audiovisual Observatory, 2016.

Komisioni Evropian. *Një Përfaqje Multi-dimensionale ndaj Dezinformimit: Raport i Grupit të Pavarur të Nivelit të Lartë mbi Lajmet e Rreme dhe Dezinformimin Online*. Luxembourg: Zyra e publikimit të Bashkimit Evropian. (*A Multi-dimensional Approach to Disinformation: Report of the Independent High Level Group on Fake News and*

Online Disinformacion). Luxembourg: Publication Office of the European Union, 2018.

Ford, Henry. *Jeta dhe Puna Ime (My Life and Work)*. New York: Doubleday, 1923.

Giroux, Henry A. *Të Jetosh me Rrezikun – Multikulturalizmi dhe Politikat e Dallimit (Living Dangerously – Multiculturalism and the Politics of Difference)*. New York: Peter Lang, 1996.

Hrvatina, Sandra, dhe Brankica Petković. "Paraqitje e situatës në rajon" *Pronësia e Medias dhe Ndikimi Mbi Pluralizmin dhe Pavarësinë e Medias, redaktuar nga Brankica Petković ("Regional Overview". Media Ownership and Its Impact on Media Pluralism and Independence)*, edited by Brankica Petković, pp. 9-49. Ljubljana: Peace Institute, 2004.

Hrvatina, Sandra, dhe Brankica Petković. "Paraqitje e situatës në rajon" Çështje të Integritetit të Medias, redaktuar nga Brankica Petković ("Regional Overview". *Media Integrity Matters*, edited by Brankica Petković, pp. 9-38. Ljubljana: Peace Institute, 2014.)

Jones, Alex. *Të Humbësh Lajmin. E Ardhmja e Lajmit që Ushqen Demokracinë. (Losing the News. The Future of the News That Feeds Democracy)*. Oxford: Oxford University Press, 2009.

Kellner, Douglas. "Studime Kulturore, Multikulturalizmi, dhe Kultura e Medias". *Gjinia, Raca dhe Klasët në Media*. ("Cultural Studies, Multiculturalism, and Media Culture". *Gender, Race and Class in Media*. A Text-Reader (2nd edition), redaktuar nga Dines Gail dhe Jean M. Humez, 9–21. London: Sage Publications, 2003.)

Kellner, Douglas. Kultura Mediatike. *Studime Kulturore, Identiteti dhe Politika ndërmjet Kulturës Mediatike Moderne dhe Postmoderne. (Cultural Studies, Identity and Politics between the Modern and the Postmodern)*. London: Routledge, 1995.

Lessenski, Marin. *Na Duhet Mendimi Praktik: Rezistenca ndaj 'Post-të vërtetës' dhe Parashikuesive të Saj në Listën e Treguesve për Edukimin mbi Median (Common Sense Wanted: Resilience to «Post-truth» and Its Predictors in the New Media Literacy Index 2018)*. Sofia: Open Society Institute Sofia, 2018.

Lippmann, Walter. *Opinion publik. (Public opinion)*. University of Virginia, American Studies Program, 2002-2003. <http://xroads.virginia.edu/~Hyper2/CDFinal/Lippman/header.html> (Hyrja në faqe 26 shkurt 2019).

Londo, Ilda dhe të tjerë. *Edukimi mbi Median dhe Nevojat për Trajnim për Gazetarët dhe Publikun Shqipëri, Bosnjë*

dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi: Raport rajonal. Bukuresht: Qendra për Gazetari të pavarur, 2017. (*Media Literacy and Education Needs of Journalists and the Public in Albania, Bosnia and Herzegovina, Macedonia, Montenegro, Serbia: Regional Report*). Bucharest: Center for Independent Journalism, 2017.

Mastnak, Tomaž. *Liberalizëm, Fashizëm, Neoliberalizëm (Liberalizem, fašizem, neoliberalizem)*. Ljubljana: Založba *cf, 2015.)

McLaren, Peter. *Multikulturalizmi Revolucionar – Pedagogjitë e Disidencës për Mijëvjeçarin e Ri (Revolutionary Multiculturalism – Pedagogies of Dissent for the New Millennium)*. Colorado: Westview, 1997.

McManus, John H. *Gazetaria në Funkcion të Tregut – Qytetarët të Tregojnë Kujdes? (Market-Driven Journalism – Let the Citizens Beware?)* London: Sage, 1994.

Mosco, Vincent. *Lart në Re. Kompanitë e Mëdha të Dhënave në një Botë të Trazuar (To The Cloud. Big Data in a Turbulent World)*. London: Routledge, 2014.

Nussbaum, Martha C. *Kufijtë e Drejtësisë. Paaftësi, Kombësi, Përkatësia e Species. (Frontiers of Justice. Disability, Nationality, Species Membership)*. Harvard: Belknap, 2006.

Oxfam. *E Mira Publike apo Pasuria Private? (Public Good or Private Wealth?)* Oxford: Oxfam International, 2019.)

Petković, Brankica, Saša Panić dhe Sandra B. Hrvatin. *Krahasimi i Modeleve dhe Kërkesës për Reforma në Mediat e Sektorit Publik (Comparing Models and Demanding Reforms of Public Service Media)*. Ljubljana: Peace Institute, 2016.)

Sen, Amartya. *Identiti dhe Dhuna. Iluzioni i Fatit (Identity and Violence. The Illusion of Destiny)*. New York: W. W. Norton, 2006.)

Steiner, Christopher. *Automatizojë edhe Këtë: Si Arritën Algoritmet të Drejtojnë Botën (Automate This: How Algorithms Came to Rule Our World, 2012.)*

Taylor, Charles. *“Politika e Njohjes”. Në Multikulturalizëm. Ekzaminimi i Politikës së Njohjes. (“The Politics of Recognition”. In *Multiculturalism. Examining the Politics of Recognition*), redaktuar nga Amy Gutmann, 25-73. Princeton: Princeton University Press, 1992.*

Tilly, Charles (ed.). Qytetaria, Identiteti, dhe *Historia Shoqërore (Citizenship, Identity and Social History)*. Cambridge: Cambridge University Press, 1996.)

Vaidyanathan, Siva. *Media Antisociale. Facebook na Ndan nga Njëri-tjetri, dhe Minon Demokracinë. (Antisocial Media. How Facebook Disconnects Us and Undermines Democracy)*. Oxford: Oxford University Press, 2018.

Verne, Jules. *Parisi në Shekullin e 20-të. Romani i Humbur. (Paris in the 20th Century. The Lost Novel)*. Toronto: Ballantine Books, 1863/1996.

Wiener, Norbert. *Kibernetika apo Kontrolli dhe Komunikimi me Kafshët dhe Makinën. (Cybernetics or Control and Communication in the Animal and the Machine)*. Cambridge, Ma.: The M.I.T. Press, 1965.

Wiener, Norbert. *Kibernetika dhe Shoqëria. (Cybernetics and Society)*. London: Free Association Books, 1989.) https://monoskop.org/images/5/51/Wiener_Norbert_The_Human_Use_of_Human_Beings.pdf (Hyrja në faqe 26 shkurt 2019).

Wilson, Edward O. *Konvergjenca. Njësia e dijes. (Consilience. The Unity of Knowledge)*. New York: Vintage Books, 1999.

Wu, Tim. *Pronarët e Rinj - Shkëlqimi dhe Rënia e Perandrive të Informimit (The Master Switch – The Rise and Fall of Informacion Empires)*. New York: Alfred A. Knopf, 2010.

Young, Iris Marion. *Drejtësia dhe Politika e Ndyshimit (Pravednosti politika razlike [Justice and the Politics of Difference])*. Zagreb: Naklada Jesenskii Turk, 2005.

Živković, Milan F. *Kush do të Paguajë për Gazetarinë (Who will Pay for Journalism?)* Ljubljana: Peace Institute, 2016.

Rreth autorëve

ILDA LONDO është diplomuar në degët Gazetari/Shkenca Politike. Ajo punon si Koordinatore e Kërkimit pranë Institutit Shqiptar të Medias.

BRANKICA PETKOVIĆ ka diplomën Master në Sociologji Kulture nga Fakulteti i Arteve, Universiteti i Ljublanës. Ajo punon si studiuese dhe manaxhere projektsh pranë Institutit të Paqes, Instituti për Studime Bashkëkohore Sociale dhe Politike në Ljublanë.

SANDRA BAŠIĆ HRVATIN ka titullin Doktor në Shkenca Komunikimi nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Ljublanës. Ajo jep mësim në Universitetin e Primorskës dhe është studiuese me përvojë në Qendrën e Shkencës dhe Kërkimit të Koper, Universiteti i Primorskës.

ISBN 978-9928-256-82-9



9 789928 256829 >



Financuar nga
Bashkimi European